



RAPORT AUDITIMI
MBI
(Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë)
në

“BASHKIA ROSKOVEC”

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

<u>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</u>	4
<u>1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit</u>	4
<u>2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</u>	11
<u>3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit</u>	13
<u>II. HYRJA</u>	14
<u>1. Objektivat e auditimit</u>	14
<u>2. Qëllimi i auditimit</u>	14
<u>3. Identifikimi i çështjes</u>	15
<u>4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>	15
<u>5. Përgjegjësitë e audituesve</u>	15
<u>6. Kriteret e vlerësimit</u>	16
<u>7. Standardet e auditimit</u>	16
<u>8. Metodologjia e auditimit</u>	17
<u>9. Dokumentimi i auditimit</u>	18
<u>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</u>	18
<u>1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Roskovec</u>	19
<u>2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit</u>	19
<u>1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.</u>	19
<u>2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2022.</u>	32
<u>3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.</u>	49
<u>4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.</u>	62
<u>4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.</u>	98
<u>5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit të Bashkisë Roskovec</u>	102
<u>6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.</u>	109
<u>7. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme</u>	113
<u>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME</u>	152
<u>V. ANEKSET</u>	165

Lista e shkurttimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Roskovec si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, zbatimi i kontratave të punimeve në investimet publike, administrimi i aseteve, shfrytëzimi për veprimtari ekonomike i fondit pyjor si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizozi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Roskovec 10 akt konstatime dhe 2 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Roskovec të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së. Gjithashtu, në ambientet e KLSH-së më datë 17.11.2023 ishte caktuar për tu zhvilluar takimi përfundimtarë me përfaqësuesit e Bashkisë Roskovec, takim i cili nuk u zhvillua pasi subjekti me emailin e datës 17,11.2023 nuk e pa të arsyeshme zhvillimin e këtij takimi.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 8,937 ha e ndarë sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 93 datë 26,11,2021 planifikim i kësaj takse për një vit ushtrimorë 2022 duhej të ishte në vlerën 32,940 mijë lekë , por në fakt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Roskovec është planifikuar një vlerë prej 25,852 mijë lekë ose më pak për shumën 7,088 mijë lekë vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në të ardhurat e Bashkisë Roskovec në kundërshtim me ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 ku si dhe_VKB nr. 93, datë 26.11.2021“Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Roskovec për vitin 2022”.	E lartë	Rekomandim Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej 7,088 mijë lekë , si e efekt në të ardhur në buxhetin e Bashkisë Roskovec.
2	Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Roskovec në datën 31.12.2022 janë në vlerën 166,688,832 lekë , nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 20,442,816 lekë dhe abonentë familjarë në vlerë	E lartë	Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 166,688,832 lekë nga taksapaguesit privat dhe familjarë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të

	<p>146,246,016 lekë., vlerë kjo e cila përbën detyrim të pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Rezulton se vetëm në vitin 2022 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 25,999,918 lekë, i përbërë nga 10,355,095 lekë dhe 15,644,823 lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Roskovec nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. DTTV për vitin 2022 nuk ka dërguar në Drejtorinë e Financës informacion lidhur me debitorët progresiv. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-45 të Raportit të Auditimit).</p>	<p>dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë Ekonomike. <i>a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.</i> <i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</i> <i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i> <i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i></p>
3	<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Fier. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 21,845,762 lekë për 758 persona, ndërsa shtesat për vitin ushtrimor buxhetor 2022 janë në vlerën 1,829,562 lekë për 61 persona, në total vlera e detyrimit është 21,845,762 lekë për 758 persona e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Roskovec, në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9,</p>	<p>E lartë Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për 758 objekte të legalizuara me vlerë 21,845,762 lekë. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Roskovec në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), të evidentojnë subjektet të cilët janë pajisur me certifikatës pronësisë dhe vendosje e urdhër kufizimit në kartelat e pasurive.</p>

	<p>pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 “ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec është miratuar me VKB-në 93, datë 26.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-45 të Raportit të Auditimit).</p>		
4	<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave për tokat bujqësore rezulton se 2 qiramarrës i nuk kanë paguar detyrimin sipas kontratës në vlerën 35,640 lekë për vitin 2022 e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec.</p> <p>Për kontratat e lidhura për shitje pasurie të paluajtshme rezulton që janë lidhur gjithsej 5 kontrata dhe 3 subjekte kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Roskovec, por për vitin 2022, janë 2 (dy) subjekte që nuk kanë paguar detyrimin për vlerën totale prej 83,184 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.</p> <p>VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-45 të Raportit të Auditimit).</p>	E lartë	<p>Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për arkëtimin e vlerave debitorë nga subjektet: S. I. në vlerën 28,600 lekë; D. K. në vlerën 7,040 lekë;</p> <p>S. L. në vlerën 37,350 lekë; T. L. në vlerën 45,834 lekë si dhe të ndiqet më përpikëri zbatimin e kushteve të kontratave shitjes së pasurive të paluajtshme.</p>
5	<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Roskovec dhe sipërmarrësit BOE “N.” SHPK ,“G.” dhe “S.” SHPK me kontratë nr.--- Prot, datë 06.03.2020 me objekt “Përmirsimi i furnizimit me ujë për qytetin e Roskovecit” dhe kontrolli në terren i rrugëve me rërë bituminoze u konstatua se rrugët në tërësi pothuajse ishin jashtë standartit madje në shumë vende përgjatë</p>	E lartë	<p>Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Roskovec konkretisht zyrës së urbanistikës dhe kryetarit të Bashkisë të merren masa për të mos hartuar dhe miratuar projekte të këtij lloji pasi janë projekte të cilat nuk kanë efikasitet dhe efektivitet si dhe degradojnë në një kohë shumë të shkurtër.</p>

	<p>sipërfaqes së tyre ishin gërryer dhe kishin krijuar gropa ,plasaritje të thella në disa pjesë kishte humbur pothuajse fare shtresa e sipërme me rërë bituminoze t=10,cm .Në disa pjesë kishte mbirë barë anash sipërfaqes së rrugës dhe në mes të aksit të sajë. Projektimi i këtyre rrugë <u>nuk është eficient dhe efektiv</u> pasi kjo metodë projektimi nuk garanton jetëgjatësi të objektit të ndërtuar. Lidhja mes këtyre shtresave nuk realizohet sipas kushteve teknike gjithashtu dhe vetë shtresa e rërës bituminoze nuk është zgjidhje e duhur marrë parasysh dhe përbërjen e sajë e cila nuk ka aftësi të mirë si ndaj ngarkesave që mban si në rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Aq më tepër kur këto rrugë nuk kanë kanale për kullimin e ujërave, pasi prania e ujërave mbi sipërfaqen e rrugës për një kohë të gjatë ndikon në degradimin e rrugës për një afat kohor të shkurtër. Vlera totale e investimit të këtyre rrugëve është 23,255,720 lekë e cila përbën përdorim pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Roskovec. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 85-89 të Raportit të Auditimit).</i></p>		
6	<p>Gjetje nga auditimi Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Roskovec për periudhën objekt auditimi janë vendosur 9 (nëntë) gjoba në vlerën 2,483,000 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 1,853,000 lekë, janë referuar në gjykatë 2 (dy) raste të ndërtimeve pa leje të konstatuara në vlerën 1,300,000 lekë dhe dy raste pa paguar në vlerën 533,000 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera 1,853,000 lekë, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 1,853,000 lekë. Sa më sipër rezulton se për 5 praktikat IMT-ja ka njoftuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me nenin 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1 faqe 96-100 të Raportit të Auditimit).</i></p>	E lartë	<p>Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në vlerën 1,853,000 lekë sipas aneksit nr. 2 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit.</p>

	<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës civile me objekt “Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut” me vlerë të kontratës (me tvsh) 23,153,880 lekë, realizuar nga OE “Z.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt me vlerë totale 1,042,235 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Roskovec. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.--- Prot, datë 30.03.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe OE “Z.” SHPK. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 85-89 të Raportit të Auditimit).</i></p>	E lartë	<p>Rekomandim: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,042,235 lekë pa tvsh nga OE “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.--- Prot, datë 30.03.2021, me objekt “Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>
7	<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezultoi se në 5 raste në procedurat e prokurimit publik, njësia e prokurimit nuk ka argumentuar kriteret e vendosur kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht në procedurat me objekt si vijon:</p> <p>1- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamion për mbledhjen e mbetjeve dhe kontener”, zhvilluar në vitin 2022.</p> <p>2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i banesave Ekzistues” zhvilluar në vitin 2022.</p> <p>3- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare 5 Dëshmoret ,Suk 1, Ambienteve sportive dhe Ndërtimi i palestrës , Bashkia Roskovec.”, zhvilluar në vitin 2022.</p> <p>4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Vidhishtë- Drizë,1470 ml (Asfaltim) b=4m+2*0.5”, zhvilluar në vitin 2022.</p> <p>5- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemimi i qendrës Marinëz +ndërtim rrethrotullimi”, zhvilluar në vitin 2022.</p> <p>Veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 59-85 të Raportit të Auditimit).</i></p>	E lartë	<p>Rekomandim Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.</p>

8	<p>Gjetje nga auditimi Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Roskovec për vitin ushtrimor 2022 kanë ushtruar aktivitetin 11 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte kanë mbyllur aktivitetin. Është pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 1 subjekt konkretisht B. me nipt L.....R dhe ka paguar detyrimet në vlerë 1,000,000 lekë si dhe janë pajisur me autorizim 3 dhe 4 vjeçar 3 subjekte të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 3,200,000 lekë si dhe nuk janë pajisur me autorizim 4 subjekte. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 93 datë 26.11.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-45 të Raportit të Auditimit).</i></p>	E lartë	<p><u>Rekomandimi</u> Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës, të ndërmar të gjitha procedurat ligjore për pajisjen me autorizim të 4 subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë respektivisht: Subjekti A. me nipt K.....A Subjekti E.me nipt K.....J Subjekti L. me nipt L.....V Subjekti B. me nipt L.....A</p>
9	<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 janë lidhur 27 kontrata me operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Roskovec, të cilët nuk kanë hapur nipt sekondar si dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore, që lindin ndaj Bashkisë Roskovec për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki. Nga sektori i prokurimeve nuk është dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës. Sa më sipër mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 <i>“Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të</i></p>	E lartë	<p><u>Rekomandimi</u> Sektori i prokurimeve në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Roskovec, të marri masa të menjëhershme për llogaritjen e vlerës së detyrimit sipas paketës fiskale nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Roskovec, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik.</p>

	<i>biznesit pranë Bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”, VKB nr. 93, datë 25.11.2021 për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-45 të Raportit të Auditimit).</i>		
10	Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë në nivelin “mjaftueshëm”, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. në sektorë të ndryshëm. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara si dhe plan-veprimi për monitorimin e Sistemit MFK. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23 dhe 24. -Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Roskovec. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 faqe 09-24 të Raportit të Auditimit).	E lartë	<u>Rekomandimi:</u> Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon: - Për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij; - Për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve; - Hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit; -Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar; -Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin; - Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”; - Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”; -Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit nga Bashkia Roskovec. -Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
11	Gjetje nga auditimi Nga kontrolli në sistemin e leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- Leje ndërtimi nr. ----, datë 10.01.2022 me zhvillues: D. H. i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: nid: k.....j; Leja e ndërtimit për objektin: “Magazine sherbimi 1 kat” adresa e	E lartë	<u>Rekomandim</u> Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të respektohet përdorimi i lejuar për njësinë strukturore përkatëse ku do të zhvillohet ndërtimi i ri. Në rastin konkret

<p>realizimit të punimeve: qyteti Roskovec. Sipas pasaportës për atë njësi strukturore konkretisht RO_UB_A2_70/21 dhe RO_UB_A1_70/59 përdorimi kryesor A i lejuar për atë njësi strukturore është 100 % “Banim” që do të thotë se objekte të llojit magazinë nuk mund të ndërtohen. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1 faqe 89-96 të Raportit të Auditimit).</p>	<p>përdorimi i lejuar në atë njësi strukturore është 100 % banim.</p>
--	---

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

I.Opinion mbi pasqyrat financiare për vitin 2022:

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare (PF) të Bashkisë Roskovec, për vitin 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Roskovec, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022, të shprehura në bazën për opinion”.

Baza për opinionin e modifikuar (kualifikuar):

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit (kap III/2.2) ku jepen përshkrimi i çështjeve për opinionin e kundërt për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidencat e auditimit që kemi siguruar, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe bazë për dhënien e opinionit tonë të kundërt (ISA-700/ISSAI-1700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022.

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

- Në gjendjen e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **21,845,762** lekë për 758 persona, si dhe nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMT –ja dhe Policia Bashkiake në vlerën 1,043,000 lekë të akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2022, vlerë e cila nuk është kontabilizuar.

Nga analiza e llogarisë 202- *Studime dhe kërkime*", rezulton se për 21 projekte Drejtoria e Financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit cka ka sjell një mbivlerësim të llogarisë në vlerë neto 10,868,600 lekë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Roskovec, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar (kualifikuar) të përputhshmërisë.

Baza për dhënien e opinionit

- Bashkia Roskovec nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 49,880 mijë lekë.

-Janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kriteret të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

- Në 5 raste dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet "Blerje kamion për mbledhjen e mbetjeve dhe kontenier", zhvilluar në vitin 2022; "Përmirësimi i banesave Ekzistues" zhvilluar në vitin 2022; "Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare 5 Dëshmoret ,Suk 1, Ambienteve sportive dhe Ndërtimi i palestrës , Bashkia Roskovec.", zhvilluar në vitin 2022; "Rikonstruksion i rrugës Vidhishtë- Drizë,1470 ml (Asfaltim) b=4m+2*0.5", zhvilluar në vitin 2022. "Sistemimi i qendrës Marinëz +ndërtim rrethrotullimi", zhvilluar në vitin 2022.

- Në 1 rast në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 9,534,932 lekë.

- Në auditimi i kontratave të zbatimit rezultuan diferenca në volumet e punimeve në vlerën **1,042,235 lekë nga OE "Z." SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. --- Prot, datë 30.03.2021, me objekt "Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut", Bashkia Roskovec,

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2022 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej **166,688** mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Roskovec, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Roskovec:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Roskovec.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit

financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 523/1 Prot, datë 20.06.2023, ndryshuar me shkresën nr. 523/2 Prot., datë 21.07.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 26.06.2023 deri në datën 04.08.2023, në subjektin Bashkia Roskovec u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1.H. I. – Përgjegjës Grupi

2.E. R.– Anëtar

3.B. B. – Anëtar

4.Pjese e grupit te auditimit ka qene edhe audituesja znj. E. V., e cila ka nderprer mardhenien me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Raporti i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Roskovec.

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Roskovec kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Roskovec është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Roskovec dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Roskovec, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arrijtjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Roskovec është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Roskovec. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Roskovec grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të

bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Roskovec me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut,

² ISSAI 1315

duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-J^a aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Bashkia Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Lushnjë, në jug me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Dimal, ndërsa në perëndim me Bashkinë Patos. Kryeqendra e



Bashkisë është qyteti i Roskovecit. Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia Roskovec ka 21.742 banorë ndërsa në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar është 31.548 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 118.01 km². Në bazë të popullsisë së numëruar nga censusi, densiteti i popullsisë së Bashkisë është 184 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti rezulton 263.33 banorë/ km².

Bashkia e Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë, e cila njihet si burimi më i madh i naftës në Europën kontinentale.

Pjesë e Bashkisë janë Njësitë Administrative Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan, e cila përfshin edhe fshatin Marinzë, që njihet veçanërisht si zonë naftëmbajtëse. Të ardhurat kryesore të banorëve vijnë nga ky sektori i naftës, në të cilin janë punësuar shumë prej banorëve të zonës. Gjithashtu, njësitë e tregtimit dhe shërbimeve janë një tjetër sektor ku janë punësuar shumë prej banorëve të qytetit të Roskovecit. Sa i takon zonave rurale, të ardhurat fitohen kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe agrumet.

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Në zbatim të pikës “1” të programit të auditimit: **“Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm. Nën-pika 1.1** Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Roskovec, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

- Bashkia Roskovec ka miratuar Rregulloren e Brendshme të administratës së Bashkisë me Vendimin të Titullarit Nr.40, Datë 21.04.2021, me shkresë Nr. 3095Prot., Dt.21.04.2021 dhe Rregulloren e Brendshme për parandalimin e Konfliktit të interesit të miratuar me Vendim të Titullarit Nr.7323Prot., Datë 17.12.2019 të hartuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike.

-Bashkia Roskovec nuk ka Kod të Etikës, por në nenin 17 të Rregullores së Brendshme janë përfshirë 11 rregulla të etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të Bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Qëllimi i të cilave është promovimi i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për punonjësit e administratës së Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative, gjatë dhe jashtë ushtrimit të kompetencave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore lidhur me rregullat e etikës në administratën publike.

- Në kreun I të Rregullores së Brendshme pika 1 dhe 3 janë përcaktuar objekti i rregullores dhe parimet bazë të veprimtarisë së Bashkisë Roskovec, ku nënkuptojnë **vlerat individuale morale dhe parimet e përgjithshme të etikës në ushtrimin e funksioneve publike të gjithë nëpunësit/punonjësit e Bashkisë Roskovec, janë të detyruar të respektojnë kushtetutën, ligjet, dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe parimet e etikës, te jenë të ndershëm e të paanshëm, të rrisin efektivitetin e punës në të gjithë strukturat e shërbimit civil dhe jo shërbimin civil si dhe të forcojnë besimin e mbështetjen e publikut ndaj tyre.**

-Në nenin 27 të rregullores së Brendshme janë përcaktuar procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të

raportuara të shkelje të kodit etik. Nuk kemi miratim të planit vjetor të trajnimeve në Bashkinë Roskovec për vitin 2022.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e informacionit), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë, në strukturën e cila do të trajtoj ankesat dhe kërkesat, strukturë e cila nuk është përcaktuar. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

- Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë për Titullarin (NA). Mungojnë raportet periodike, ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

Me shkresë **Nr.1298/1Prot., Dt.28.02.2023** është firmosur Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Bashkia Roskovec për vitin 2022 nga kryetar Znj. M. B..

Ka raporte monitorimi të buxhetit dhe performancës për çdo 4 muaj dërguar Ministrisë së Financave:

- 4 mujori I me shkresë Nr.5462Prot., Datë 30.05.2022;

- 4 mujori II me shkresë Nr.8749Prot., Datë 26.09.2022 dhe

- 4 mujori III me shkresë Nr.1239 Prot., Datë 27.02.2023.

-Në bazë të ligjit **Nr.10296, Datë 08.07.2010**“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29 dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qëndrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave “Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm” për vitin 2022 me shkresën **Nr.1298Prot., Datë 28.02.2023**.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit dhe për vitin 2022 nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA. Bashkia Roskovec ka të hartuar Planin e Përgjithshëm Vendor por nuk ka të miratuar Planin e Zhvillimit Strategjik dhe Planin Operacional të Zhvillimit Lokal. Në dokumentet e PBA e ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Bashkia Roskovec ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative, ku për vitin 2022 ka qënë në fuqi Rregullorja e Brendshme e miratuar nga Titullari me shkresën Nr.3095Prot., Datë 21.04.2021, me Vendim Nr.40, Dt 21.04.2021 nga Kryetari i Bashkisë Roskovec Znj. M. B..

Në nenin 43 të rregullores së brendshme është përcaktuar mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, që nënkupton metodën shkresore dhe elektronike dhe ka Vendim të veçantë të Kryetarit të Bashkisë. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet me ndryshimet e strukturave organike.

-Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Kështu:

- **Për vitin 2022** struktura është miratuar me Vendim të Titullarit **Nr.22, Dt.01.02.2022** me më **Nr.803Prot., Datë 01.02.2022** “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Bashkisë Roskovec, njësisve administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, si dhe organigramës për vitin 2022 ” ku numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Roskovec është gjithsej **187** (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) i kategorizuar si më poshtë:

- Kryetar - 1 (një)
- Kabineti i kryetarit - 11 (njëmbëdhjetë)
- Shërbimi civil – 55 (pesëdhjetë e pesë)
- Punonjës Administrativ dhe Mbështetës 120 (njëqind e njëzetë)

Në administratën e Bashkisë Roskovec gjatë vitit 2022, kanë funksionuar 9 (nëntë) drejtori dhe 22 (njëzetë e dy) sektorë.

Është miratuar dhe struktura për 2 (dy) ndërmarrjet vartëse të Bashkisë, konkretisht:

- **Për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjes**, me Vendimin **Nr.32, datë 15.02.2022** “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Ndërmarrjes vartëse, Ndërmarrja e Shërbimeve të Mirëmbajtjes (Rrugë, dekor, ndriçim, mirëmbajtje dhe investime publike) për vitin 2022”, ku numri i përgjithshëm i punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes është gjithsej **78** (shtatëdhjetë e tetë).

Ndryshuar, me Vendimin **Nr.2325/2Prot, Datë 24.02.2022** “Për një ndryshim në strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Ndërmarrjes Vartëse, Ndërmarrja e Shërbimeve të Mirëmbajtjes (Rrugë, dekor, ndriçim, mirëmbajtje dhe investime publike) për vitin 2022”, ku numri i përgjithshëm i punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes korrigjohet nga **78** (shtatëdhjetë e tetë) bëhet **74** (shtatëdhjetë e katër).

Ndryshuar përsëri, me Vendimin **Nr.80, Datë 28.06.2022** “Për një ndryshim në strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Ndërmarrjes Vartëse, Ndërmarrja e Shërbimeve të Mirëmbajtjes (Rrugë, dekor, ndriçim, mirëmbajtje dhe investime publike) për vitin 2022”, ku numri i përgjithshëm i punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes nga **74** (shtatëdhjetë e katër) bëhet **76** (shtatëdhjetë e gjashtë).

-Për **Ndërmarrjen e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza** me Vendimin **Nr.35, Datë 21.02.2022** “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Ndërmarrjes vartëse, Ndërmarrja e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza”, për vitin 2022, ku numri i përgjithshëm i punonjësve të Ndërmarrjes së Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza është gjithsej **80** (tetëdhjetë).

- Në Rregulloren e Brendshme janë përcaktuar për çdo drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist. Në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Roskovec ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, Bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”:

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit si dhe janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nëndarjeve dhe fushave përkatëse.

Të dhëna për pozicionet në shërbimin civil për vitin 2022, Bashkia Roskovec:

Numri i punonjësve për vitin 2022

Plan Fakt Vakante

55 47 8

Pozicione në shërbimin civil sipas strukturës në plan 55 (pesëdhjetëpesë) nga këto:

Pozicione të kategorisë së lartë drejtuese **1** (një)

Pozicione të kategorisë së mesme drejtuese **6** (gjashtë)

Pozicione të kategorisë së ulët drejtuese **14** (katërbëdhjetë)

Pozicione të kategorisë ekzekutive **34** (tridhjetekatër)

Pozicione në shërbimin civil sipas strukturës në fakt 47 (dyzeteshtatë) nga këto:

Pozicione të kategorisë së lartë drejtuese **1** (një)

Pozicione të kategorisë së mesme drejtuese **2** (dy)

Pozicione të kategorisë së ulët drejtuese **13** (trembëdhjetë)

Pozicione të kategorisë ekzekutive **31** (tridhjetenjë)

Pozicione në shërbimin civil sipas strukturës të paplotësuara (vakant) 8 (tetë) nga këto:

Pozicione të kategorisë së lartë drejtuese **0** (zero)

Pozicione të kategorisë së mesme drejtuese **4** (katër)

Pozicione të kategorisë së ulët drejtuese **1** (një)

Pozicione të kategorisë ekzekutive **3** (tre)

✓ **Informacioni si më sipër për KLSH, Bashkia Roskovec.**

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike është dërguar me shkresë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Vendimi Nr.48, Dt.18.03.2022 mbi “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 është kryer procedurë nga DBNJÇJ Roskovec për publikim vendesh të lira në zbatim me ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe rekrutuar në përputhje me të. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale sipas nenit 25 të Rregullores së Brendshme dhe VKM Nr.833, Datë 28.10.2020, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera. Nuk ka Urdhër të miratuar për “Plani Vjetor i Trajnimeve për Bashkinë Roskovec”.

-Vërehet se mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit por ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Gjithashtu, nga Bashkia Roskovec është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Për vitin 2022 realizimi i trajnimeve të stafit në organizime jashtë Bashkisë paraqitet **43**(dyzetetë) trajnime të punonjësve të Bashkisë Roskovec nga ASPA, OJF, Ministri etj., por nga vetë institucioni nuk ka asnjë trajnim të brendshëm për nëpunësit e saj.

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me **Ligjin Nr.114/2015** “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor Ekonomik.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”. Në Rregulloren e Brendshme në nenin 29 “Delegimi i detyrave” përcaktohet:

30.1. Delegimi i kompetencave, bëhet në përputhje me aktet ligjore.

30.2. Çdo delegim kompetencë duhet të dokumentohet me shkrim, duke përcaktuar llojin e kompetencës, periudhën në të cilën lëshohet, personin të cilit i është deleguar kompetenca.

30.3. Delegimi i kompetencave nuk e shkarkon nga përgjegjësia deleguesin.”

Janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit Nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 59, Pika 3 me autorizimet përkatëse:

-Autorizim Nr. 1072, Datë 09.02.2022;

-Autorizim Nr. 1073, Datë 09.02.2022;

-Autorizim Nr. 1502, Datë 21.02.2022;

-Autorizim Nr. 2467, Datë 28.03.2022;

-Autorizim Nr. 2468, Datë 28.03.2022;

-Autorizim Nr. 2888, Datë 08.04.2022;

-Autorizim Nr. 7298, Datë 09.08.2022;

-Autorizim Nr. 7631, Datë 23.08.2022;

-Autorizim Nr. 7695, Datë 25.08.2022.

-Nuk ka Urdhër të Brendshëm “Për delegimin e detyrës së koordinimit të rrishtit”, ndërsa në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të MFE Nr.23, Datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2022 me shkresën Nr. 1159 Prot., Datë 20.02.2022 me Urdhër të Titullarit, Datë 20.02.2022 “Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve”. Në këtë urdhër është ngritur GMS me **13**(trembëdhjetë) anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe 15(pesëmbëdhjetë) ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA për vitin 2023-2025. Ndërsa për ecurinë e periudhës Janar-Dhjetor është proceduar me Urdhër Nr.342/1Prot., Dt.11.02.2021“Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve”.

Në Bashki ngrihet Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili ndjek problemet që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin:

a) Vendos rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar

b) Harton Buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).

c) Ndjek zbatimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

d) Përgatit raporte në përputhje me rregullat, rregulloret dhe standardet e zbatueshme ose me objektivat e specifikuar të njësisë publike”.

Referuar kësaj nga auditimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si:

-Nuk ka vendosur rregulla të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar;

-Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut;

-Me shkresën **Nr.1298Prot., Datë 28.02.2023** i është dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Roskovec dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm” për vitin 2022.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit të zbatimit të buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave.

Në kapitullin “Vlerësimi i sistemit të MFK” janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për Bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së Bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu janë paraqitur masat e marra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe plan veprimi për të ardhmen për përmirësimin e performancës organizative dhe financiare të njësisë nga puna për arritjen e synimeve përkatëse të: Drejtorisë Ekonomike, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

-Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

-Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

-Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit.

-Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: -Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Roskovec në hartimin e PBA ka vendosur objektiva si në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në Këshillin Bashkiak, si dhe dëgjesa me publikun.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Në Bashkinë Roskovec nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut. Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në Bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Edhe pse është ngritur grupi i menaxhimit të riskut ka një mungesë të veprimtarisë së tij për rrjedhojë, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të Bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nenin 13 “Koordinatori i Riskut” është përcaktuar:

1. Të dhëna të përgjithshme

1.1. Koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i Bashkisë Roskovec.

1.2. Koordinator i riskut mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimit e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut.

2.1. Është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit të riskut.

2.2. Vlerëson sistemet e risqeve.

2.3. Bashkërendon aktivitetet lidhur me menaxhimin e riskut.

2.4. Harton dhe ndjek strategjinë e menaxhimit të riskut.

Referuar kësaj rregulloreje këto detyra dhe përgjegjësi nuk janë realizuar lidhur me këtë komponent të MFK nga NA dhe nuk ia ka deleguar punonjësve të Drejtorisë së Financës. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin Nr.10296, Datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9 pika 3, neni 10, neni 11 pika 2.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Roskovec në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për t'i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

Hartimi i Strategjisë së Rriskut është në proces plotësimi, Menaxhimi i Lartë i Institucionit vepron në bazë të:

- Vetëvlerësimin për Kontrollin e Brendshëm.

-Vënien në zbatim të rekomandimeve të AB-së në fushën e MFK-së.

-Plan veprimet e AB-së.

-Plan veprimet e KLSH-së.

Bashkia nuk ka përcaktuar Koordinator Risku për rrjedhojë, nuk kryhen trajnime të herëpashershme në lidhje me ligjin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe nuk përcaktohet roli i secilit Sektor apo Drejtori në funksion të komponentëve të MFK.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet kontrolli”.

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës.

Nuk është miratuar Urdhër “Mbi zbatimin e ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në Bashkinë Roskovec”, por proceset e punës kryhen duke u mbështetur në ligjin Nr.10296, Datë 08.07.2010 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në rregulloren e brendshme. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ).

- Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogarritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimi të mallit.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

- Në Rregulloren e Brendshme në Kreun IV “Administrimi, Komunikimi dhe Ruajtja e Dokumentacionit”, përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit. Procedura për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit bëhet nga Sektori i Sekretari-Arkivit në përputhje me Ligjin Nr.9154, Datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe me Vendimin Nr.4, Datë 19.06.2017 të Këshillit të Lartë të Arkivave:- Dokumentet financiar nuk evidentojmë dhe nuk dorëzohen në sekretari apo sekretari –arkiv dokumentet me karakter të thjeshtë (fatura, mandat-pagesa, mandate-arkëtimi, fletë -hyrje, fletë- dalje, fletë udhëtimesh etj.). Këto dokumente ruhen në sektorët përkatës dhe mbasi humbasin vlerën operative të ruajtjes, nxirren për asgjësim sipas rregullave nga vet sektorët. Dokumente të tilla të ndodhura në arkiv i janë dorëzuar zyrës së financës me procesverbal bazuar në ligjin përkatës dhe urdhërit të Kryetarit Nr.58, Datë 12.06.2020(neni nr.20 në Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, në ligjin Nr.9154, Datë 06.11.2003).

- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshme në detyrat e Drejtorisë Ekonomike, por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit Nr.30, Datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i

autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve. Aktivitet Afatgjatë nuk janë të regjistruara në SIFQ në mënyrë analitike për çdo aktiv por janë të regjistruara në grup aktivesh, pasi kjo Bashki akoma nuk është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Roskovec nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Sistemet nuk kanë procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme në nenin 34 pika 13 nënpika 1 përcaktohen detyrat e Punonjësit për mirëmbajtjen e rrjetit elektronik, i cili varet nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra:

- për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve;
- të merret me instalimin e programeve;
- menaxhon Serverin kryesor duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, fireëall-et, kufizimin e ndërhyrjeve në të dhënat e IT.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Drejtuesit në Bashkinë Roskovec kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit ndërsa raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

-Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Roskovec për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Microsoft Excel dhe nuk ka një program specifik të vetin të kontabilitetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike, gjithashtu edhe monitorimi i të ardhurave kryhet me program Microsoft Excel i cili menaxhohet nga Sektori i Tatim-Taksave dhe i Financave.

Në lidhje me parimin 14 dhe 15: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm dhe komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenin 4 pika 5

“Mbledhjet periodike të Kryetarit me strukturat drejtuese”, në Kreun III “Rregulla të përgjithshme” në nenin 14 “Marrëdhëniet ndërmjet strukturave të Bashkisë”, neni 15 “Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak”, neni 21 “Informacioni dhe komunikimi me median”, neni 22 “Informimi dhe marrëdhëniet me publikun”, neni 23 “Kordinatori i së drejtës për informim” në Kreun VI “Administrimi, komunikimi dhe ruajtja e dokumentacionit” neni 24 pikat 1- 6.

-Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

-Përdorimin e e-mailit zyrtar e kanë të gjithë punonjësit dhe komunikimi zyrtar mes punonjësve të Bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor kryhet nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

-Nga Bashkia Roskovec kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të dokumentuara në procesverbale si dhe të ngarkuara në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Bashkisë, **por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.**

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4(katër) muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

- **Në Bashkinë Roskovec mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.**

- Një nga drejtuesit e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm i cili në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm, vetëm për vitin 2022.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo anketa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se në Bashkinë Roskovec ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka mangësi të evidentueshme në tërësi.

Situata: Nuk janë kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

-“Mjedisi i kontrollit”

i)Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

ii)Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

iii)Nuk është evidentuar puna e anëtarëve GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet të për hartimin e planit strategjik dhe PBA. Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme në pikën 6 të

nenit 45 GMS nuk ka kryer detyrat si:- Mungesa e vendosjes së rregullavë të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar; -Mungesa e një programi strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit; -Mos garantimi i ruajtjes dhe zhvillimit profesional të stafit dhe mungesa e programeve të trajnimit për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional nga politikat dhe praktikat e dobëta të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Roskovec.

-“Menaxhimi i Riskut”

i)Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

ii)Në Bashkinë Roskovec nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

iii)Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në Bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Është ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij por nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

iiii)Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

i)Në Rregulloren e Brendshme në Kreun IX “Administrimi, Komunikimi dhe Ruajtja e dokumentacionit” në nenin 25“Të dhëna të përgjithshme” pika 5 “Ruajtja e dokumentacionit” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

ii)Bashkia Roskovec nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Sistemi nuk ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe gjithashtu nuk ka rregulla të shkuara për ruajtjen e aktiveve.

“Informimi dhe komunikimi”

i)Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

ii)Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Roskovec për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Microsoft Excel dhe nuk ka një program specifik të vetin të kontabilitetit.

“Monitorimi”

i)Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e Bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

ii)Në Bashkinë Roskovec mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

iii)Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Kriteri: -Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23 dhe 24. -Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Roskovec.

Ndikimi/Efekti: Mosevidentimi i aktiviteteve me risk të lartë, mosmartja e masave të nevojshme për zvogëlimin e riskut, me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve publike, përbëjnë risk për institucionin dhe ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit Nr.10296, Datë 08.07.2010“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe mos konsolidim të tërësisë së rregullave.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij;
- Për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve;
- Hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit nga Bashkia Roskovec.
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

Për sa më sipër, për mangësitë e konstatuara në fushën e MFK, ngarkohen me përgjegjësi M. B. (K/Bashkia Roskovec), D. H. (ish-DBNJ/Bashkia Roskovec), E. A.(ish-DBNJ/ Bashkia Roskovec), V. Z. (DBNJ/Bashkia Roskovec).

1.2. Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

1.3 Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm, të auditim Nr.523/1Prot., Datë 20.06.2022“Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022–31.12.2022”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Roskovec;
- 2.Planet Strategjik dhe pasqyrat shoqëruese;
- 3.Planifikimi vjetor për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese;
- 4.Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022;
- 5.Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- 6.Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
- 7.Dosjet koherente të subjekteve të audituara;
- 8.Projektraportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësisve publike;
- 9.Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre;

I-Vlerësimi dhe aktivitetit i Auditit të brendshëm në sektorin publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Bazuar në planin strategjik e vjetor të miratuar nga Titullari i Bashkisë Roskovec me Nr.6824Prot., Datë 18.10.2021 dhe Planit vjetor të rishikuar me Nr.5253Prot., Datë 23.05.2022, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar veprimtarinë e tij për periudhën Janar- Dhjetor 2022 në zbatim të programit.

Sektori i Auditit të Brendshëm, në nivel sektori është i përbërë me strukturën prej 3 (tre) nëpunës, 1 (një) përgjegjës, 2 (dy) specialistë auditimi. Sektori i Auditit të Brendshëm ushtron veprimtarinë e saj, bazuar në Ligjin Nr.114/2015, Datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.100, Datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Roskovec, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe neni 64, germa “a” të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

-Varësia organizative e NJAB në organi gramën e Bashkisë Roskovec është drejtpërdrejtë nga titullari i institucionit (Kryetari Bashkisë Roskovec).

Konstatohet se me shkresë Nr.2395 Prot., Dt.07.04.2023 nga Bashkia Roskovec është dërguar informacioni, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Tiranë mbi raportin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022, si dhe pasqyrat si më poshtë.

Me shkresë **Nr.1784Prot., Datë 10.02.2023** është dërguar nga Bashkia Roskovec raporti vjetor i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, ku vërehet se gjatë vitit 2022 sektori i auditimit ka vazhduar të ketë probleme me plotësimin e strukturës organizative për arsye të mospërmbushjes së kritereve të vendit të punës.

Konstatohet se, në auditimet e kryera ka mangësi ka funksionimin e kontrollit të brendshëm, në njohjen e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në vlerësimin e detyrimeve tatimore të taksapaguesve, në hartimin e dokumentacionit dhe evidentimin e saktë të vlerësimit dhe pagesës së taksave dhe tarifave vendore.

I/a.Situata e strukturës së NJAB në Bashkinë e Roskovec nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022

Nga auditimi u konstatua se struktura organizative e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 është përcaktuar që NJAB të ketë në përbërjen e saj **3(tre)** punonjës, por që për periudhën nën auditim rezulton se kjo njësi ka funksionuar me 3 (tre) punonjës, 1 përgjegjës i njësisë (i certifikuar), dhe 2(dy) specialistë auditimi, **(aktualisht në proces certifikimi është një specialiste, si më sipër përshkruar)**, në kundërshtim me ligjin Nr.114/2015 “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/2016 dhe VKM nr. 83/2016, përcaktohet qartë që në strukturën e [AB] mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për t’u certifikuar [NJAB], ndërkohë vërehet se një nga audituesit është në proces certifikimi, kurse audituesi i tjetër është me arsimim jo të mjaftueshëm (bachelor), pa certifikuar si audituese dhe jo në hapa procesi trajnimi apo certifikimi gjë që automatikisht sjell një auditim jo në nivele të kënaqshme.

➤ **Në zbatim të planit strategjik është hartuar plani vjetor për vitin 2022** ku bashkangjitur janë pasqyrat të cilat pasqyrojnë në detaje aktivitetin e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, si dhe planifikimin strategjik për vitet 2022-2024 si më poshtë:

➤ **Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimeve, fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre sipas pasqyrave më lart.**

Tek të 6 (gjashtë) auditimet janë hartuar planet e veprimit nga ana e Audituesve dhe nga subjekti i audituar. Vërehet që ka vend për përmirësime pasi struktura është e re dhe jo e trajnuar si dhe mungesa e suportit të vazhdueshëm nga ana e Drejtorisë Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm në mënyrë që të përmirësohet puna audituese dhe kontrollit të AB të Bashkisë Roskovec.

-Nga Angazhimet e auditimit për vitin 2022 u vlerësuan me risk të **lartë 1 (një) angazhim auditimi dhe 5 (pesë) angazhime auditimi me risk të mesëm.**

-Gjetje me efekte financiare evidentohet se ka dhe parregullsitë e evidentuara përmbledhen sipas pasqyrës mbi gjetjet e parregullsive bashkëlidhur këtij raporti.

➤ ***Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm***

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është bërë vlerësimi i kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. *Miratimi i strategjisë së riskut mbetet një nga synimet kryesore për 2023 për institucionin por vërehet që janë bërë hapa gjatë 2022 për hartimin e strategjive në nivel sektori e drejtorie për arritjen e këtij synimi.* Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm bëhet nga vet drejtuesi i njësisë auditimit dhe vetëkontrolli i veprimeve duke qënë se nuk kanë një komitet auditimi (mungesë fondi për krijimin e një strukture të tillë) për të pasur një vlerësim më të saktë dhe profesional.

➤ ***Trajnimet e [NJAB] dhe certifikimet***

Referuar ligjit Nr.10296/2010, Manualit të MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.8980, Datë 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE Nr.100/2016 të MFK, Ligjit Nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, rëndësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të [NJAB] sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Aktualisht NJAB është në proces certifikimi të **1** (një) audituese në organikën e saj.

Konstatohet se [NJAB] në Bashkisë Roskovec, ka respektuar të gjitha trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në zbatim me Ligjin Nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik”.

Mungesa e trajnimeve çdo vit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka ndikim negativ për njësinë pasi stafit i mungojnë njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, përgjegjësitë, shkallën hierarkike etj. Mungesa e transparencës për publikun lidhur me njohjen dhe veprimtarinë e këtij institucioni, shkak për këtë është mosveprimi i titullarit të institucionit mbi hartimin e një program trajnimi mbi menaxhimin e riskut si dhe krijimin e ëbesiteve të institucionit me qëllim rritjen e transparencës.

Bazuar si më sipër Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masë për punonjësit të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e rrishtut.

1/c. Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm

Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm.

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit Nr.114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin Publike”, planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Nga auditimi rezultoi se, bazuar në planin strategjik e vjetor të miratuar nga Titullari i Bashkisë Roskovec me **Nr.6824Prot., Datë 18.10.2021** i rishikuar, dhe Planit vjetor të rishikuar (ndryshuar) me **Nr.5253Prot., Datë 23.05.2022**, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar veprimtarinë e tij për periudhën Janar- Dhjetor 2022 në zbatim të programit.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer **6** (gjashtë) angazhime Auditimi, nga të cilat : **0** (zero) të kombinuar, **6**(gjashtë) përputhshmërie, **0**(zero) auditim performance.

Auditime të konfirmuara me shkresën **Nr.1784 Prot, Datë 10.02.2023**. drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave ku është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e nenit 14, të Ligjit Nr.114/2015, Datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Janë dhënë **31**(tridhjetë e një) rekomandime për përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive, si dhe për funksionimin e kontrolleve të brendshme për **6**(gjashtë) angazhimet e auditimit. ***Përgjithësisht Drejtoritë dhe sektorët kanë filluar të zbatojnë rekomandimet e lëna dhe janë në proces të ndjekjes së tyre.***

Në mënyrë të përmbledhur auditimet e planifikuara dhe të realizuara paraqiten si vijon:

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2022	6	6	6	0	0	0	0

Burimi i të dhënave: Njësisë e Auditimit të Brendshëm

➤ ***Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm***

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve u konstatua se:

- Përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik,” Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).

- Sektori i A.B në zbatim të planit vjetor nuk ka përfshirë në grup pune specialist të sektorëve të ndryshëm, për kryerjen e auditimit sipas programeve të miratuara nga Titullari i Bashkisë. ***Sektori i Auditimit të brendshëm edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar të ketë mangësi në certifikimin e specialistëve të auditimit të brendshëm.***

Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, rezulton që është kryer auditimi i detyrave dhe rekomandimeve të lëna, në përputhje me ligjin Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

-Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen dhe grupin e auditimit. Vend të veçantë në program zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjorë në fuqi.

➤ ***Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna.***

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022 është raportuar në mënyrë sistematike Kryetarit të Bashkisë Roskovec. Nga auditimi i raportimit vjetor për vitin 2022, janë dhënë **31**(tridhjetë e një) rekomandime për përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive, si dhe për funksionimin e kontrolleve të brendshme për **6**(gjashtë) angazhimet e auditimit. Nga Drejtoritë dhe sektorët e audituar janë hartuar planveprimet me afatet konkrete dhe personat përgjegjës mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit. **Përgjithësisht Drejtoritë dhe sektorët kanë filluar të zbatojnë rekomandimet e lëna dhe janë në proces të ndjekjes së tyre.**

Auditimet e realizuar dhe rekomandimet e realizuara për vitin 2022 paraqiten në tabelën si vijon:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej Leke	Zbatuar	Ne proces	Pa zbatuar
1	Viti 2022	31	17	10	4	1	-	1	-
TOTALI		31	17	10	4	1	-	1	-

Burimi i të dhënave: Njësia e Auditimit të Brendshëm

Konstatohet se: -Nga sa më lart grupi i auditimit thekson se NJAB në të gjitha angazhimet të kryera gjatë periudhës objekt auditimi në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bërë në afatin e përcaktuar në manualin e auditimit pas 6-muajsh.

Konstatohet se: - NJAB për periudhën objekt auditimi ka të miratuar një program auditimi në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara më parë, që është pasqyruar dhe më sipër, veprime këto që janë në zbatim me ligjin Nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Titulli i gjetjes: Mangësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Mungesa e trajnimit dhe certifikimit të audituesve në sektorin e AB.

Situata: Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Bashkinë Roskovec është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta vetëm përgjegjësi është pajisur ndërsa të tjerët nuk janë të pajisur me certifikatën e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe të VKM Nr.83, Datë 03/02/2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3., ndërkohë vërehet se një nga audituesit është në proces certifikimi, kurse audituesi i tjetër është me arsimim jo të mjaftueshëm (bachelor), pa certifikuar si audituese dhe jo në hapa procesi trajnimi apo certifikimi gjë që automatikisht sjell një auditim jo në nivele të kënaqshme.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin Nr.114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

-NJAB nuk ka kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM Nr.83, Datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin Nr.5 dhe Nr.6 të ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Miratimi i strategjisë së riskut mbetet një nga pikat me sensitive në lidhje me mungesën e hartimit të strategjive në nivel sektori e drejtorie për arritjen e këtij synimi.

-Audituesit e brendshëm në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmbëgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bërë në afatin e përcaktuar në Konkluzione mbi problematikat e punës si auditues.

Kriteri: Ligji Nr.114/2015, Datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, “Punësimi i audituesit të brendshëm”, neni 19 “Çertifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20, “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”, me MAB të miratuar me Urdhërin Nr.100, Datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” pika 2.6, “Roli dhe përgjegjësitë e Njësia

së Auditimit të Brendshëm” nën-pika (c) dhe pika 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe planit vjetor të AB”, kapitulli III, “Drejtimet e auditimit”, kapitulli IV pikat 4.1.7-4.1.12, kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi auditimi”, kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”, Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm”, pika 7.1.1. “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”, Pika 3 e VKM Nr.83, Datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin Nr.5 dhe Nr.6 të ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Ndikimi/Efekti: Mosrealizimi i objektivave dhe moskryerja e auditimit të brendshëm në njësi, shkakton mangësi në njohjen e problemeve nga menaxhimi i njësisë dhe pengon marrjen e masave në kohën e duhur për zgjidhjen e problemeve dhe parandalimin e fenomeneve negative, si mitmarrja, mashtrimi dhe korrupsioni.

Shkaku: Mosekzistenca e një stafi profesional të NJAB dhe realizimi i auditimeve jo në shkallën dhe nivelin e duhur në mospërputhje me kriteret e pranuar.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për mbylljen e çertifikimit dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1.Znj. M. B.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Roskovec.
- 2.Z. G. H.**, Përgjegjës në Njësinë e Auditit të Brendshëm.
- 3.Znj. E. C.**, Specialiste në Njësinë e Auditimit të Brendshëm.
- 4.Znj. G. Z.**, Specialiste në Njësinë e Auditit të Brendshëm.
- 5.Znj. X. S.**, Specialiste në Njësinë e Auditit të Brendshëm.

2. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e Bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me Urdhrin nr. 242/1, datë 11.02.2021, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 105 , datë 24.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Fier: me shkresën nr.1453/ date 10.01.2022.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:
a-PBA 2022-2024 miratuar respektivisht me VKB nr.46, datë 30.06.2021 me VKB nr.105 , datë 24.12.2021

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2022-2024 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politikat e programit”; “Qëllimi Politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr.	shënime
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë	Programe	
2022-2024	342/1	11.02.2021	342/1	11.02.2021	miratim kalendari	106	24.12.2021		
					miratim tavaneve të shpenzimeve	17	17.03.2021	19	në afat
					miratimi i tabelave të PBA	46	30.06.2021	19	në afat

Burimi: Drejtoria e Financës

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2022-2024 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 94, datë 29.06.2021, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 105, datë 24.12.2021, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Roskovec për vitet 2022-2024”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr.103 datë 24.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Fier me shkresën nr.03/1 date 11.01.2022

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën **423,549,902** lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën **115,118,589** lekë, transfertat specifike ka vlerën **62,311,131** lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën **600,979,622** lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën **600,979,622** lekë.

Gjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetorë 2022). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.8 , datë 27.01.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 18,129,586 lekë.

- Me VKB nr.16 , datë 28.02.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec .

“Për miratim fonde shtese dhe rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 11,682,000 lekë , si dhe shpërndarje ndërmjet programeve fondin për investime prej 926,456 leke.

- Me VKB nr.37 , datë 01.06.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për miratim të përdorimit te fondit te emergjencave civile për vitin 2022”, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime në vlerën 2,942,572 lekë brenda fondit te emergjencave civile nga fondi i kushtëzuar te akorduar për vitin 2022.

- Me VKB nr.42 , datë 29.06.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në vlerën 8,489,471 lekë brenda buxhetit te miratuar për vitin 2022.

- Me VKB nr.43 , datë 29.06.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për miratim ndryshim dhe shkurtim fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve dhe shkurtim fondesh me efekte -3,080,195 leke.
- Me VKB nr.53 , datë 27.07.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në vlerën 1,026,001 lekë brenda buxhetit të miratuar për vitin 2022.
- Me VKB nr.54 , datë 27.07.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar fonde shtese ne shumen 3,000,000 leke si dhe rishpërndarje fondesh brenda te njëjtit program në vlerën 956,880 lekë ne buxhetit te miratuar për vitin 2022.
- Me VKB nr.62 , datë 29.08.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për përdorimin e fondit rezerve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve ne shumen 650,000 leke si dhe rishpërndarje fondesh brenda te njëjtit program në vlerën 300,000 lekë ne buxhetit te miratuar për vitin 2022.
- Me VKB nr.73 , datë 30.09.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për fonde shtese në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 701,176 lekë.
- Me VKB nr.96 , datë 23.12.2022 është marrë vendim nga këshilli Bashkiak Roskovec “Për fonde shtese në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 27,052,000 lekë.

Buxhetit i miratuar për vitin 2022 është 619,110 mijë lekë. me burime financimi si me poshtë:

- 1- Të ardhurat e veta 428,604 (000) lekë (69.2%) të totalit të burimeve
 - 2- Transfertë e pakushtëzuar 124,113 (000) lekë (20%) të totalit
 - 3- Transfertë specifike 66,393 (000)lekë (10.7%) të totalit
- Të marra së bashku trasfertat nga qeveria qendrore janë **190,506** (000) lekë dhe zënë 30.8% të totalit të burimeve financiare.

Buxheti i miratuar është dërguar në Degën e Thesarit brenda afatit ligjor .
Më të detajuar burimet dhe shpenzimet e planifikuara paraqiten si vijon;

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022 ne mije leke	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2021/2022	5,054	0
2	Plani i të ardhurave viti 2022	423,550	0
3	Trashëguar nga transferta viti 2022	13,076	0
4	Transfertë e pakushtëzuar viti 2022	115,119	0
5	Transfertë e specifike viti 2022	62,311	0
		0	0
1	Paga (600)	0	180,348
2	Sigurime shoqërore (601)	0	28,907
3	Shpenzime operative (602)	0	80,228
4	Transferta (603+604+605+606+609)	0	12,776
5	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë	0	316,851
	Totali i buxhetit	619,110	619,110

Burimi: Drejtoria e financës

Në formë table paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2022 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

në mijë lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Projekt Buxhet 2022
600	Paga	170,259	182,639	182,639	180,348
601	Sigurime Shoqërore	27,778	29,104	29,104	28,907
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	70,764	86,148	86,148	62,098
603	Subvensione	2,000	4,000	4,000	1,000
604	Transferta Korente të Brendshme				5,600
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	194,788	153,000	153,000	6,176
I	Shpenzime Korrente	465,588	454,891	454,891	284,129
230	Kapitale të Patrupëzuara				
231	Kapitale të Trupëzuara	288,055	268,015	268,015	316,851
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	288,055	268,015	268,015	316,851
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale	288,055	268,015	268,015	316,851
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	753,644	722,906	722,906	600,980

Burimi: Drejtoria e financës

Gjatë vitit 2022 është bërë Analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore, Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe janë dërguar në ministrin e financave brenda afateve ligjorë.

Ky raportim monitorimi për vitin 2022 është miratuar në Këshillin Bashkiak dhe është dërguar në Ministrin e Financave. Konkretisht është hartuar raporti i monitorimit dhe i performances për vitin 2022 dhe është dërguar në ministrin e Financave respektivisht;

- 4 mujori I me shkresë Nr.5462 Prot., Datë 30.05.2022;
- 4 mujori II me shkresë Nr.8749 Prot., Datë 26.09.2022;
- 4 mujori III me shkresë Nr.1239 Prot., Datë 27.02.2023.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e më poshtme:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	203,897	208,743	-4,846
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	102,585	90,148	12,437
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	366,655	233,530	133,125
4	Investime nga FZSHSH			0
	Total I planit fillestar	673,136	532,421	140,715
	Shtesat nga Pushteti Qendror	329,708	190,485	139,223
5	Investime grant i kushtëzuar			0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	3,230	3,000	230
7	Shpenzime (602.604.609)	188,849	153,000	35,849
	<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>	<i>137,629</i>	<i>34,485</i>	<i>103,144</i>

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
	Gjithsej	1,002,844	722,906	279,938

Burimi: Drejtoria e financës

Nga auditimi konstatohet se nga krahasimi i planit përfundimtar të vitit 2022 me atë të PBA-së 2022-2024, vjen me rritje nga plani përfundimtar në vlerën 274,938 mijë lekë respektivisht: vlera në ulje 4,846 mijë lekë i përket shpenzimeve për paga; vlera në rritje 12,437 mijë lekë i përket shpenzimeve operative dhe trasfertat, ndërsa vlera në rritje 133,125 mijë lekë i përket investimeve të cilat janë rritur për shkak të shpenzimeve të shtuara për mbetjet urbane.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shitesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Në mënyrë të detajuar ndryshimet buxhetore janë paraqitur në aneksin nr. 3 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

bërë me urdhër të nëpunësit Autorizues dhe janë miratuar ne Degën e Thesarit Fier.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në vlerën **1,011,839 mijë lekë**, e detajuar sipas aneksit nr. 4 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Konstatohet se plani i buxhetit i gjendëruar nga thesari ka vlerën **1,011,839 mijë lekë** i barabartë me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli Bashkiak që ka vlerën **1,011,839 mijë lekë**.

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **1,011,839 mijë lekë**, ndërsa realizimi **820,212 mijë lekë**, ose në masën 89.01%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **178,183 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **172,041 mijë lekë**, ose në masën 96.60%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 96%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **92,672 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **71,506 mijë lekë**, ose në masën 77.20%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **504,283 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **345,534 mijë lekë**, ose në masën 68.50 %.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Roskovec ka diferenca me vlerën e planifikuar.

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **1,011,839 mijë lekë**, ndërsa realizimi **820,212 mijë lekë**, ose në masën 89%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara , i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **504,283 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **345,534 mijë lekë**, ose në masën 68.50 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Roskovec në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetaren e Bashkisë Roskovec znj. M. B., si dhe z. S. Ç., me detyrë Drejtor i Financës.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë

Konstatohet se për vitin 2022 me VKB nr. 62 , date 29.08.2022 është miratuar buxheti i vitit 2022 ku është përcaktuar edhe fondi rezervë (fondi i veçantë) fondi rezerve dhe i kontigjences është 1,500,000 leke

- fondi i emergjencave nga te ardhurat 2,500,000 leke
- mënyrën e llogarritjes të kësaj vlere, bazën ligjore për këtë;
- vlera e përdorur në fakt, për çfarë janë përdorur këto fonde nga Bashkia Roskovec;

Me vendim nr.62 , date 29.08.2022 është përcaktuar përdorimi i fondit rezerve ne masën 650,000 leke pre nevojat shtese për riparim dhe mirëmbajtje te pompave te vaditjes dhe kaldajave te shkollave . Gjithashtu po me këtë vendim është vendosur qe nga fondi rezerve të përdoren 300,000 leke për sigurimin e instrumentave fillestar te “Grupit Vendore te veprimit”

- vlera e pa përdorur është 550,000 mije leke.

Ndërsa për fondin e emergjencave nga te ardhurat e Bashkisë nuk është mare vendim për përdorim për vitin 2022.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE) Në mënyrë të përmbledhur paraqitet fondet e trashëguara për vitin 2022.

Fondet e trashëguara në 31.12.2021 për përdorim në vitin 2022 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2022 për përdorim në vitin 2023 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
75,433,269	82,851,685

Detyrimet e prapambetura viti 2022

Vlera e raportuar nga Bashkia Roskovec në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është **65,119,199 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 1240 prot., datë 27.02.2023 drguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sftatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve	65,119,199		
II	Detyrime (a+b+c)			10,30%
a	Shpenzime korrente	8,612,128		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	56,507,071		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			

c	Vendime gjyqësore			
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	65,119,199	632,452,384	10.30%

Burimi: Bashkia Roskovec

Titulli i gjetjes: Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura.

Situata:

Bashkia Roskovec në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 174,850 mijë lekë. Në buxhetin vjetor 2022 është likuiduar vlera 159,611 mijë lekë, ose 91.2% e vlerës së detyrimit

Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjate vitit 2022 , kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022 .

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (174,850-65,119), me 109,731 mijë lekë, ose në masën prej 62%. Ndërsa detyrimet e krijuara gjat vitit 2022 janë në vlerën 49,880 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr. 5 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Roskovec znj. M. B., si dhe z. S. Ç., me detyrë Drejtor i Financës.

Kriteri: UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimi MFE nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” si dhe neni 52 i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndikimi: Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Roskovec dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, ku mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rrishtë për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 22 datë 01.02.2022., “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Roskovec dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 13 punonjës konkretisht: 1 drejtor, 2 përgjegjës sektori 2 specialistë të vlerësimit të taksave dhe tarifave të biznesit dhe familjarë, 3 specialist pran Njësi Administrative Kurjan, Kuman dhe Strum, Bashkia Roskovec. Në mënyrë të detajuar struktura e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2022 është paraqitur në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Për vitin 2022: Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 93 datë 26.11.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier. Nga të dhënat e **pasqyrës aneks nr. 2** më poshtë, shihet se për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave është në vlerën. 423,550 **mijë lekë** dhe realizuar në fakt në vlerën 305,025 **mijë lekë**, në mënyrë të detajuar paraqitur në aneksin nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Titulli i gjetjes: *Metodologjia që DTTV përdor për të realizuar planifikimin vjetor të taksave dhe tarifave vendore nuk bën të mundur një parashikim real të të ardhurave të veta të Bashkisë Roskovec.*

Situata: Me qëllim analizimin e treguesve të planifikimit dhe realizimit të taksave dhe tarifave vendore nga DTTV në Bashkinë Roskovec u kërkua informacion lidhur me metodologjinë që zbatohet në hartimin e planifikimit vjetor të të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore. Rezulton se, ka diferencë të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të Bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

Për vitin 2021, është planifikuar si e ardhur vlera **423,550 mijë lekë** dhe realizuar në fakt në vlerën **305,025 mijë lekë**, pra me një mosrealizim në shumën **118,525 mijë lekë**. Tejkallimet dhe mosrealizimet janë argumentuar si më poshtë:

Të ardhurat tatimore dhe argumentet e dhëna nga sektori i taksave dhe tatimeve për tejkallimet dhe mosrealizimet, paraqiten si më poshtë:

- Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, është në masën 87%, pasi kjo është e ardhur që vjen nga DRT Fier, ndërsa planifikimi është bërë duke u nisur nga realizimi i një viti më parë.
- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtese, tokë, truall), është në masën 96%,.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, është në masën 20%, pasi planifikimi është bërë duke u nisur nga të ardhurat e realizuara të një viti më parë, të cilat kanë qënë të konsiderueshme, por edhe nga mungesa e legalizimeve nga ana e ASHK-së.
- Taksa e mjeteve të përdorura është në masën 105%, ku ka ndikuar edhe kërkesa e Bashkisë për rakordime mujore me DRSHTRR Fier.
- Të ardhura nga taksa e rentës minerare, është në masën 90%, për arsye të dërgimit nga qeverisja qendrore në muajin dhjetor 2022.
- Taksa e tabelës dhe reklamës, është në masën 113%, për shkak të çmimit shumë të lartë për m²
- **Të ardhurat Jotatimore**, paraqiten si më poshtë:

- Të ardhurat nga tarifat vendore, është në masën 62%, për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifat e ndriçim, janë në masën 53% kryesisht për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifat e gjelbërimit, janë në masën 51% kryesisht për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifa e pastrimit janë në masën 76%.
- Tarifa të tjera janë në masën 46% në të cilat janë përfshirë (tarifa e vaditjes; të tjera të ardhura; tarifat e përkohshme; tarif për mirëmbajtjen e sistemit kullues; sponsorizime, etj...).

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Udhëzimi të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; VKB-në 93, datë 26.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022.

Ndikimi: Niveli i planifikimit të të ardhurave të Bashkisë nga taksat dhe tarifat vendore ndikon direkt në hartimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Roskovec.

Shkaku: Strukturat brenda Bashkisë Roskovec nuk dërgojnë informacionin përkatës pranë DTTV sipas përcaktimeve të VKB-ve për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Roskovec. DTTV nga ana e saj në mungesë të këtij informacioni si dhe nga mos kryerja e analizave të mirëfillta nuk arrin një planifikim efektiv.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Roskovec të analizojë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

➤ **Taksa e tokës:**

Për vitin 2022 taksa mbi tokën bujqësore është realizuar në nivelin 92% (planifikuar 25,852 mijë lekë dhe realizuar 23,697 mijë lekë). Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore rezulton se Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 , pika 1 “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetë deklaratim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë Bashkisë ku ndodhet toka”, pikës 2.2 dhe të VKB-së për vitin 2022⁴ dhe është e ndarë në 7 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit. si vijon;

Në ha

Nr	Njesia Administrative	Toke bujq. gjithsej Ha ne 1991	Nr. Fam. Qe kan mar AMTP	Sipërfaqja e tokes ndar ne fakat Ligji 7501	Kategoria e tokës ndar sipas ligjit 7501/ në hektar							Sipërfaqja e ndar sipas sipas	Sipërfaqja e tokes	Sip. e tokes
					I	II	III	IV	V	VI	VII			

⁴ VKB nr. 93, datë 26.11.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Roskovec për vitin 2022”.

1	Roskovec		1268	1189	0	593	481	115	0	0	0			
2	Kuman		1512	1982	0	138	546	459	224	145	470			
3	Strum		1494	3260	6.5	932.2	1622.6	586.4	106.3	6	0			
4	Kurjan		1106	2506.3	0	0.4	137	673	761	472	462.9			
Shuma		9062.8	5380	8937.3	6.5	1663.6	2786.6	1833.4	1091.3	623	932.9	8937.3	125.5	35.89
Çmimi sipas VKB					5600	4900	4200	3600	3000	2400	1800			
Total vlera 32,940,320					36,400	8,151,640	11,703,720	6,600,240	3,273,900	1,495,200	1,679,220			

Burimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria e Tatim Taksave

Titulli i gjetjes: *Mos planifikimi i saktë i taksës së tokës bujqësore.*

Situata: Nga ku rezulton se sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 8,937 ha e ndarë sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 93 datë 26.11.2021 planifikim i kësaj takse për një vit ushtrimorë duhej të ishte në vlerën **32,940 mijë lekë**, por në fakt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Roskovec është planifikuar një vlerë prej **25,852 mijë lekë** ose më pak për shumën **7,088 mijë lekë** vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Kriteri: Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 ku cilësohet: *“Taksa mbi tokën bujqësore 1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli Bashkiak ose komunal mund të miratojë nën kategorizime. 2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji. 3. Përrjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. 4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e Bashkisë ose komunës, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme”.*

VKB nr. 93, datë 26.11.2021“Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Roskovec për vitin 2022”.

Impakti: Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore

Shkaku: Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe koordinim i gabuar midisi sektorëve në marrjen e informacionit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej **7,088 mijë lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Roskovec kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Roskovec 2021-2022

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja fillim në	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2021	415	19	28	406
		2022	406	18	14	410
2	Biznesi Madh	2021	71	5	3	73
		2022	73	2	2	73
	Gjithsej	2021	486	24	31	479
		2022	479	20	16	483

Burimi: Bashkia Roskovec

Sa më sipër konstatohet se numri total i bizneseve në Bashkinë Roskovec ka ardhur në rritje nga viti 2021 që rezultojnë 479 në vitin 2021 rezultojnë 483 biznese gjithsej. Për këtë periudhë janë regjistruar 20 biznese të reja ndërkohë që janë mbyllur 16 biznese të tjera.

Menaxhimi i borxhit

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore. Gjendja e debitorëve progres për subjektet fizik/juridik dhe familjarë paraqitet deri në 31.12.2021 në vlerën **140,688,914 lekë** dhe në 31.12.2022 në vlerën **166,688,832 lekë**. Në mënyrë të detajuar paraqitet si vijon:

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të Bashkisë.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrimit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Roskovec nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse është aksionare e vetme e shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime Roskovec ShA dhe bazuar në pikën (ii), neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore.

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore.

Paketa Fiskale e Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familiar në vlerën **146,246,016 lekë**. Vlerë e cila përbën Detyrim të pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Roskovec, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familiar deri në datën 31.12.2022. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut

XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Në **Pasqyrën Aneks 4** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifatat vendore të ndara sipas Njësive administrative si vijon:

Nr.	Nj. Administrative	Numri i familjeve	Toka Vlera në lekë	Numri i familjeve	Ndertesa, truall, pastrim, ndricim, gjelberim		Mirembajtje Kanali	Totali Nj. A
					Vlera në lekë	Numri I familjeve	Vlera në lekë	
1	Roskovec	767	11,718,786	1,496	16,162,026	707	1,081,813	28,962,625
2	Kuman	1,294	19,832,270	1,233	12,697,542	998	1,483,406	34,013,218
3	Strum	1,617	39,656,719	1,646	17,430,258	1,187	3,494,325	60,581,302
4	Kurjan	674	16,950,759	657	5,738,112	-	-	22,688,871
	SHUMA		88,158,534		52,027,938		6,059,544	146,246,016

Burimi: Bashkia Roskovec

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifatat vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën 14,784,740 lekë. Gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 4,697,019 lekë si dhe janë shtuar debitorët në vlerën 10,355,095 lekë duke ngelur pa u arkëtuar vlera 20,442,816 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Roskovec si vijon;

Nr. debitorëve	Emërtimi njësive	Gjendja fund 31.12.2021	Pakësimi 2022	Shtesa gjate vitit 2022	Gjendja në fund vitit 2022
1	BIZNESE	14,784,740	4,697,019	10,355,095	20,442,816

Burimi: Bashkia Roskovec

Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Roskovec është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:⁵

- 1.Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
- 2.Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
- 3.Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2022. Sipas listës që administrojnë drejtoria e taksave dhe tarifave vendore.

Sa me sipër ariet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të Bashkisë Roskovec, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar

⁵Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Kriteri: Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:

Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **166,688,832 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë Ekonomike.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Fier. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **21,845,762 lekë** për 758 persona, ndërsa shtesat për vitin ushtrimor buxhetor 2022 janë në vlerën **1,829,562 lekë** për 61 persona, në total vlera e detyrimit është 21,845,762 lekë për 758 persona e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Roskovec (sipas listës të administruar në CD).

Periudha	Nr. i lejeve të legalizimit	Vlera totale e detyrimit në lekë	Vlera e Tni paguar lekë/m ²	Vlera e taksës pa paguar në lekë
Deri 31.12.2021	697	25,177,144	5,163,108	20,015,623
Deri 31.12.2022	61	1,859,564	29,655	1,829,909
Shuma	758	27,036,708	5,192,763	21,84,532

Burimi: Bashkia Roskovec

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec është miratuar me VKB-në 93, datë 26.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”;

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Roskovec, nga mos arkëtimi i vlerës prej **21,845,762 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e masave nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për të bërë të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve nga subjektet/familjet që kanë përfituar certifikatën e pronësisë, si dhe mos bashkëpunim me DTTV dhe ASHK-në.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për **758 objekte** të legalizuara me **vlerë 21,845,762 lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Roskovec në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), të evidentojnë subjektet të cilët janë pajisur me certifikatës pronësisë dhe vendosje e urdhër kufizimit në kartelat e pasurive.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me subjektet e tregimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Roskovec dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 11 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	Ç. SH.P.K	J.....B	05.05.2020	04.05.2023	600000	600000	0
2	D.	L.....G					Mbyllur
3	B.	L.....A					Nuk eshte licencuar
4	E.SHPK	K.....S			800000	800000	0
5	L.	L.....V					Nuk eshte licencuar
6	A.	L.....M					Mbyllur
7	E.	K.....J					Nuk eshte licencuar
8	X. SH.P.K	K.....E	18.12.2020	18.12.2024	800000	800000	0
9	A.	K.....A					Nuk eshte licencuar
10	B.	L.....R	18.12.2020	18.12.2025	1000000	1000000	0
11	D.	L.....V	04.11.2016	04.11.2021			
SHUMA						3200000	

Burimi: Bashkia Roskovec

Situata Nga dokumentacioni i venë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Roskovec për vitin ushtrimor 2022 kanë ushtruar aktivitetin 11 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte kanë mbyllur aktivitetin. Është pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 1 subjekt konkretisht B. me nipt L.....R dhe ka paguar detyrimet në vlerë 1,000,000 lekë si dhe janë pajisur

me autorizim 3 dhe 4 vjeçar 3 subjekte të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 3,200,000 lekë si dhe nuk janë pajisur me autorizim 4 subjekte. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 93 datë 26.11.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatua se situata paraqitet e pa ndryshuar nga auditimi i mëparshëm konkretisht:

1. Subjekti “Ç.” Shpk, me NUIS J.....B, ka ushtruar aktivitet si pikë shpërndarje karburantesh, vajrash dhe pjesë këmbimi automjeteve, tregtim gazi me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 23.04.2018-23.04.2019, pajisja me licencën e radhës është 24.04.2019-23.04.2020 dhe është pajisur sërish me licencë 3-vjeçare për periudhën 05.05.2020-04.05.2023. Është bërë pagesa e licencës në vlerën 200,000 me datë 23.04.2019. Me shkresë nr. 185 prot., datë 1.02.2018 Bashkia Roskovec ka lëshuar vërtetim për këtë subjekt, i cili nuk ka taksë dhe detyrime për të shlyer pranë zyrës së Tatim-Taksave. Me shkresë nr. T00172084, datë 14.03.2018 MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier ka lëshuar vërtetim për këtë subjekt, i cili nuk ka detyrim tatimor të papaguar.

2. Subjekti “D.” Shpk, me NUIS L.....G, ka ushtruar aktivitet tregti me pakicë të benzinës, naftës, gazit, lubrifikantëve dhe të gjitha produkteve dhe nënprodukteve të tyre. Bashkia Roskovec me Urdhër nr. 14, datë 25.02.2019, me komision “Për shqyrtimin e kërkesës së subjekteve të “Pikave të Karburanteve”. Me shkresë datë 06.08.2021 Bashkia Roskovec ka lëshuar vërtetim për pagesë të taksave dhe tarifave se subjekti nuk ka detyrime të prapambetura. Me shkresë datë 02.06.2021 Bashkia Roskovec ka lëshuar vërtetim për pagesë të taksave dhe tarifave se subjekti nuk ka detyrime të prapambetura. Me shkresë 4057/1 prot., datë 05.07.2021 Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative për kërkesën nr. 4057, datë 02.06.2021 për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni. Me shkresë 5575 prot., datë 12.08.2021 Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative për kërkesën nr. 5177, datë 22.07.2021 për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni.

3. Subjekti “D.” Shpk, me NUIS L.....V, ka ushtruar aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve si nafta, benzina, gazi i lëngshëm etj. Me autorizim nga Bashkia Roskovec datë 7.11.2016 me një afat 5-vjeçar nga data 04.11.2016-04.11.2021, dhe nuk ka një licencë të rinovuar për periudhën në vazhdim, duke ushtruar aktivitet i pa pajisur me autorizim me efekt financiar, 2 muaj x 16,666 = 33,332 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

4. Subjekti “B.” Shpk, me NUIS L.....A, ushtron aktivitet tregtim me shumicë e pakicë i hidrokarbureve e nënprodukteve të saj, lëngut të gazit, etj. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 3291/1 prot., datë 23.10.2017, për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni.

5. Subjekti “E.” Shpk, me NUIS K....S, ushtron aktivitet tregtim karburant, lubrifikant me pakicë dhe ka marrë autorizim për një periudhë 5-vjeçare për tregtim me pakicë të karburanteve, është pajisur me licencë 1-vjeçare nga data 23.09.2019-22.09.2020 dhe licencë 4-vjeçare nga data 07.12.2020-07.12.2024 dhe për periudhën 23 Shtator – 06 Dhjetor të vitit 2020 ka ushtruar aktivitet pa licencë. Periudha 2 mujore nga 23.09.2020-06.12.2020 është periudhë që ka ushtruar aktivitet e pa pajisur me autorizim me efekt financiar, 2 muaj x 16,666 = 33,332 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

6. Subjekti “L.” Shpk, me NUIS L.....K, ka ushtruar aktivitet tregtim me pakicë i karburanteve të ndryshme, vajrave lubrifikant për mjete të tonazheve dhe llojeve të ndryshme, etj. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 3152, datë 24.05.2021, nr. 6450/1, datë

26.10.2021 dhe 6450/2 datë 25.10.2021 për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni. Me shkresë datë 27.09.2021 Bashkia Roskovec ka lëshuar vërtetim për pagesë të taksave dhe tarifave se subjekti nuk ka detyrime të prapambetura.

7. Subjekti “A.” Shpk, me NUIS L.....M, ka ushtruar aktivitet tregtim me pakicë i karburanteve të ndryshme, vajrave lubrifikant për mjete të tonazheve dhe llojeve të ndryshme, etj. Bashkia Roskovec me shkresë datë 2.06.2016 ka lëshuar vërtetim për pagesë të taksave dhe tarifave se subjekti ka shlyer detyrimet për taksën e ndërtesës dhe taksën e tokës bujqësore për vitin 2015 dhe detyrimet e biznesit për vitin 2016. Me shkresën nr. 4735 prot., datë 05.07.2021 kthim përgjigje për kërkesën për pajisje me licencë “Për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, etj.”, Bashkia shprehet se duhet të merret në shqyrtim pagesa për detyrimet që subjekti ka.

8. Subjekti “E.” Shpk, me NUIS K.....J, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të karburanteve, etj. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 582/1 prot., datë 07.03.2019, për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni.

9. Subjekti “X.” Shpk, me NUIS K.....E, ushtron aktivitet tregtim me pakicë i karburanteve dhe gazit të lëngshëm, etj. Është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 28.06.2019-27.06.2020, pajisja me licencën e radhës është për një periudhë 4-vjeçare nga 18.12.2020-18.12.2024, dhe për periudhën 28 Qershor – 17 Dhjetor të vitit 2020 ka ushtruar aktivitet pa licencë. Periudha 5 muaj e 19 ditë nga 28.06.2020-17.12.2020 është periudhë që ka ushtruar aktivitet e pa pajisur me autorizim me efekt financiar, 5 muaj x 16,666 = 83,330 dhe 19 ditë x 555 = 10,545 lekë, në total 93,875 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

10. Subjekti “A.” Shpk, me NUIS K.....A ushtron aktivitet tregtim karburanti dhe është pajisur me licencë 5-vjeçare nga data 06.05.2015-06.05.2020, pas kësaj date deri në fund të vitit 2021 ushtron aktivitet pa licencë. Periudha 8 muaj me efekt financiar, 8 muaj x 16,666 = 133,328 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

11. Subjekti “B.” Shpk, me NUIS L.....R, ushtron aktivitet tregtim me pakicë i naftës bruto, gazit natyror, gazit të lëngshëm, i nënprodukteve të përparuara të naftës si benzina, etj., dhe është pajisur me licencë 5-vjeçare nga data 18.12.2020-18.12.2025.

Nga informacioni dhe dokumentacioni që Bashkia disponon, rezulton që subjektet që ushtrojnë aktivitet pa autorizim të ketë një efekt financiar me vlerë totale **293,867 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.**

Kriteri: Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35 ku cilësohet:

“1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e Bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur:

a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;

b) nuk është taksë Bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.

2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli Bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat Bashkiake ose komunale apo nga një agjent”.

- VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II, kapitulli III, pika 4, ku cilësohet:

II. Procedura për dhënien e autorizimeve

Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit

për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.

III. Pagesat

Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues. Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:

1. për lejet e tregtimit të llojit "A" 500 000 lekë
2. për lejet e tregtimit të llojit "B" 200 000 lekë
3. për lejet e tregtimit të llojit "C" 200 000 lekë
4. për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazi të lëngshëm, vajrash lubrifikante dhe të stacioneve të mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm 100 000 lekë
5. për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse 50 000 lekë.

Tarifat për përsërritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave të mësipërme.

- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës "b" ku cilësohet:

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Pagesa për dhënien dhe përsërritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe **2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.**

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënien dhe përsërritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera**".

10. Pagesa për dhënien dhe përsërritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe **200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.**

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"10. Pagesa për dhënien dhe përsërritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.**"

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e

licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

-VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

Impakti: E ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec nga aktiviteti i paligjshëm i 4 subjekteve dhe mospagim të detyrimeve.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave në zbatimin e kuadrit ligjorë.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi

Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për pajisjen me autorizim të 4 subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë respektivisht:

Subjekti A. me nipt K.....A

Subjekti E.me nipt K.....J

Subjekti L. me nipt L.....V

Subjekti B. me nipt L.....A

➤ **Mbi pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Roskovec.**

Titulli i gjetjes: Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të cilët janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Roskovec 2022.

Situata: Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Roskovec grupi i auditimit auditoi dokumentacionin mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifave vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Për periudhën nën auditim janë lidhur 27 kontrata me operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Roskovec, të ciët nuk kanë hapur nipt sekondar në Bashkinë Roskovec si dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore, sipas paketës fiskale miratuar me Vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec nr. 93, datë 25.11.2021 për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022. Në mënyrë të detajuar *subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Roskovec 2022 për të cilët drejtoria e taksat dhe tarifave vendore nuk janë llogaritur taksat dhe tarifave vendore paraqiten në aneksin nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.*

Nr	Emërtimi i objektit	Operatori Ekonomik	Data e lidhje së kontratës	Afati i punimeve	Data e fillimit të punimeve	Leja e ndertimit
1	Rikonstruksioni i bibliotekes Publike Roskovec dhe krijimi i klubit Rinore te librit	"S." Shpk	02.03.2022	6 muaj	11.03.2022	
2	"Rikonstruksioni i Rruges Musa Sinani - Struga e Thate Suk 2	"S." Shpk	19.04.2022	6 muaj	02.08.2022	

3	" Fuqizimi i stacionit te pompimit te ujitjes nga lumi Seman, zona e suk - Hoxhenje"	"A." SHPK	26.07.2022	30 dite	02.08.2022	
4	Pastrimi, sistemimi dhe mbulimi me tumbino i kanalit K 25 permes fshatit Marinez	" Z." shpk	27.07.2022	2 muaj	09.08.2022	
5	Rruga "Bullazaret" 400 ml. +rruga "Doksaneve" 150 ml, fshati Kurjan (b=4m rerebituminoze + 2*0.5 bankina	"A." SHPK	12.09.2022	3 muaj	08.02.2023	nr .. dt 13.10.2022
6	Rikonstruksioni i rruges "Zogallaret" fshati Suk 2, 600 ml +rruga "Asllan Toska 670 ml, + rruget lidhese 189 ml b = 4 m rerebituminoze + 2*05 m bankine	"A." SHPK	12.09.2022	3 muaj	13.10.2022	nr dt 11.10.2022
7	Rikonstruksioni i rruges lagjia "Dortaj", fshati Vlosh	"A." SHPK	12.09.2022	3 muaj	14.10.2022	nr dt 11.10.2022
8	Rikonstruksioni i rruges Vidhishte-Kerranjaket,fshati Luar ,2060ml, b=4m rerebituminoze + bankina 2*0.5m	" B."SHPK	14.09.2022	3 muaj	11.10.2022	nr .. dt 11.10.2022
9	Permiresimi i banesave ekzistuese	"J." Shpk	06.10.2022	6 muaj	19.10.2022	Nr.. dt 23.10.2022
10	Rikonstruksioni i rruges "Shehallaret" Roskovec	BOE "G." shpk & "J." SHPK	11.10.2022	6 muaj	06.01.2023	nr ... dt 12.10.2022
11	Rikonstruksioni i rruges "Metushaj" Suk 1	" Z." shpk	05.10.2022	3 muaj	20.12.2022	nr .. date 25.11.2022
12	Rikonstruksioni i rruges "Zyka" Kuman	"S."Shpk	02.11.2022	6 muaj	06.02.2023	Nr... date 29.12.2022
13	Asfaltim trotuar + ndricim "Qani Kapo" Jagodine	" Z." shpk	11.10.2022	6 muaj	13.02.2023	nr ... date 25.11.2022
14	Rikonstruksioni i rruges "Shyqo Refati +Bashkimi Strum	" Z." shpk	15.09.2022	6 muaj	31.01.2023	Nr.... dt 11.10.2022
15	Rikonstruksioni i rruges "Kadri Ruko" Strum	"H." shpk	23.09.2022	6 muaj	12.10.2022	Nr.... dt 12.10.2022
16	Nderhyrje emergjente ne fshatin Ngjeqar	BOE "Z." shpk & "A." SHPK & "A." Shpk	13.10.2022	10 muaj	03.11.2022	nr ... date 02.11.2022
17	Sistemimi i qendres se Mbersit dhe i godines per sherbime komunitare	"K." shpk	19.10.2022	3 muaj	13.01.2023	nr ... date 25.11.2022
18	Rikonstruksioni i rruges Feta Agaci (Mulliri) Suk 1	"S."Shpk	01.11.2022	6 muaj	07.02.2023	nr ... date 19.12.2022
19	Rikonstruksioni i rruges Cezmes	"M." Shpk	03.11.2022	3 muaj	17.01.2023	nr ... date 19.12.2022
20	Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare Suk 1	BOE "A."SHPK & "S." Shpk	03.11.2022	6 muaj	05.12.2022	
21	Rikonstruksioni catis se shkolles 9 vjecare Kuman	"A." SHPK	10.11.2022	3 muaj	02.12.2022	nr ... date 02.12.2022
22	Asfaltim i rruges Faik Kapo Roskovec	"A." SHPK	18.11.2022	3 muaj	20.12.2022	nr .. date 25.11.2022
23	Rikonstruksioni i rruges Vidhishte Drize	"H." shpk	11.11.2022	6 muaj	01.02.2023	nr .. date 19.12.2022
24	Sistemimi i qendres Marinez + ndertimi i rrethrotullimit	" Z." shpk	11.11.2022	6 muaj	13.02.2023	nr ... date 19.12.2022
25	Permiresimi i rrugeve te lagjeve dhe parcelave bujqesore	"A."shpk	05.12.2022	3 muaj	17.02.2023	nr .. date 30.12.2022
26	Nderthyrje emergjentene infrastrukture per mbrotje nga fatkeqesite natyrore sipas objekteve . Punime per veshjen e kanalit V-35 dhe portat hyrse ne V3, Punime per puseten e thithjes se stacionit te pompimit Hoxhenjt, Punime per hapjen e rruges ne pyellin e Vloshit	"F." Shpk	13.12.2022	3 muaj	13.12.2022	nr .. date 22.12.2022
27	Rikonstruksioni I KUL Roskovec	BOE "H." shpk & "M." SHPK	14.12.2022	1 muaj	17.01.2023	nr .. date 06.01.2023

Burimi i të dhënave: Bashkia Roskovec, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi rezultoi se, janë lidhur 27 kontrata me operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Roskovec, të ciët nuk kanë hapur nipt sekondar si dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore, që lindin ndaj Bashkisë Roskovec për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki.

Sektori i prokurimeve nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës.

Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të listuar në tabelën e mësipërme është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 “Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë Bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”, VKB nr. 93, datë 25.11.2021 për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022.

Kriteri: Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 “Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë Bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”, VKB nr. 93, datë 25.11.2021 për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022.

Impakti: E ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec nga aktiviteti i paligjshëm i subjekteve dhe mospagim të detyrimeve.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave në zbatimin e kuadrit ligjorë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi

Sektori i prokurimeve në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Roskovec, të marrin masa të menjëhershme për llogaritjen e vlerës së detyrimit sipas paketës fiskale nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Roskovec, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik.

➤ **Asetet e dhëna me qira**

Titulli i gjetjes 13: Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të aseteve.

Dhënia e aseteve të Bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;
- VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Bashkia Roskovec në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi⁶ për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre administron 11 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore të cilat janë lidhur përpara vitit 2022 dhe 1 kontratë është lidhur për vitin ushtrimor. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjisllacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 3 vjet deri në 99 vjet. Në mënyrë të përmbledhur kontratat paraqiten në tabelat në vijim:

Kontratat e lidhura nga Bashkia Roskovec për dhënien me qira të tokave

Nr.	Subjekti	Kontrata	Data	Afati në vite	Sipërfaqja në ha/m ²	Detyrimi Vjetor/Mujor në lekë	Debitor 2021	Debitor 2022

⁶ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

1	E. B. B.	Qera toke bujqesore	18.08.2021	99 vjet	4 ha	24000 lekë/vit	0	0
2	B. K.C.	Qera toke bujqesore	09.09.2021	99 vjet	1 ha	6000 lekë/vit	0	0
3	S. I.	Qera toke bujqesore	05.10.2010	33 vjet	1.14 ha	28600leke/vit	0	28600
4	L. G.	Qera toke bujqesore	23.05.2012	33 vjet	0.438 ha	10950 lekë/vit	0	0
5	B. S.	Qera toke bujqesore	02.01.2012	33 vjet	0.5615 ha	8422 lekë/vit	0	0
6	D. K.	Qera toke bujqesore	19.11.2013	10 vjet	0.85 ha	7040 lekë/vit	0	7040
7	A. S.	Qera toke bujqesore	05.11.2010	99 vjet	0.1725 ha	1640 lekë/vit	0	0
8	M. S.	Qera toke bujqesore	30.08.2010	99 vjet	2.5 ha	15000 lekë/vit	0	0
9	L. S.	Qera toke bujqesore	23.03.2012	30 vjet	20 ha	120000 lekë/vit	0	0
10	B. p.	Qera toke	08.01.2021	3 vjet	1.3153 ha	1315300 lekë/vit	0	0
11	B. p.	Qera toke	08.01.2021	3 vjet	0.9142 ha	914200 lekë/vit	0	0
12	A.. SH.P.K	Qera toke bujqesore	04.03.2022	35	3 ha	21000 lekë/vit	0	0
	Total					2 472 152	0	35 640

Burimi: Bashkia Roskovec, përpunoi grupi i auditimit

Kontratat e lidhura nga Bashkia Roskovec për shitje pasuri të paluajtshme

Lekë

Nr.	Subjekti	Kontrata	Data	Afati në vite	Sipërfaqja në m ²	Detyrimi Mujor në lekë	DEBITOR	
							2021	2022
1	F. K.	Kontratë shitje pasuri e paluajtshme	09.11.2020	30 vjet	84 m ²	7,465 lekë		
2	G. H.	Kontratë shitje pasuri e paluajtshme	29.03.2021	30 vjet	78 m ²	6,932 lekë		
3	M. B.	Kontratë shitje pasuri e paluajtshme	18.03.2021	30 vjet	65 m ²	6,932 lekë		
4	T. L.	Kontratë shitje pasuri e paluajtshme	23.03.2021	30 vjet	78 m ²	6,932 lekë		45,834
5	S. L.	Kontratë shitje pasuri e paluajtshme	23.03.2021	30 vjet	84 m ²	7,465 lekë		37,350
Totali detyrimeve nga mos pagesa e kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme							-	83,184

Burimi: Bashkia Roskovec

Situata: Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave për tokat bujqësore rezultojnë se 2 qiramarrës i nuk kanë paguar detyrimin sipas kontratës në vlerën 35,640 lekë për vitin 2022 e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Për kontratat e lidhura për shitje pasurie të paluajtshme rezultojnë që janë lidhur gjithsej 5 kontrata dhe 3 subjekte kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Roskovec, por për vitin 2022, janë 2 (dy) subjekte që nuk kanë paguar detyrimin për vlerën totale prej 83,184 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Roskovec nga mos arkëtimi i detyrimeve nga shitja e pasurive të paluajtshme.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Roskovec nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të shitjes nga subjektet qiramarrëse.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për arkëtimin e vlerave debitorë nga subjektet:

S. I. në vlerën 28,600 lekë;

D. K. në vlerën 7,040 lekë;

S. L. në vlerën 37,350 lekë;

T. L. në vlerën 45,834 lekë si dhe të ndiqet më përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave shitjes së pasurive të paluajtshme.

Për periudhën objekt auditimi dhe shkeljet e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi punonjësit e mëposhtëm:

- znj. D. D. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 15.01.2021 deri më 14.04.2022
- z. M. A. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 19.04.2021 deri më 03.11.2022
- znj. A. R. me detyrë Përgjegjse në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 02.09.2021 e në vijim
- z. M. P. me detyrë Përgjegjse në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 11.02.2022 e në vijim

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.

• ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Roskovec” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Fier si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

• ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Roskovec për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Roskovec pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

• ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Fier për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr. 2145 prot. datë 31.03.2023 konfirmuar nga Dega e Thesarit Fier. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Roskovec dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

• ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarit dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaku e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është në vlerën **4,123,104,959 lekë** dhe për vitin 2022 është **3,996,542,469 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 75,433,269 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 82,851,685 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 75,433,269 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 82,851,685 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit si dhe rakordon me rubrikën analoge “Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022”. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën **82,851,685 lekë**, e cila rakordon me gjendjen në rubrikën analoge “Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **82,851,685 lekë** në Formatin nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022” në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **21,229,730 lekë** dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **26,602,594 lekë**, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej **5,372,864 lekë** rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,735,936 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 5,407,557 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 671,621 lekë, e cila përfaqëson shtesat e gjendjes së mallrave në fund të vitit 2022 e analizuar.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 16,493,794 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 21,195,037 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 4,701,243 lekë, e cila përfaqëson shtesat e gjendjes së mallrave në fund të vitit 2022 e analizuar.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 183,416,619 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 187,277,448 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i mos kryerjes se pagesave ndaj kreditorëve të ndryshëm në lidhje me investimet dhe shërbimet e ndryshme.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 172,057,183 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 176,090,570 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 4,033,387 lekë e cila vjenë si rezultat i rritjes së debitorëve të qirave, etj. Analiza e gjendjes së llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në aneksin nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Titulli i gjetjes Kontabilizimi i gabuar i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Situata: Nga analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore familjarë dhe biznesi në vlerën **166,380,720 mijë lekë**, nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **21,845,762 lekë** për 758 persona, si dhe nuk janë përfshirë gjjobat e vendosura nga IMT –ja dhe Policia Bashkiake në vlerën 1,043,000 lekë të akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2022, vlerë e cila nuk është kontabilizuar. Në mënyrë të detajuar gjjobat e IMT –ja dhe Policisë Bashkiake paraqiten si vijon:

N r	Emërtimi i gjobës	Gjobapër vitin 31.12.2021						Gjobapër vitin 31.12.2022					
		Gjoba te vendosura		Gjoba te paguara		gjoba për tu paguar		Gjoba te vendosura		Gjoba te paguara		gjoba për tu paguar	
		nr	vlere	nr	vlere	nr	vlere	nr	vlere	nr	vlere	nr	vlere
1	S. Z.	2	2000	2	2000								
2	K. H.	2	4000			2	4000						
3	G. shpk	1	5000	1	5000								
4	M.	1	105000	1	105000								
5	J. B.	1	1000	1	1000								
6	A. X.	1	3000			1	3000						
7	T. B.	1	2000			1	2000						
8	P. T.	1	110000			1	110000						
9	J. S.	1	300000	1	300000								
10	A. Y.							2	40000	-		2	40000
11	A.M.							1	1000	1	1000		
12	Y. V.							1	1000			1	1000
13	B. H.							1	1000	1	1000		
14	E. X.							1	1000	1	1000		
15	L.K.							1	500000	1	500000		
16	F.R. C.							1	50000	1	50000		
17	Sa. L.							1	500000			1	500000

18	S. shpk, G. shpk					14	280000	14	285600		
19	S.					1	500000			1	500000
20	N. P.					1	50000	1	50000		
21	E. M.					1	2000			1	2000
22	Y.B.					2	5000	2	5000		0
23	N. B.					1	50000	1	50000		
24	E. Shpk					1	300000	1	300000		
	Totali		532,00 0	413,00 0	119,00 0		2,281,00 0		1,243,60 0		1,043,000

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Kriteri: Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22.

Ndikimi: Mos funksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuar, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Roskovec të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 "debitorë të ndryshëm", në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë por të ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

-Gjendja e llogarisë 4342 "Operacione me shtetin, të drejta" (debitorë) më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 11,186,878 lekë. Nga analiza e llogarisë **4342** "Operacione me shtetin, të drejta" për vitin 2022 është e analizuar si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2022 e llog 4342
1	Paga Personeli llogaria 42	7,621,636
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	557,460
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,124,246
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	294,788
5	Furnitorëllogaria.401-408	588,748
	Shuma	11,186,878

Nga analiza e llogarisë 4342 "**Operacione me shtetin, të drejta**" dhe vlerës të pasqyruara në **5 (pesë) llogarive pasive**, pra në vitin 2022 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime” dhe “gjendjen e llog “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,928,128,015 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,770,971,158 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,770,971,158 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,868,600 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 28,601,463 lekë, ku diferenca në ulje prej 17,732,863 lekë i përket lëvizjeve të aktiveve si dhe vlerës së amortizimit. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Situata: Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*", nga 22 projekte, nga të cilat për 21 projekte drejtorja e financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktiviteti afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kriteri:

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimet e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" **Pika 2. Klasa 2**, "Aktivitet afatgjatë" (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: "Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëposhtëm:

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

Aktivitet afatgjatë jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM"

Kreu II. "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" **Pika 16/b. d** të cilat përcaktojnë: "Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe

- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjatë, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës "b" më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjatë; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

Ndikimi/Efekti: Nuk paraqet një panoramë të qartë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë për sistemin e llogarive

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:

Drejtorja e Financës të marrë masa për sistemin e llogarisë (202) "Studime dhe kërkime", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

- **Gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene"** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 112,776,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 112,776,000 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës kontabël.

Nr	Vitet e blerjes	Emertimi I objektit	CELJE 01.01.2022	BLERE GJATE VITIT 2022	PAKESIME GJATE VITIT 2022	GJENDJA NE FUND 31.12.2022
1	para 2014	Toka,troje,terene Njësia Kuman	112,776,000	-	-	112,776,000

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Sektori i Regjistrimit të Pronave (SRP) të krahasuara me kartelat në kontabilitet të Drejtorisë Ekonomike për truallin nën objekt të objekteve të administruara në llog.(210) “Toka, troje terrene” u konstatua se; Bashkia Roskovec, sipas DRP ka në administrim gjithsej 38 objekte ndërtesa dhe konstruksione të ndryshme me sipërfaqe truall nën këto objekte prej 74,995 m², nga të cilat dokument të pronësisë (çertifikatë, apo vërtetim hipotekor) disponohen vetëm për 8 objekte me sipërfaqe truall nën këto objekt të objekteve prej 28,703 m², kurse për 30 objekte me sipërfaqe truall nën objekt të objekteve prej 23,303 m² nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie. Nga këto, Drejtoria Ekonomike ka të administruara në kontabilitet zero m² të truallit nën objekt të objekteve. Në këto kushte për mospërputhjet në administrimin për çdo truall të “Toka, troje, terrene” nga Bashkia Roskovec duhet që patjetër të kryejë sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, vlera e truallit dhe ndërtesave të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës(ASHK) Fier si dhe inventarizimi i trojeve me komision përkatës. Më poshtë po paraqesim tabelën e detajuar:

Nr	Emërtimi	Gjithsej		Të pa Regjistruara		Të Regjistruara	
		Nr. objekt	Sipërfaqe Truall	Nr. objekt	Sipërfaqe Truall	Nr. objekt	Sipërfaqe Truall
I	Bashkia Roskovec	10	18,337	8	9,565	2	8,768
II	Njësiti administrative	28	56,658	22	13,738	6	19,935
1	Njësia Administrative Strum	8	26,224	8	3,239	-	-
2	Njësia Administrative Kuman	8	24,024	6	5,749	2	18,275
3	Njësia Administrative Kurjan	12	6,410	8	4,750	4	1,660
	Shuma gjithsej	38	74,995	30	23,303	8	28,703

Shënim: Të dhëna të marra nga Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave, Bashkia Roskovec.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llog 210 “Toka, troje terrene” rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2022.

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto 264,656,900 lekë në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 269,666,100 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 269,666,100 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës kontabël si vijon:

Nr	VITET	Emertimi I objektit	CELJE 01.01.2022	BLERE GJATE VITIT 2022	SHTESA TE TJERA GJATE VITIT	PAKESIME GJATE VITIT 2022	GJENDJA NE FUND 31.12.2021
1	2017	Blerje peme dekorative dhe shkurre	192,000				192,000
2	2021	Pyllezime	2,289,600				2,289,600
3	2021	Blerje peme dekorative dhe shkurre	1,912,800				1,912,800
4	2021	Pyje dhe kullota kaluar ne pronësi me VKM r. 433, datë 8.6.2016	260,262,500				260,262,500
5	2022	Pyllezime		952,800			952,800
6	2022	Pyllezime		296,400			296,400
		SHUMA	264,656,900	1,249,200	0	0	265,906,100

Burimi: Drejtoria e financës

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 843,273,458 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 831,027,163 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,007,636,685 lekë, në mënyrë kontabël paraqitet në aneksin nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportin e auditimit.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,645,073,183 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,471,337,015 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlerën neto)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,459,257,994 lekë Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 748,337,568 leke, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj si dhe janë transferuar Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimet Roskovec Sh.A vlera neto 474,506,278 lekë sipas tabelës vijuese. Amortizimi për vitin 2022 është llogaritur 709,945,140 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në aneksin nr. 6 pika 3 bashkëlidhur raportin e auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,299,415 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 10,421,564 lekë e cila është e analizuar sipas vlerës kontabël sipas në aneksin nr. 7 pika 3 bashkëlidhur raportin e auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,582,101 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 36,786,462 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 44,819,881 lekë, vlera e amortizimit të akumuluar është 12,821,419 leke. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2021 deri në fund të vitit 2022 paraqiten në aneksin nr. 8 pika 3 bashkëlidhur raportin e auditimit.

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 50,466,958 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 38,956,855 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 83,687,187 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përlllogaritur është në shumën 39,942,332 lekë.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Rrjeshti	Nr. Reference	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I.AAGI/JO MATERIALE	28,601,463	15,814,875	12,786,588	0	1,917,988	0	0	28,601,463	17,732,863	10,868,600
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	28,601,463	15,814,875	12,786,588		1,917,988			28,601,463	17,732,863	10,868,600
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashm	0	0	0					0	0	0
5	21-28	II.AAGI/ MATERIALE	3,943,014,696	1,014,886,681	2,928,128,015	229,274,952	386,340,608	26,620,553	26,529,353	4,145,669,095	1,374,697,936	2,770,971,158
6	210	Toka,troje, Terene	112,776,000	0	112,776,000	0		0		112,776,000	0	112,776,000
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	264,656,900	0	264,656,900	5,009,200		0		269,666,100	0	269,666,100
8	212	Ndertime e Konstruksione	977,719,307	134,445,849	843,273,458	29,917,378	42,163,673	0		1,007,636,685	176,609,522	831,027,163
9	213	Rruge,rzjete,vepra ujore	2,459,257,994	814,184,811	1,645,073,183	155,278,468	329,014,637	0		2,614,536,462	1,143,199,448	1,471,337,015
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	8,114,220	1,814,805	6,299,415	4,523,760	310,411	91,200		12,546,780	2,125,216	10,421,564
11	215	Mjete transporti	31,757,100	26,174,999	5,582,101	32,320,781	5,904,420	19,258,000	19,258,000	44,819,881	12,821,419	31,998,462
12	216	Rezerva shtetore	0	0	0	0		0		0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0		0		0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	88,733,175	38,266,217	50,466,958	2,225,365	8,947,468	7,271,353	7,271,353	83,687,187	39,942,332	43,744,855
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	0	0	0	0		0		0	0	0
16	28	Caktime	0	0	0	0		0		0	0	0
17		TOTAL I(I+II)	3,971,616,159	1,030,701,556	2,940,914,603	229,274,952	388,258,597	26,620,553	26,529,353	4,174,270,558	1,392,430,800	2,781,839,758

Testi substancial i amortizimit

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme “pika 36.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për aktiv sipas klasifikimit.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 657,316,090 lekë dhe më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 657,316,090 lekë që i përket kontabilizimit të aksioneve të Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Roskovec.

➤ Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **410,451,670** lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **305,036,679** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 762,867 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 588,748 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 7,621,636 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhet në Janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 557,460 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 2,124,246 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 294,788 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuarra për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 57,303,684 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 60,711,580 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në Degën e Thesarit Fier në mënyrë analitike, e cila paraqitet në aneksin nr. 9 pika 3 bashkëlidhur raportin e auditimit.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet në aneksin nr. 10 pika 3 bashkëlidhur raportin e auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën **718,999,121** lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Fier paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 204,010,807 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 131,067 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 124,823,693 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 79,056,047 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 7,462,278 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 2,885,671 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 4,555,225 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën **669,859,016** lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën **104,243,655 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **104,243,655 lekë** diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën **17,053,254 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën **17,053,254 lekë** , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **47,630,424 lekë** dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën **47,630,424 lekë** , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **124,012,220 lekë** dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **186,684,868 lekë**, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2022 totali i te ardhurave ne vlere është **718,999,121 lekë** dhe totali shpenzimeve është **696,859,016 lekë**. Diferenca e tyre në vlerën **22,140,105 lekë** rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën - 5,372,864 lekë .

B- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Roskovec).

Tabela e punonjësve për Bashkinë Roskovec

Nr.	Emërtimi	Viti 2022			
		01.01-2022		31.12.2022	
		P	F	P	F
1	Kryetar	1	1	1	1
2	Zëvendës Kryetar	2	2	2	2
3	Administrator Njesisë	3	3	3	3
4	Drejtor kabinetit	1	1	1	1
5	Këshitar i Kryetares	4	1	4	1
6	Sekretar Këshilli	1	1	1	1
7	Sekretar I përgjithshëm	1	1	1	1
8	Drejtorit	9	6	9	6
9	Përgjegjës	17	17	17	17
10	Specialist	46	45	46	43
11	Punonjës te zjarrfikëses	14	12	14	13
12	Punonjës te gjendjes civile	4	4	4	4
13	Arsimi parashkollor (Edukatore)	34	34	34	31
14	Punonjës mbështetës	43	43	43	42

15	Punonjës policie	7	6	7	6
	TOTALI	187	177	187	172

Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2022 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. **22** datë **01.02.2022**. Miratuar në total numri **183** punonjësit të dhe **4** Gjendjes Civile = **187** punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej në **Janar 2022 177 punonjës dhe Dhjetor 2022 ,172 punonjës për shkak të largimit të punonjësve ne vende të tjera punë** , nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Roskovec , është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve Janar 2022 dhe Dhjetor 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. S. Ç. dhe nga Specialistet e pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë; M. B.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore O. B.-V. Z. dhe nga Kryetari Bashkisë M. B. .

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkuara nga përpiluesi, për vitin 2022.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar 2022 dhe Dhjetor 2022) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkuara nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore **O. B.-V. Z.** Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, ” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Roskovec, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Roskovec, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar 2022 dhe Dhjetor 2022) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. S. Ç. nga Specialistet e pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë; M. B.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore znj. **O. B.** - znj. V. Z. dhe nga Kryetari Bashkisë znj. M. B.

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, janë bërë ndalesa edhe për debitorët të përcaktuar në Urdhret përkatës. (Te vendosura nga Përmbarimi apo palë të tjera.)

✓ Në bazë të urdhrat i Kryetarit nr. prot 5366, 25.05.2022 mbi debitorët punonjësve të Bashkisë Roskovec si dhe ndërmarrjen ne varësi ne shumen totale 763,407 leke detyrime te prapambetur te viteve 2021-2022 te cilat janë mbajtur nga paga e punonjësve nga muaji Maj- Korrik 2022.

Paraqitja në formë tabelle e burimit të Financimit.

000/lekë

Periodha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2022	207,127	199,818	96.47	62,122	82,600	3,090	52,006

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë

000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2022		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	178,183	171,666	96.34
2	F. Sig. Shoq	28,944	27,776	95.96
3	F. Veçantë		376	

B.3 - Respektimi i dispozitave ligjore për kohëzgjatjen e kohës së punës, pagesa për orë jashtë orarit të punës etj.

- Pagesa për ore suplementarë për punonjësit e sektorit e MZZH-se .

1-Urdher nr. 163 date 25.07.2022(Për orët shtese ne muajin Qershor 2022)

Orë gjithsej 69 vlera 31,853 leke .

2-Urdher nr. 180 date 19.08.2022(Për orët shtese ne muajin Korrik 2022)

Orë gjithsej 185 vlera 79,887 leke

3-Urdher nr. 124 date 26.09.2022(Për orët shtese ne muajin Gusht 2022)

Orë gjithsej 79 vlera 34,783 leke

4-Urdher nr. 252 date 1.11.2022 (Për orët shtese ne muajin Shtator 2022)

Orë gjithsej 202 vlera 91,142 leke

Fond i veçantë për punonjës qe kane dale ne pension

- 1-Urdher nr. 12-13-14-16 date 31.01.2022 fondi 289,500 leke

- 2- Urdhër nr.198 date 15.09.2022 , shpërblim për raste sëmundjeje 50,000 leke

- 3- Urdhër nr.227 date 07.10.2022 shpërblim për raste te daljes ne pension 36,800 leke .

Veprimet nëpërmjet magazinës

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.

- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit

në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Roskovec". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, është bërë brenda afateve të përcaktuara.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Roskovec (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Për vitin 2022: Bashkia Roskovec ka zhvilluar gjithsej **36** procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit: **296,665,981** lekë TVSh, vlerë të kontratës: **263,251,958** lekë TVSh, diferencë midis tyre prej: **33 414 023** lekë TVSh.

-“E Hapur e thjeshtuar”, **27** procedura, me fondin limit në total prej: **124 575 387** lekë pa TVSh, kontrata të lidhura **109 238 819** pa TVSh në total prej: **lekë TVSh**, duke kursyer shumë prej: **15 336 568** lekë.

-”Tender i Hapur”, **4** procedura, me fondin limit në total prej: **158,247,586** lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej: **140,433,663** lekë pa TVSh, duke kursyer shumë: **17,813,923** lekë pa TVSh .

- Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, **5** procedura, me fondin limit në total prej: **13,843,008** lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej: **13,579,476** lekë pa TVSh, duke kursyer shumë prej: **263,532** lekë pa TVSh .

- Shërbim konsulence, **1** procedura, me fondin limit në total prej: **833 333** lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej: **672,098** lekë TVSh, duke kursyer shumë prej: **161,235** lekë pa TVSh.

-“Blerje me vlerë të vogël”, **45** procedura, me fondin limit në total prej: **17,233,174** lekë pa TVSh, kontrata të lidhura në total prej : **14,651,460** lekë pa TVSh, duke kursyer shumë prej: **2,581,714** lekë pa TVSh;

Viti 2022					
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
<i>Procedurë e hapur;</i>	4	158,247,586	140,433,663	17,813,923	11.26%
<i>Procedurë e hapur e thjeshtuar;</i>	27	124,575,387	109,238,819	15,336,568	12.3%
<i>Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës</i>	5	13,843,008	13,579,476	263,532	1.9%
<i>Shërbim konsulence;</i>	1	833 333	672 098	161 235	19.3%

Prokurim me vlerë të vogël.	45	17,233,174	14,651,460	2,581,714	14.98%
SHUMA		313,899,155	277,903,418	35,995,737	11.5%

Procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2022 janë si më poshtë vijon:

1. Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje kamion për mbledhjen e mbetjeve dhe kontenier”.					
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” REF-Urdhri nr. 3757 prot., datë 06.05.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 3293, datë 20.04.2022 1. .D. G. 2. . M. P. 3. E. H.	2 Njësia e Prokurimit 1. .A. X. 2. .S. Ç. 3. .E. H.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 5078 prot., datë 16.05.2022. 1. .K. L. 2. .M. L. 3. .Z. C.	4. Fondi Limit (pa TVSh) 9,941,250 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: T 9,735,000 lekë pa TVSh.
7 Data e hapjes së tenderit: Data 26.05.2022 ora 09:00 Afati 4 muaj	8. Burimi Financimit Ambasades Japoneze (Donacion)		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE	10.Ankimime AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 6194 prot., datë 24.06.2022
			12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK S’ka		

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Situata

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogarritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 3293 prot., datë 20.04.2022 “Për krijimin e komisionit të llogarritjes së fondit limit”, i përbërë nga znj. D. G., Ekonomiste, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në Ndërmarrjen e Pastrimit Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave z. M. P., Ekonomist, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave dhe znj. E. H., Inxhinierë Gjeomjedisi, me detyrë .Përgjegjës e sektorit të lejeve të ndërtimit. Konstatohet se anëtarët e komisionit nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet çka bie në kundërshtim me Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar pika 42 dhe 43 ku citohet:

“42. Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues”.

“43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjës të materialit”.

Sipas procesverbalit nr. 3293/1 prot., datës 27.04.2022, të mbajtur për efekt të pasqyimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogarritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit,

ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë **9,941,250 lekë** pa TVSh.

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr. 3757 prot., datë 06.05.2023 “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, znj. A. X. anëtarë me profesion “Jurist”, z. S. Ç. anëtar me profesion “Ekonomist” dhe z. E. H. anëtar me profesion “Inxhinier”. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbal me nr. 3757/1 prot., datë 13.05.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej znj. A. X. anëtarë me profesion “Jurist”, z. S. Ç. anëtar me profesion “Ekonomist” dhe z. E. H. anëtar me profesion “Inxhinier”, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 13.05.2022, të cilat janë si më poshtë:

Në pikën 2.3.5 të DST (kriteret e veçanta) është kërkuar:

a) Mjetin në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje) ose kur Mjeti është i porositur do të shoqërohet me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar).

b) Dokumentacionin përkatës të rregullt të mjetit si certifikata origjinale e mjetit etj. Formulimi i kriterit për “Dokumentacionin përkatës të rregullt të mjetit” në këtë mënyrë nuk është i saktë dhe i plotë, sepse nuk ka përcaktuar se cilat janë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomik për të përmbushur kriterin e kërkuar. Është detyrë e njësisë së prokurimit, të përcaktojë dokumentet që duhet të dorëzojnë operatorët ekonomik për çdo kriter të vendosur në DST. Pra cili është dokumentacioni ligjor që duhet të paraqesin operatorët ekonomik në mënyrë që autoriteti kontraktor të garantohet për furnizimin me mallin e kërkuar? Cili është dokumenti që duhet të paraqesin operatorët ekonomik që vërteton se për mjetin janë paguar të gjitha detyrimet doganore në RSH? Këto duhet të përcaktohen në DST nga njësia e prokurimit.

Hartimi i pasaktë, i pa plotë i kriterit të mësipërm, bënë që të jenë të pa qartë operatorët ekonomik për llojin e dokumentit që do të dorëzojë, si dhe të jetë i pa qartë komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë kualifikimit dhe vlerësimit të ofertave, duke lënë shkak për interpretime të ndryshme, pa u mbështetur në një standard të caktuar, i cili është dokumenti që duhet të përcaktohet në DST, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 40, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, ku thuhet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo 38 rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriereve”.

Në pikën 2.3.6 të DST është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie, që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjeteve, për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet”. Nga sa më sipër konstatohet se njësia e prokurimit ka vendosur kriterin se në deklaratën e garancisë të jenë të përcaktuara qartë të gjitha kushtet e garancisë teknike të mjetit, por nga auditimi i DST, konstatohet se nuk janë parashikuar se çfarë kriteri përfshihet në kushtet e garancisë teknike të mjetit. Që operatori ekonomik të jap deklaratë se plotëson disa kushte/kriere, duhet më parë që këto kushte/kriere të jenë përcaktuar në DST. Një mangësi e tillë në DST vështirëson vendimmarrjen e KVO dhe lë hapësira për interpretime të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave. Mos përcaktimi i kriereve të cilat përbëjnë kushtet e garancisë teknike të mjetit, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 40, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, ku thuhet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë

në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

Në lidhje me “Argumentimin e specifikimet teknike dhe preventivi”:

Specifikimet teknike dhe preventivi është hartuar nga KLLFLST, dorëzuar dokumentacioni teknik si preventivi+ specifikimet teknike të mallit me procesverbalin e komisionit nr.3293/1 prot., datë 27.04.2022 dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave si vijon:

Nr.	Specifikimet teknike për kamionin:
1	Viti i prodhimit 2021 ose 2022 (me 0 km).
2	Motori I kamionit duhet të jetë diesel me 4 cilindra ose më shumë se 4.
3	Pesha maksimale e kamionit me ngarkesë të jetë 7000 kg - 9900 kg.
4	Kamioni duhet të jetë I pajisur me kompaktor të mbyllur për heqen e mbetjeve urbane.
5	Kapaciteti mbajtës të jetë 7 - 8 m3.
6	Kompaktori duhet të jetë I pajisur me mekanizëm për kontinier plastik dhe metalik 1100 L.
7	Norma e kompaktimit 1:3 - 1: 6.
8	Trashsia e fletës metalike te kompaktorit të jetë 3 mm + , dhe rezistente ndaj grryerjes.
9	Shkallë dhe doreza për qëndrimin dhe mbajtjen e punëtorve.
10	Ndricim në pjesën e pasme për mbledhjen e mbetjeve gjatë natës.
11	Kamerë në pjesën e pasme dhe monitor në gabinen e shoferit.
12	Depozit për ujin e ndotur të mbetjeve dhe zorrë shkarkimi.
13	Ganxha në dyshemenë e trupit për të lejuar ngritjen në rast të mirëmbajtjes ose riparimit.
14	Garanci 1 deri 2 vite per gabime montimo ose materiali.
	Specifikimet teknike për koshat:
1	Kontinieret duhet të jenë të rinjë
2	Materiali Plastikë
3	Kapaciteti mbajtës 1100 L.
4	Të pajisur me kapak dhe doreza për hapjen e kapakut.
5	Numri I rrotave 4
6	Levizja e rrotave 360 gradë
7	Sistem frenimi të paktën në dy rrota (përpara ose pas)
8	Doreza për aksesimin nga puntorët dhe për ngritjen nga mekanizmi i kompaktor.

Në shtojcën 5 të specifikimeve teknike në DST Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike ku citon: “*Viti i prodhimit 2021 ose 2022 (me 0 km)*”. Ky specifikim është i pa argumentuar teknikisht dhe ligjrisht pasi kufizon pjesëmarrjen e OE të cilët disponojnë mjete të vitit të prodhimit më të hershëm se viti i përcaktuar mësipër që mjete objekt prokurimi duhet të ketë për të përmbushur qëllimin në kundërshtim me nenin 78 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar. Është sugjeruar edhe na APP, nëpërmjet e-mail it zyrtar, dërguar AK, por këto sugjerime nuk janë reflektuar nga njësia e prokurimit referuar procesverbalit me nr. 5377 prot., datë 25.05.2022. Sa më sipër për kritere të vendosura në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJHDT.

Kriteri:

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP.**

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të jap argumentim për çdo kriter të veçantë për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik dhe jo vetëm, të vendosur në DST dhe argumentet të dokumentohen me procesverbal.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 5557 prot., datës 01.06.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	L. SHPK	9,550,000	S'kualifikuar Në DST është kërkuar që mjeti të jetë i vitit 2021-2022 me kilometra 0 (zero). KVO pasi hapi sistemin elektronik konstatoj se operatori ka ngarkuar në sistem dokumentacion dhe foto për mjetin i cili është i vitit 2004. Ky kriter nuk u përmbush nga Operatori Ekonomik. Në DST është kërkuar Operatori ekonomik duhet të paraqesi bilancin vjetor , për vitin 2021 të konfirmuar me vule pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) KVO pasi hapi sistemin elektronik konstatoj se operatori ka ngarkuar në sistem bilancin për vitin 2021 por mungon vula nga Drejtoria e Tatimeve. Ky kriter nuk u përmbush nga Operatori Ekonomik.
2	T SHPK	9,735,000	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës nr. 5953 prot., datë 16.06.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 OE, është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 16.06.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “T” SHPK për të cilën është lidhur kontrata me nr. 6194 prot., datë 24.06.2022 për vlerën 9,735,000 lekë pa TVSH dhe vlera 11,682,000 lekë me TVSH, dhe me afat 4 (Katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit Ekonomik të shpallur fitues “T” SHPK, me ofertë për vlerën 9,735,000 lekë pa TVSH dhe vlera 11,682,000 lekë me TVSH, dhe me afat 4 (Katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës, arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

Lidhja dhe sigurimi i kontratës

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar sigurim për ekzekutimin e kontratës, në vlerën 10 % e vlerës së kontratës. Në datën 24.06.2022 është bërë lidhja e kontratës midis AK dhe shoqërisë “T” ShPK, në vlerën 11,682,000 lekë (me TVSh).

Në datën 17.06.2022 nga shoqëria “T” ShPK është bërë sigurimi kontratës në vlerën 1,168,200 lekë, ose në masën 10% e vlerës së kontratës, në përputhje me DST.

Marrja në dorëzim e mjetit

Për marrjen e mjetit në dorëzim nga Titullari i AK ka dalë urdhri nr.234, datë 12.10.2022, nr.9192 prot., “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave me object blerje kamion për mbledhjen e mbetjeve dhe kontejner”, në të cilin është përcaktuar komisioni i përbërë nga: znj. D.

G., Ekonomiste, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në Ndërmarrjen e Pastrimit Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave, z. A. D., Agranom, me detyrë Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. S. K., Drejtësi, me detyrë Specialiste për Strehimin Social/Çështje Ligjore, Referuar urdhrin nr.234, datë 12.10.2022, nr.9192 prot., të Titullarit të AK “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave me objekt “Blerje kamion për mbledhjen e mbetjeve dhe kontenier”, konstatohet se anëtarët e komisionit nuk janë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet cka bie në kundërshtim me Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar pika 42 dhe 43 ku citohet:

“42. Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar”.

“43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Titullarin e AK.

Në urdhrin është përcaktuar: **“Komisioni ngarkohet për kontrollin fizik të mjetit nëse është sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit”**.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm komisioni me nr. 9192/1 prot., në datën 12.10.2022 ka mbajtur procesverbalin e marrjes në dorëzim të 50 kontejnerëve plastic dhe mjetit tip ISUZU, kamion për mbledhjen e mbetjeve.

Nga komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit në procesverbalin e mbajtur prej tij, me të dhënat e specifikimeve teknike të DST, konstatohet se:

-nuk është përcaktuar qartë marrja në dorëzim e mjetit, pasi nuk janë përcaktuar fazat nëpër të cilat do të kalojë ky proces. Në DST është përcaktuar se: Kontrolli fizik i mjetit për përputhshmërinë e specifikimeve teknike të kërkuara në DST do të bëhet pas lidhjes së kontratës brenda 10 ditëve nga lidhja e saj.

Si fazë e parë duhet të jetë dorëzimi i mallit pranë Autoritetit Kontraktor dhe verifikimi prej këtij të fundit nëse specifikimet teknike të mjetit përputhen më ato të kërkuara në DST, si dhe kolaudimi i mjetit nga AK (kryerja e provave të nevojshme të funksionimit të mjetit, etj.).

Si fazë e dytë, pasi të jetë verifikuar se automjeti është në përputhje me specifikimet teknike, automjeti merret në dorëzim provizorisht nga Autoriteti Kontraktor dhe lidhet kontrata.

Si fazë e tretë, dorëzimi në mënyrë përfundimtare e mjetit dhe hartimi i procesverbalit përfundimtar midis AK dhe OE.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim të mjetit: znj. D. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në Ndërmarrjen e Pastrimit Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave, z. A. D., me detyrë Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. S. K., me detyrë Specialiste për Strehimin Social/Çështje Ligjore,

2. Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave Ekzistuese”.				
1. Lloji/Urdhri i Procedurës Prokurimit “E hapur e thjeshtur” REF-39101-08-17-2022 Urdhri nr. 7326 prot., datë 11.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 7202, datë 04.08.2022 4. A. D. 5. E. H.	2 Njësia e Prokurimit 1. Z. S. 2. E. T. 3. S. P.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 7847 prot., datë 24.08.2022 1. K. L. 2. M. L.	

	6. K. G.		3. Z. Ç.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 10 366 044 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: J.” SHPK” 9 534 932 lekë pa TVSh.	6. Diferenca me fondin limit 831 112 lekë pa TVSh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data .29.08.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.+Të ardhurat e Bashkisë	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 4 OE b) S’kualifikuar 2 B/OE , c) Kualifikuar 2 B/OE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: ditë			
10.Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 9069 prot., datë 06.10.2022	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK	

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogarritjen e Fondit Limit” :

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr. 7202 datë 04.08.2022“Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, A. D.-Inxhinier E. H.-Inxhinier K. G.-Ekonomist Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 7202/1, datë 05.08.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Situata 1

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej1. Z. S.-Juriste, E. T.-Ekonomiste , S. P.-Inxhinierë të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 18.08.2202, të cilat janë si më poshtë;

1. Në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, në DT është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Autoritetet Kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NP1 - A** (Punime gërmimi ne toke)
- **NP3 - A** (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e speciale, veshje fasada
- **NS2 - A**(Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.)
- **NS4 - A** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale
- druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.)
- **NS14- A** (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.)

-Referuar projekt preventivit të punimeve, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

2. Në pikën 2.3.4 të DT është kërkuar që: Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të ketë inxhinier drejtues teknik të përfshirë në Licencën e shoqërisë së ndërtimit si më poshtë:

- *Inxhinier Ndërtimi I (një)*
- *Inxhinier elektrik I (një)*

Për punonjësit me sipër duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si të figurojnë në listepagesat e shoqërisë .

- Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit, nuk argumentohet periudha e vendosur për punonjësin e mësipërm dhe si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Gjykojmë se kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale, lidhur me disponimin e inxhinierëve, ezarohen duke kërkuar disponimin e tyre gjatë pjesëmarrjes në procedurë, përfshirjen e tyre si drejtues teknik. Gjithashtu sqarojmë se një inxhinier që të jetë drejtues teknik në një shoqëri duhet të ketë minimalisht 5 vite/3 vite pune eksperiencë (jo me të njëjtën shoqëri për 3/5 vite)⁷. Në këto kushte inxhinieri mund të ketë mbi 5 vite pune eksperiencë, si dhe 1 muaj që është i punësuar në një subjekt që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, pra nga OE plotësohet kërkesa për inxhinierin, duke dorëzuar edhe licencën e kërkuar (ku inxhinieri/ët të jenë drejtues teknik) e cila tregon se OE është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Vendosja e kërkesës të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

3. Në pikën 2.3.6 të DT është kërkuar që: Operatori ekonomik duhet të vetëdeklaroj mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona vetshkarkues kapac mbajtes 15-20 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetshkarkues kapac mbajtes deri 10ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinxh	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamioncine deri në 3 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere kantieri-2.5-3.5 m3	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobote uji	2 cope	Pronësi ose me qera

- Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve për kamion vetëshkarkues 15-20 ton (1 copë), si dhe kërkohet kamionçinë kapaciteti maksimal mbi 10 ton (2 copë). Gjithashtu theksojmë se transportimi i materialeve hidraulike, elektrike, pllakave, dritareve, etj ... nuk do të kryhet brenda të njëjtës ditë, pasi janë punime të cilat shtrihen në kohë të ndryshme (gjashtë muaj) dhe në këto kushte një kamion/kamionçinë mund të kryej disa rrugë dhe të realizohet qëllimi.

- Gjithashtu nuk është argumentuar teknikisht 2 Autobote uji, pasi referuar pajisjeve ndihmëse janë kërkuar 3 depozita uji me kapacitet 3000 ml, pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë sipas përcaktimeve të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

⁷ Shkronja “a” pika 1 në Kreun IV të VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Situata 2

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 7818, të datës 01.09.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"L." SHPK	9 127 534	S'kualifikuar; <i>1.Në DST kapaciteti teknik pika 2.3.8 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesin certifikata te vlefshme të cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara sipas standarteve :</i> Certifikate ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë Certifikatë ISO 45001-2018 Standart për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë ne Pune Ky kriter nuk është përmbushur nga OE (mungojnë certifikatat Iso) 2.Sigurimi i ofertës nuk është sipas përqindjes së kërkuar në ligj me vlerën 2% të fondit limit Ky kriter nuk është përmbushur nga OE(vlera është e vogël)
2	"J." SHPK	9,534,932	kualifikuar;
3	"F." SHPK	9 840 750	kualifikuar
4	"I." SHPK	10 004 012	S'kualifikuar; <i>Komisioni i vlerësimit të ofertave pasi hapi sistemin elektronik për këtë procedurë prokurimi konstatoj:</i> Sigurimi i ofertës nuk është sipas përqindjes së kërkuar në ligj me vlerën 2% të fondit limit . Ky kriter nuk është përmbushur nga OE (vlera është e vogël)

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 8642, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 2 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 22.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "J." SHPK" për të cilën është lidhur kontrata datë 06.10.2022 për vlerën 9,534,932 lekë pa TVSH dhe vlera 11,441,918 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht⁸, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Sa i përket mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se OE nuk plotëson pikën 2.3.6 për:
1.Kamion vetëshkarkues, me targë AA...FJ, siguracioni i dorëzuar fizikisht në muajin Tetor 2022, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:1430 dhe Nr.Kol:652 me subjektin "L. G.", por ky subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

⁸ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

2. Autovinc, me targë AA...VH dhe mjete me targa AA...DR, siguracioni i dorëzuar fizikisht në muajin Tetor 2022, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:2764 dhe Nr.Kol:1074 me subjektin “A. Q.”, për këto mjete nuk janë paraqitur certifikatat për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

3. Kamion vetëshkarkues, me targë FR...B dhe mjete i llojit MT me targa AEMT, siguracioni i dorëzuar fizikisht në muajin Tetor 2022, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:2815 dhe Nr.Kol:1090 me subjektin “L. G.”, për këto mjete nuk janë paraqitur certifikatat për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

4. Autoboti i ujit me targë AA...GH, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:734 dhe Nr.Kol:297/2 me subjektin “D. N.”, por ky subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quket përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjete;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjete dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.
7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.
8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.
- 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”. Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, certifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikaten përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z. K. L. Kryetar, z. M. L. dhe znj. Z. Ç. Anëtar.

Kriteri:

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP dhe KVO.**

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

3. Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i Shkolles 9-vjecare 5 Deshmoret ,Suk 1,Ambjenteve sportive dhe Ndertimi i palestres ,Bashkia Roskovec.”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E Hapur” REF-39373-08-19-2022 Urdhri nr. 64 prot., datë 11.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Kontrate dhurimi : Nr.3993prot,datë11.08.2020	2 Njësia e Prokurimit 1. K. G. 2. E. T. 3. S. P. 4.A. D. 5.Z. S.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 7650 prot., datë 24.08.2022 1. K. L. 2. M. L. 3. Z. C. 4.S. Ç. 5.E. K.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 78 583 225 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: BOE:”A.”& “S.” SHPK 67 282 494 lekë pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit 11 300 731 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data :07.09.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit +Buxheti i Bashkise		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 4 OE b) S’kualifikuar 0 B/OE , c) Kualifikuar 4 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj			
10.Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 9840 prot., datë 03.11.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlogarritjen e Fondit Limit” :

Dokumentacioni teknik i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare 5 Deshmoret, Suk 1,Ambjenteve sportive dhe Ndërtimi i palestrës ,Bashkia Roskovec.

”konstaton me kontratë dhurimi nr. Nr.3993prot,datë11.08.2020 e lidhur ndërmjet palëve :G. i cili më poshtë do të quhet “Dhures” dhe Bashkia Roskovec, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj, M. B. që më poshtë do të quhet “Përfitues i dhurimit”.

Anëtarët pranuan specifikimet teknike të hartuara nga shoqëria private me përfaqësues "G." sh.p.k, duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve për realizimin e objektit të prokurimit .

Përfaqësuesi i shoqërisë për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivit është bazuar në VKM-në nr.629,Datë15.07.2015”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre1 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Situata:

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (1. K. G.-Ekonomiste , 2. E. T.-Ekonomiste , 3. S. P.-Inxhinier ,4.A. D.-Inxhinier, 5.Z. S.- Juriste), të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 22.08.2022, të cilat janë si më poshtë;

Në pikën 2.3.2.Liçensa profesionale, në DT është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP– 1 A Punime gjermimi në tokë.
- NP– 2 A Ndërtime civile dhe industriale.
- NP- 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NP– 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pistaaeroportuale.
- NS– 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- NS- 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS– 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- NS– 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- . NS– 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

-Referuar licensës profesionale NP- 4-A të projekt preventivit të punimeve, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Në pikën 2.3.4 të DT është kërkuar që: Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensen e shoqërisë ose pajisur me licencë individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Në lidhje me kërkesën për Inxhinier Gjeolog, si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, referuar tipologjisë të punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkretë për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve në fjalë. Vendosja e kriterit për inxhinieret, nuk përmbahet përcaktimeve të pikës 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Në pikën 2.3.7 në DT është kërkuar që: Operatori Ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtës 12- 15 Ton	Ne pronësi ose me qera	Copë	3
2	Fadrome me goma	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
3	Eskavator 9- 11 Ton	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
4	Autobetoniere	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
5	betoforma	Ne pronësi ose me qera	m 2	500
6	Autobot Uji	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
7	Autopomp betoni	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
8	Rrul ngjeshes	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
9	Vibrator Betoni	Ne pronësi ose me qera	Copë	4
10	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 Ton	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
11	Kamioncina me kapacitet mbajtës 3.5- 5 Ton	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
12	Kamion me vinc	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
13	Minieskavator	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
14	betoniere	Ne pronësi ose me qera	Copë	4
15	Automjet me kosh per punimet ne lartesi	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
16	Mixer rrotullues per stabilizimin e shtresve te rruges	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
17	Makineri per prerje pllakash	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
18	Tranxhe hekuri	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
19	Nivelues lazer	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
20	Skeleri	Ne pronësi ose me qera	m 2	2500
21	Vegla pune per stampat e betonit, vegla per muratoret formedhënesit punuesit e cimentos	Ne pronësi ose me qera	Copë	25
22	Stampa betoni	Ne pronësi ose me qera	Copë	40
23	Pjaster vibruës	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
24	Saldatrice	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
25	Bango hekuri	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
26	Depozita uji	Ne pronësi ose me qera	Copë	2

- Kokore minimumi 40 copë

- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve për kamion vetëshkarkues 12-15 ton (3 copë), Ekskavator 9- 11 ton Kamion Vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton (copë 2) si dhe kërkohet Kamioncinë me kapacitet mbajtës 3.5- 5 ton (2 copë). Gjithashtu theksojmë se transportimi i materialeve hidraulike, elektrike, pllakave, gërmim dheu, etj ... nuk do të kryhet brenda të njëjtës ditë, pasi janë punime të cilat shtrihen në kohë të ndryshme (gjashtë muaj) dhe në këto kushte një kamion/kamioncinë mund të kryej disa rrugë dhe të realizohet qëllimi.

- Gjithashtu nuk është argumentuar teknikisht betonier (4 copë) në përputhje me volumin e punimeve, pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë sipas përcaktimeve të pikës 4,

të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri:

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP*

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 8428, të datës 15.09.202, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“A.” & “S.” SHPK	67,282,494	Kualifikuar
2	“B.” SHPK	73,589,752	Kualifikuar
3	“J.” & “C.” SHPK	75,147,508	Kualifikuar
4	“U.” SHPK	76,802,082	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 02.11.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 4 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 02.11.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “A. “ SHPK & “S.” SHPK” për të cilën është lidhur kontrata datë 03.11.2022 për vlerën 67,282,494 lekë pa TVSH dhe vlera 80,38,993 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve.

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezultojnë se është paraqitur 1 ankesa nga OE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.

Titullari i AK, ka marrë vendimin (urdhër) me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedurës dhe caktimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës të përbërë nga D. H.-Juriste, E. H. –Inxhinierë, A. A.-Ekonomiste.

Më datë 23.09.2022 pranë autoritetit Kontraktor është paraqitur formulari i ankesës me nr.8699 prot, prej ankimesit BOE: “A.”& “S.” SHPK me nr. nipti: K.....C & K.....N. Dokumentat plotësuese lidhur me ankesën:

- Shtojca 8 A.
- Shtojca 8 S.
- Fatura tatimore për betoforma për A.& S.
- Vërtetim gjyqësor në lidhje me pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë

Më datë 28.09.2022 është ngritur urdhri nr. 208 për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesës të përbërë nga (D. H.-Juriste, E. H. –Inxhinierë, A. A.-Ekonomiste) nga ku nëpërmjet vendimit nr. 8842/2 datë 28.09.2022 komisioni për shqyrtim ankese njëherazi vendosi:

Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “A.” SHPK për: procedurën e prokurimit me objekt: **”Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare “5 Dëshmorët +kopësht, Suk 1, ambiente sportive dhe**

ndërtim i palestrës.”

Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomikë “A.” SHPK në procedurat e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti kontraktor të anulojë të gjitha pasojat juridike të ardhura nga vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomikë “A.” SHPK, në procedurat e mësipërme të prokurimit, si dhe të kalojë për rivlerësim të procedurave të mësipërme të prokurimit në SPE.

Ky vendim i vihet në dispozicion menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim ankuesit nga operatori ekonomikë “A.” SHPK dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Më datë 21.10.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i përbërë nga z. J. M. –Kryetar , z. F. Z.-Nënkryetar, z. K. T. -Anëtar, znj. A. M.-Anëtar ekzekutoi vendimin nr. 1032/2022 prot ku njëzëri vendosi :

Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë A.” SHPK & “S.” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. . REF-39373-08-19-2022 me objekt: “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare 5 Dëshmoret, Suk 1, Ambienteve sportive dhe Ndërtimi i palestrës, Bashkia Roskovec.”.

Konkluzion: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit Ekonomik të shpallur fitues BOE “A. & “S.” SHPK me ofertë për vlerën 67,282,494 lekë pa TVSH dhe vlera 80,38,993 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (Gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës, arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

4. Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Vidhishtë- Drizë,1470 ml (Asfaltim) b=4m+2*0.5”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur ” REF-42548-09-20-2022 Urdhri nr. 110 prot., datë 20.09.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.8460 , datë 16.09.2022 E. H. A. D. M. A.	2 Njësia e Prokurimit 1. S. P. 2. S. Ç. 3. E. K. 4.K. G. 5.Z. S.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 8761 prot., datë 26.09.2022 1. K. L. 2. M. L. 3. Z. Ç.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 12 535 250 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: H.” SHPK 9 009 000 lekë pa TVSh.	6. Diferenca me fondin limit 3 526 250 lekë pa TVSh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 06.10.2022	8. Burimi Financimit Të ardhurat e Bashkisë	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 8 OE b) S’kualifikuar 0 B/OE , c) Kualifikuar 8 B/OE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës:6 (gjashtë) muaj			
10.Ankimime AK-s’ka/ka;	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 10048 prot., datë 11.11.2022	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK	

APP-s'ka/ka;		
KPP-s'ka/ka		

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlogarritjen e Fondit Limit” :

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr.8460 datë 16.09.2022 “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, E. H.-Inxhinier A. D.- Inxhinier M. A.-Ekonomist . Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 8460/1, datë 19.09.2022.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST ,dorëzuar dokumentacioni teknik dhe preventivi me procesverbalin e komisionit nr. 8460/1 prot, datë 19.09.2022, dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivi është bazuar në VKM-në nr.629, datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të Tyre 1 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) si dhe te aktin normativ NR.10 Date 18.05.2022” Për kompensimin financiar të çmimit për disa material ndërtimi sipas përcaktimit të kontratës për punë publike si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”.

Preventivi i hartuara nga KLLFLST si mëposhtëm për objektin: "Rikonstruksion i rrugës Vidhishtë- Drizë,1470 ml (Asfaltim) b=4m+2*0.5"

Nr.	Nr. An.	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia
1. Punime në rrugë				
1	3.197	Skarifikim shtresa ekzistuese ne rruge	m ²	3000
2	3.87/b	Germim dheu ne rruge dhe germim kanali anesor	m ³	490
3	An.164/1b	Mbushje+ngjeshje e trupit te rruges me cakell per kuote projekti	m ³	300
4	3.212/a	Shtrese stabilizant+ngjeshje t=5cm	m ²	5800
5	3.228/1/an	Shtrese binderi me zall lavatrice,6cm,me makineri+ngjeshje	m ²	5800
6	3.207	Cakull per bankine t=10cm	m ²	1470
SHUMA 1				
		TVSH 20%		
		TOTALI		

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej znj. S. P.- Inxhinier z. S. Ç.-Ekonomist z. E. K.- Inxhinier znj. K. G.-Ekonomist zj. Z. S.-Juriste të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 20.09.2022.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

Pika 2.3.6- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

I.MAKINERI	Njesia	Sasia	Pronësi a
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 15 ton.	copë	2	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	copë	1	Pronësi ose me qera

Grejder.	copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	copë	1	Pronësi ose me qera
Fadrom	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
Betonierë.	copë	2	Pronësi ose me qera

Sa më sipër janë kërkuar 2 kamiona me kapacitet mbajtës mbi 15 ton, pasi në 6 muaj AK do të furnizohet me rreth 16,070 m² dhe 790 m³ materiale ndërtimi, si zall lavatrice, rërë lavatrice, çakull makinerie, çimento. Bazuar në argumentimin e dhënë në procesverbalin përkatës konstatohet se, kërkesa për kapacitetin mbajtës mbi 15 ton nuk është argumentuar plotësisht, pasi nuk është bërë një analizë se sa rrugë do të bëjë kamioni në ditë për të furnizuar me mallrat e mësipërme Bashkinë Roskovec brenda 6 muajve. Për më tepër që nuk argumentohet numri i kamionave, pse 2 kamiona dhe jo 1, shoqëruar me analizë teknike, sipas volumit dhe grafikut të punimeve.

- Nuk argumentohet kërkesa për 2 betonierë për 6 muaj pasi referuar procesverbalit të argumentimit të kërkesës për mjetet, sipas zërave përkatës të preventivit, volumet e punimeve për secilin zë pune sipas VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete te renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj...

Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon znj. S. P.- Inxhinierë z. S. Ç.-Ekonomist z. E. K.- Inxhinierë znj. K. G.-Ekonomist zj. Z. S.-Juriste

Kriteri:

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP**

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 9365, të datës 18.10.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“H.”SHPK	9 009 000	Kualifikuar
2	“N.” SHPK	9 091 200	Kualifikuar
3	“B.” SHPK	9 990 500	Kualifikuar
4	“F.” SHPK	10 000 000	Kualifikuar
5	“I.” SHPK	10 934 800	Kualifikuar
6	“M.” SHPK	10 965 040	Kualifikuar
7	“Z.” SHPK	11 684 500	Kualifikuar
8	“S.” SHPK	11 786 500	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 01.11.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 8 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 8 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 01.11.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “H.” SHPK për të cilën është lidhur kontrata

datë 11.11.2022 për vlerën 9,009,000 lekë pa TVSH dhe vlera 10,810,800 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) muaj/ ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Konkluzion: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatorit Ekonomik të shpallur fitues OE “H.” SHPK me ofertë për vlerën 9,009,000 lekë pa TVSH dhe vlera 10,810,800 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (Gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës, arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

5. Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i shkollës së mesme “Didin Bishani”,Fshati Kurjan , Njësia Administrative Kurjan ”.				
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Konkurruese e negociuar” Urdhri nr.140 prot., datë 06.12.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 10479, datë 05.12.2022 1 E. H. 2 Z. S. 3 A. A.	2 Njësia e Prokurimit 1. S. P. 2. D. H. 3. S. Ç. 4.E. K. 5.E. T.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 10525 prot., datë 06.12.2022 1. K. L. 2. M. L. 3. K. G. 4.E. H. 5.Z. Ç.	
4. Fondi Limit (pa TVSh) 19 459 118 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: 19 370 555 lekë pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit 88 563 lekë pa TVSh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data .13.01.2023	8. Burimi Financimit European Union(BE)		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 3 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 2 OE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj				
10.Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 1743 prot., datë 17.03.2023		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK	

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

Bazuar në marrëveshjen e projektit të financimit me nr. 6531/1 prot., datë 06.07.2022, nënshkruar nga Financuesi (Center Science and Inovation for Development “SCIDEV), përfaqësues z. H. P. dhe përfaqësuesja e Bashkisë Roskovec znj. M. B. me vlerë financimi 447,954 Euro dhe shuma e transhit të parë në vlerën 266,282.62 Euro është nënshkruar në gjuhën Angleze dhe nuk i është nënshtruar procedurave të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” neni 10 pika 2 ç ku citohet “tekstin e marrëveshjes, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë”; neni 17 pika 2/ç ku citohet “tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe; si dhe neni 19.

Referuar marrëveshjes për financimit të projektit me objekt “Rikonstrukcion i shkollës së mesme “Didin Bishani”,Fshati Kurjan, Njësia Administrative Kurjan” me vlerë financimi në shumën 19,370,555 lekë, Grant për Bashkia Roskovec. Kjo procedurë është shpallur në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec.

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlogarritjen e Fondit Limit” :

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr. 10479 datë 05.12.2022 “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, znj. E. H. –Inxhinier, znj. Z. S.-Juriste, znj. A. A.-Ekonomiste. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 10479/1, datë 06.12.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej znj. S. P.-Inxhinier, znj. D. H.-Juriste, z. S. Ç.-Ekonomist, z. E. K.-Inxhinier, znj. E. T.-Ekonomiste, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 13.12.2022 të cilat janë si më poshtë;

1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 6;*
- c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcë 4*
- d. *Listat e Çmimeve të shërbimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 5;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 10 dhe 11.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

2.Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar të kontratës që po prokurohet konkretisht:

19,459,118 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqindë tetëmbëdhjetë), (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

3.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 në zbatim të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **jo më të vogël se 9 500 000** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë **jo më të vogël** se sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **38 000 000** (tridhjetë e tetë milion) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës perkatëse (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikatën e marrjes në dorëzim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim
- Faturë tatimore

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës perkatëse (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
- Fatura tatimore perkatëse.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.2. në DT është kërkuar Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP- 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NS- 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS– 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

- NS– 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- .NS– 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

2.3.3. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punëtorë minimalisht **15 (pesëmbëdhjetë)** personave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të dorëzoj dokumentet si me poshtë:

a. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërorë ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Shtator - Nëntor2022**.

b.Listepagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Shtator - Nëntor2022**.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të paktën si me poshtë:

- Teknik ndërtimi 1 (një)
- Murator 2 (dy)
- Elektracist 1 (një)
- Pllakashtures 2 (dy)
- Bojaxhi 2 (dy)

2.3.6. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjës të specializuar/kualifikuar si me poshtë:

2 (dy) - **Shofere**

1(nje) -Manovrator

Për manovratorët e mjeteve të renda si me sipër të paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit për makinerite të renda sipas profesionit përkatës dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Për shoferët të paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

punëtorët e mësipërm të figurojnë në listepagesa për periudhën e kërkuar. ***Në rastin kur punonjësit Manovrator ose shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.***

2.3.7 Operatori Ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion Vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 12-15 Ton	Ne pronësi ose me qera	Cope	1
2	Fadrome me goma	Ne pronësi ose me qera	Cope	1
3	Autobot Uji	Ne pronësi ose me qera	Cope	1
4	Kamioncina me kapacitet mbajtes 3.5- 5 Ton	Ne pronësi ose me qera	Copë	2

5	betoniere	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
6	MAKINERI PER PRERJE PLLAKASH	Ne pronësi ose me qera	Copë	2
7	NIVELUES LAZER	Ne pronësi ose me qera	Copë	1
8	SKELERI	Ne pronësi ose me qera	m 2	500
9	SALDATRICE	Ne pronësi ose me qera	Copë	1

- Kokore minimumi 20 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 copë

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma), kur janë ne pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:

- çertifikaten e pronësisë;
- leja e qarkullimit;
- çertifikaten e kontrollit teknik;
- siguracionin;
- leja e transportit qe lëshohet nga njësia vendore
- fotot përkatëse ku te duket qartësisht targa dhe lloji i mjetit

b) Ndërsa për mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mësipërm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë e cila duhet te përfshijë objektin përkatës dhe duhet te jete e vlefshme për te gjithë periudhën e kohëzgjatjes se objektit deri në përfundimin e plote te punimeve.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

d) Mjetet dhe makineritë nuk duhet te jene te angazhuar ne objekte te tjera, vërtetuar kjo me deklaratë te OE.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin qe prokurohet, si me poshtë:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit te Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 6 (gjashtë) muaj kalendarike.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 300, të datës 17.01.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"S." SHPK	19 370 556	Kualifikuar
2	"V. & Q." SHPK	19 395 333	Kualifikuar
3	"S." SHPK	19 448 140.08	S'kualifikuar; Në DST kriteret e vecanta të kualifikimit , Ofertuesi duhet të paraqesë :

			b.Sigurimin e ofertës ,sipas shtojcës 6 të DST.Ky kriter nuk është përmbushur nga Operatori ekonomik.
--	--	--	---

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 01.02.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 1 OE, janë kualifikuar 2 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 01.02.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë” S.” SHPK për të cilën është lidhur kontrata datë 17.03.2023 për vlerën 19,370,555 lekë pa TVSH dhe vlera 23,244,666 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) muaj ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Titulli i gjetjes:

Situata: Nga auditimi i procedurës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Didin Bishani”, Fshati Kurjan, Njësia Administrative Kurjan”. me fond limit në vlerën **19,459,118** lekë pa TVSh OE “S SHPK”, në të cilën ka marrë pjesë 3 OE, konstatohet se: procedura e kryer për këtë inventar është bazuar në marrëveshjen e projektit të financimit me nr. 6531/1 prot., datë 06.07.2022, nënshkruar nga Financuesi (Center Science and Inovation for Development “SCIDEV), përfaqësues z. H. P. dhe përfaqësuesja e Bashkisë Roskovec znj. M. B. me vlerë financimi 447,954 Euro dhe shuma e transhit të parë në vlerën 266,282.62 Euro është nënshkruar në gjuhën Angleze dhe nuk i është nënshtruar procedurave të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” neni 10 pika 2 ç ku citohet “*tekstin e marrëveshjes, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë*”; neni 17 pika 2/ç ku citohet “*tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe; si dhe neni 19.* Në këtë procedurë vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, si dhe specifikimet teknike të vendosura për mallrat e kërkuara, nuk është e sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, si licencat e kërkuara, numri i fuqisë punëtore, certifikatat e kërkuara etj., Kjo procedurë është kryer vetëm me shpallje në faqen zyrtare të Bashkisë, dhe jo sipas legjislacionin e prokurimit publik, mos bërjen publike të shpalljes së njoftimit të kontratës nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve publike, nuk është kryer publikim në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik, nuk janë ndjekur hapat e duhur të kryerjes së procedurave normale të prokurimit, duke sjellë pabarazi midis OE, duke mos trajtuar në mënyrë të drejtë konkurrencë dhe trajtim të barabartë midis tyre duke mos siguruar besim në publik dhe duke shmangur transparencën në kryerjen e kësaj procedure.

Veprime e mosveprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” neni 1, 3, 4 pika 9; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 39, “Kontratat për punë publike”, ku përcaktohet se:

2) *Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.*

5) *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Znj. M. B., me detyrë Kryetar i Bashkisë Roskovec, në cilësinë e titullarit të Autoritetit

Kontraktor,

2) Znj. S. P. me detyrë Përgjegjës i sektorit të prokurimeve, Inxhinier, në cilësinë e përgjegjës të prokurimeve dhe hartuesit të kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike,

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që tekstin e marrëveshjes të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 10 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/6 prot., datë 16.08.2023, nga znj S. P., znj. D. H., E. K., S. Ç. E. T.n në cilësinë e njësisë së prokurimit, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për sa më sipër rezulton se njësia e prokurimit në zbatimin e procedurës së prokurimit është mbështetur në kontratën nr. 6531/1 prot., datë 06.07.2022, nënshkruar nga Financuesi (Center Science and Inovation for Development “SCIDEV), përfaqësues z. H. P.dhe përfaqësuesja e Bashkisë Roskovec znj. M. B. me vlerë financimi 447,954 Euro, pjesë e së cilës është dhe objekti i prokuruar “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Didin Bishani”, Fshati Kurjan, Njësia Administrative Kurjan”. Referuar kësaj kontrate Artikulli 6 pika 6.1 Aneksi IV “Rregullat e prokurimit për përfituesin” praktika që do të ndiqet nga përfituesi i fondit për prokurim publik do të jetë sipas PRAG (Procedura e prokurimit sipas legjislacionit Evropian. Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” në nenin 8 pika 2 citohet se “ Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, të cilat autoriteti ose enti kontraktor jep në përputhje me rregullat e prokurimit, që parashikohen nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, kur kontratat publike në fjalë financohen plotësisht nga kjo organizatë ose institucion ”

Në rastin e kontratave publike dhe konkurseve të projektimit, që bashkë financohen në shumicën e tyre nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit”

Në këtë rast Bashkia Roskovec ka një marrëveshje për financim projekti nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në vlerën 447,954 Euro përfituar në kuadër të thirrjes për aplikim si pjesë e marrëveshjes miratuar me VKM nr. 50 datë 29.01.2020 “Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programet vjetore kombëtare për republikën e Shqipërisë, për vitin 2018, në kuadër të asistencës së para anëtarësimit (IPA II), i ndryshuar.

Bashkëlidhur dokumentet vërtetues

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4869 prot datë 14.08.2023 do të merren në konsideratë për sa i përket procedurës së zhvilluar nga AK. Ndërsa për sa i përket marrëveshjes AK duhet ti nënshtruar procedurave të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” neni 10 pika 2 ç ku citohet “tekstin e marrëveshjes, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë”; neni 17 pika 2/ç ku citohet “tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe; si dhe neni 19.

6. Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemimi i qëndres Marinëz +ndërtim rrethrotullimi".		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur e thjeshtuar" REF-43558-09-27-2022 Urdhri nr. 7521 prot., datë 19.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 7033 datë 27.07.200 A. D. E. H. M. A.	2 Njësia e Prokurimit 1. S. P. 2. E. T. 3. E. K. 4.Z. S. 5.S. Ç.
3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 9299 prot., datë 14.10.2022 1. K. L. 2. M. L. 3. Z. Ç.	4. Fondi Limit (pa TVSh) 10 615 044 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: 9 984 980 lekë pa TVSh.
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 10.10.2022	8. Burimi Financimit Të ardhurat e Bashkisë	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S'kualifikuar 1 B/OE , c) Kualifikuar 1 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë)		
10. Ankimime AK-s'ka/ka; APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 10068 prot., datë 11.11.2022	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlogarritjen e Fondit Limit" :

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr.7033 datë 27.07.2022 "Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike", i përbërë prej, z. A. D.- Inxhinier znj. E. H.-Inxhinier z. M. A.-Ekonomist . Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 7033/1, datë 29.07.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST ,dorëzuar dokumentacioni teknik dhe preventivi me procesverbalin e komisionit nr. 7033/1 prot, datë 29.07.2022, dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivit është bazuar në VKM-në Nr.629, Datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me vkm nr. 631, datë 26.10.2018) si dhe të aktin normativ nr.10 datë 18.05.2022" Për kompensimin financiar të çmimit për disa material ndërtimi sipas përcaktimit të kontratës për punë publike si pasje e situatës se veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022".

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Situata:

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve":

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej znj. S. P.- Inxhinier, z. S. Ç.-Ekonomist, z. E. K.- Inxhinier, znj. Z. S.-Juriste dhe znj. E. T. -Ekonomiste, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 27.09.2022, të cilat janë si më poshtë;

1. Në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, në DT është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Autoritetet Kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP1 - A (*Punime gjurmimi në tokë*)
- N.P. 4 –A (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- N.S – 8 (Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të parandëruar).
- N.S - 13 (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)

-Referuar projekt preventiv të punimeve, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

2. Në pikën 2.3.6 është kërkuar që Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik si më poshtë për të cilën duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt, diploma dhe CV.

Inxhinier Gjedodet/Topograf - 1

Elektricit-1

Skulpturist instalacioni-1

- Në lidhje me kërkesën për Inxhinier Gjeolog/Topograf dhe *Skulpturist instalacioni-1*, si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, referuar tipologjisë të punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve në fjalë. Vendosja e kriterit për inxhinieret, nuk përmbahet përcaktimeve të pikës 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

3. Në pikën 2.3.7- në DT është kërkuar: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

I.MAKINERI	Njesia	Sasia	Pronësi a
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 10 ton.	copë	2	Pronësi ose me qera
Automjet transporti vetëshkarkues 5-7ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	copë	1	Pronësi ose me qera
Grejder.	copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	copë	1	Pronësi ose me qera
Fadrom	copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
AutoBetonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve për kamion vetëshkarkues 5-7 ton (1 cop), si dhe kërkohet kamionçinë kapaciteti maksimal mbi 10 ton (2 cop). Gjithashtu theksojmë se transportimi i materialeve hidraulike, elektrike, pllakave, gjurmim dheu, etj ... nuk do të kryhet brenda të njëjtës ditë, pasi janë punime të cilat shtrihen në kohë të ndryshme (gjashtë muaj) dhe

në këto kushte një kamion/kamionçinë mund të kryej disa rrugë dhe të realizohet qëllimi.

- Gjithashtu nuk është argumentuar teknikisht rryl ngjeshës i tonazhit të madh në përputhje me volumin e punimeve, pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë sipas përcaktimeve të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri:

Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP*

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 9536, të datës 24.10.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“Z.” SHPK	9 984 980	Kualifikuar
2	“A.” SHPK	-	S’kualifikuar; Në DST në pikën 2, kriteret e vecantatë kualifikimit ,në pikën b është kërkuar : Sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3. Ky kriter nuk është përmbushur nga operatori ekonomik pasi nuk është hedhur në sistem . 2-Mjeti Grejder dhe Asfaltoshtruesja e paraqitur nga operatori ekonomik duhet të ishte e paisur m targ. Për mjetet që shënohen në rregjistra publik (mjet me goma)kur jan me pronësi duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësin e mjetit. -certifikatën e pronësisë Leja e qarkullimit Certifikatën e kontrollit teknik Siguracionin Leja e transportit që leshohet nga njësia vendore Foto përkatëseku të duhet qartësisht targa dhe lloji i mjetit .

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 04.11.2022 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 1 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 04.11.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “Z.” SHPK për të cilën është lidhur kontrata datë **11.11.2022** për vlerën 9,984,980 lekë pa TVSH dhe vlera 11,981,976 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) muaj/ ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Lidhja e kontratës:

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. **10068 prot., datë 11.11.2022** është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari znj. M. B. dhe Operatorin Ekonomik **Z.” Shpk** me përfaqësues z. Z. Z., me objekt: “*Sistemimi i qendrës Marinëz +ndërtim*”

rreth rrotullimi”. Bashkia Roskovec, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës, për vlerën 9,984,980 lekë pa TVSH dhe vlera 11,981,976 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) muaj/ ditë nga data e lidhjes së kontratës.

4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në zbatim të pikës 4.4/4 me objekt: “*Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik*” të Programit të Auditimit, në Bashkinë Roskovec , nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022.

Nga grupi i auditimit, u arsyetua, për t’u audituar kontrata për punë publike, pasqyruar në tabelën nr. 1, me vlerë **218,970,254 lekë me TVSH**, mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimi, zbatimi i afateve të kontratave si dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera.

Tabela nr. 1. Kontrata zbatimi të audituara

Nr	Emërtimi i investimit të kryer	Vlera e investimit me TVSH sipas kontratës	Data e fillimit të punimeve sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim të kantierit të ndërtimit	Data e marrjes në dorëzim të investimit (procesverbali i kolaudatorit dhe grupit të marrjes në dorëzim)
1	Përmirësimi i furnizimit me ujë të pashëm për qytetin e Roskovecit	159,926,434	12.03.2020	25.01.2022
2	Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut	23,153,880	13.04.2021	21.10.2022
5	Rikonstruksioni i kopshtit Nr. 1 në Roskovec	15,177,809	26.11.2021	31.05.2022
6	Rikonstruksioni i rrugës “Tushallarët, fshati Strum	9,494,783	05.04.2021	24.05.2022
7	Adaptimi i objektit të ish – tualeteve në kopësht dhe çerdhe	11,217,348	01.11.2021	18.01.2023
Shuma në lekë me TVSH		218,970,254		

Burimi: Bashkia Roskovec , përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:

Titulli i Gjetjes	Nga kontrolli i punimeve në terren për zbatimin e kontratës me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për qytetin e Roskovecit” u konstatua
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Roskovec dhe sipërmarrësit BOE “N.” shpk ,“G.” dhe “S.”shpk me kontratë nr.--- Prot, datë 06.03.2020 me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për qytetin e Roskovecit” dhe kontrolli në terren i rrugëve me rërë bituminoze u konstatua se rrugët në tërësi pothuajse ishin jashtë standartit madje në shumë vende përgjatë sipërfaqes së tyre ishin gërryer dhe kishin krijuar gropa ,plasaritje të thella në disa pjesë kishte humbur pothuajse fare shtresa e sipërme me rërë bituminoze t=10,cm .Në disa pjesë kishte mbirë barë anash sipërfaqes së rrugës dhe

	<p>në mes të aksit të sajë. Projektimi i këtyre rruge <u>nuk është eficient dhe efektiv</u> pasi kjo metodë projektimi nuk garanton jetëgjatësi të objektit të ndërtuar. Lidhja mes këtyre shtresave nuk realizohet sipas kushteve teknike gjithashtu dhe vetë shtresa e rërës bituminoze nuk është zgjidhje e duhur marrë parasysh dhe përbërjen e sajë e cila nuk ka aftësi të mirë si ndaj ngarkesave që mban si në rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Aq më tepër kur këto rruge nuk kanë kanale për kullimin e ujërave, pasi prania e ujërave mbi sipërfaqen e rrugës për një kohë të gjatë ndikon në degradimin e rrugës për një afat kohor të shkurtër. Vlera totale e investimit të këtyre rrugëve është 23,255,720 lekë e cila përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve të Bashkisë Roskovec.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 10297, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, neni 8 në të cilin citohet se:</p> <p>Qëllimi i ligjit Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.</p> <p>Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit Titullarëve njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienz.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se vlera e këtij investimi në shumën 23,255,720 lekë shpenzim pa efektivitet për buxhetin e Bashkia Roskovec,</p>
Shkaku:	<p>Neglizhencë nga ana e DPZHTEK Bashkia Roskovec.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandime:	<p>Nga ana e Bashkisë Roskovec konkretisht kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorisë së urbanistikës dhe të merren masa për të mos hartuar dhe miratuar projekte të këtij lloji pasi janë projekte të cilat nuk kanë efizienz dhe efektivitet si dhe degradojnë në një kohë shumë të shkurtër.</p>

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 5 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/5 prot., datë 15.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Nga observacionet e vëna në dispozicion subjekti pretendon se investimi me rërë bituminoze është zgjedhja e duhur pasi ato rrugë do të shërbenin vetëm në funksion të ndërtimit apo mirëmbajtjes së objekteve të ndërtuara dhe nuk do të kenë fluks lëvizje automjetesh. Në rast se kjo rrugë do të kishte projekt me shtresë binder dhe asfalt kostoja e sajë do të ishte shumë e lartë. Ne komentet e subjektit përmendet edhe mirëmbajtja e cila i ka munguar këtyre rrugëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër grupi i auditimit për observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 127 prot datë 15.08.2023 nuk ndan të njëjtin mendim me subjektin për shkak se këto rrugë të projektuara në atë

mënyrë nuk janë rezistente ndaj kohës dhe ndaj agjentëve atmosferik. Janë investime të cilat për një kohë shumë të shkurtër dalin nga funksioni çka do të thotë që investimi nuk është efektiv dhe eficient. Grupi i auditimit rekomandon të mos hartohen më projekte më rrugë të tilla pasi kanë jetëgjatësi të shkurtër dhe kosto jo të vogël për tu ndërtuar.

Titulli i Gjetjes	Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për obejktin “Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut” u konstatuan punime të pakryera.
Situata:	<p>Nga auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës civile me objekt “Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut” me vlerë të kontratës (me tvsh) 23,153,880 lekë, realizuar nga OE “Z.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt dhe sipas imazheve të vëna në dispozicion vihet re se kjo sipërfaqe është shtruar vetëm me një shtresë asfaltike respektivisht;</p> <p>Sipërfaqja e kësaj rruge pas shkollës është 610 m².</p> <p>Zëri i punes “shtresë stabilizanti t=5 cm” 610 m² x 330 lekë/m²=201,300 lekë.</p> <p>Zëri i punës “Mbushje e trupit të rrugës me cakëll t=10cm” Janë situacionuar 476.42 m³ cakëll.Nqs do e kthejme në sipërfaqe të shtruar këtë cakëll me trashësi 10 cm del që sipërfaqja e shtruar me cakëll të jetë 4762.m².Sipërfaqja e rrugës bashkë me kunetat është 2160 m².Kjo sipërfaqe kërkon 216 m³ cakëll.Diferenca 476.42 m³-216 m³=260.42 m³ beton.</p> <p>“Mbushje e trupit të rrugës me cakëll t=10cm” 260.42 m³ x 1500 lekë/m³=390.630 lekë.</p> <p>“Mbjellje bari” me sipërfaqe 3455 m² dhe vlerë 345,505 lekë</p> <p>“Mbjellje lulesh” 300 copë me vlerë 105,000 lekë.</p> <p>Zërat e mësipërm duhet ti zbriten situacionit përfundimtar si punime që nuk janë realizuar me vlerë totale 1,042,235 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Roskovec.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. --- Prot, datë 30.03.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe OE “Z.” SHPK</p>

Kriteri:	Ligji 8402 date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7 Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të Bashkisë/komunës/qarkut. Kontrata Nr.--- Prot, datë 30.03.2021
Ndikimi/Efekti:	Shuma prej 1,042,235 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Roskovec.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandime:	Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,042,235 lekë pa tvsh nga OE “Z.” SHPK , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.--- Prot, datë 30.03.2021, me objekt “Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 5 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/5 prot., datë 15.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Për zërin e punës “Mbushje e trupit të rrugës me çakëll $t=10$ cm “është përlllogaritur dy herë pasi pra me dy shtresa nga 10 cm.

Për zërin e punës “Mbjellje lulesh dhe mbjellje bari” subjekti pretendon se janë realizuar por për shkak të mirëmbajtjes dhe kushteve atmosferike dhe jetëgjatësisë si dhe afatit kohor që nga data e përfundimit të punimeve nuk mund ti vihet kjo përgjegjësi sipërmarrësit.

“Shtresë stabilizanti”.Për këtë zë pune subjekti pretendon se është hedhur në cilësi dhe sasinë e duhur sipas projektit, e ilustruar me foto.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 127 prot datë 15.08.2023 për sa i përket zërit “Mbushje e trupit të rrugës me çakëll $t=10$ cm “ janë hedhur dy shtresa çakëll grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë pasi nuk është e faktuar nga ana e subjektit aq më tepër dhe në situacion nuk është pasyruar.

Përsa i përket mbjelljes së luleve dhe barit nga ana e subjektit nuk është vënë në dispozicion asnjë provë gjatë punimeve ose në përfundim të tyre ku të evidentohen këto zëra. Foto e vënë në dispozicion tregon barin por grupi i auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë imazh gjatë mbjelljes së barit ose luleve për ta marrë në konsideratë këtë zë pune.

Stabilizanti i përmendur nga ana e grupit të KLSH-së është për pjesën e sipërfaqes mbrapa shkollës dhe jo për rrugën të cilën e keni ilustruar edhe me foto. Në atë pjesë mbrapa shkollë është konstatuar se shtresa e stabilizantit nuk është vendosur.

5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Zyra e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Roskovec ka ushtruar funksionet dhe detyrat e saj bazuar në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015”.

Bazuar në sa më sipër, gjatë vitit 2022 janë miratuar 6 Vendime për Leje Ndërtimi, 3 vendime për miratimi të Certifikatë përdorimi, 1 vendim miratimi për Deklaratë Paraprake, 1 vendim Leje për Ndryshim Projekti, 1 vendim Leje për Shtyrje Afati si dhe 5 Leje Zhvillimi. Nga grupi i auditimit u audituan 7 leje, të cilat janë paraqitur në tabelën nr.1 si vijon:

Titulli i lejes	Njesia Strukturore	Investitori	Preventivi	Nr.pr ot	Data e aplikimit	Sip.ndertimi	Audituar
1.Leje ndertimi	RO_UB_A2_70/21 RO_UB_A1_70/59	D. H.	17°124'009		01.12.2021	Sip.truallit = 4272 m2 Sip.gjurmese= 960 m2	po
2.Deklarate paraprake		A.	-		16.01.2022	-	jo
3.Çertifikate përdorimi	RO_UB_A2_40/55	A. F.	5°455'316		25.01.2022	Sip.truallit =181.9 m2 Sip.gjurmese=126 m2	jo
4.Leje zhvillimi	RO_UB_A2_70/21	X. Ç.	-		30.01.2022	Sip.truallit=2009 m2 Sip.gjurmese=246.95 m2	jo
5.Leje per ndryshim projekti	RO_B_B2_19/8	H. G.	23°151'583		22.02.2022	Sip.truallit=8800 m2 Sip.gjurmese=500 m2	po
6.Leje ndertimi	RO_UB_A2_70/21	X. Ç.	2°192'235		06.03.2022	Sip.truallit=2009 m2 Sip.gjurmese=246.95 m2	po
7.Leje zhvillimi	RO_B_B2_19/129	G.	17°977'586		28.03.2022	Sip.truallit=10 840 m2 Sip.e ndertimit te ri=1631 m2	po
8.Leje ndertimi	RO_B_B2_19/129	G.	17°977'586		28.03.2022	Sip.truallit=10 840 m2 Sip.e ndertimit te ri=1631 m2	po
9. Leje zhvillimi	RO_UB_A1_70/14	Y. R.	3°996'586. 17		16.05.2022	Sip.truallit=302 m2 Sip.shtese kati+anesore=145.1 + 15.4 m2	po
10.Leje zhvillimi	RO_B_B1_18/86	X. K.	5°333'867. 14		30.05.2022	Sip.truallit=2000 m2 Sip.ndertimi=318 m2	jo
11.Leje ndertimi	RO_B_B1_18/86	X. K.	5°333'867. 14		30.05.2022	Sip.truallit=2000 m2 Sip.ndertimi=318 m2	jo
12.Çertifikate përdorimi	RO_UB_A2_70/21	X. Ç.	-		21.08.2022	Sip.truallit=2009 m2 Sip.gjurmese=246.95 m2	jo
13.Leje ndertimi	RO_UB_A1_70/24	X. K.	295°479		29.08.2022	Sip.e murit rrethues= 2.35 m2	jo
14.Leje ndertimi	RO_UB_A1_70/14	Y. R.	3°996'586. 17		12.09.2022	Sip.truallit=302 m2 Sip.shtese kati+anesore=145.1 + 15.4 m2	po
15.Çertifikate përdorimi		X. K.			21.09.2022	Sip.truallit=2250 m2 Sip.ndertimi=600 m2	jo
16.Leje per shtyrje afati	RO_B_B2_19/58	E.	15°170'484 .92		12.11.2022	Sip.truallit=11 200 m2 Sip.ndertimit total=1790 m2	jo
17.Leje zhvillimi	RO_UB_A2_70/39	Enti Kombetar I Banesave	93°635'933		15.11.2022	Sip.truallit=1500 m2 Sip.gjurmese=408.6m2	jo

Burimi: Drejtoria e PZHT rakorduar me sistemin e-lege

Në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara paraqiten si vijon:

Titulli i Gjetjes 1:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se nuk është respektuar përdorimi i lejuar i tokës.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- Leje ndërtimi nr. ----, datë 10.01.2022 me zhvillues: D. H. i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: nid: k.....j; Leja e ndërtimit për objektin: “Magazine shërbimi 1 kat” adresa e realizimit të punimeve: qyteti Roskovec. Sipas pasaportës për atë njësi strukturore konkretisht RO_UB_A2_70/21 dhe RO_UB_A1_70/59 përdorimi kryesor A i lejuar për atë njësi strukturore është 100 % “Banim” që do të thotë se objekte të llojit magazinë nuk mund të ndërtohen.
Kriteri:	Plani i përgjithshëm vendor, Bashkia Roskovec, Njësia strukturore sipas PPV-Bashkia Roskovec RO_UB_A2_70/21 dhe RO_UB_A1_70/59 ku përdorimi i lejuar i tokës është banim.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, Planin e përgjithshëm vendor sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Roskovec.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të respektohet përdorimi i lejuar për njësinë strukturore përkatëse ku do të zhvillohet ndërtimi i ri. Në rastin konkret përdorimi i lejuar në atë njësi strukturore është 100 % banim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. I. K. me detyrë ish specialiste pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
2. A. P. me detyrë ish përgjegjëse pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
3. M. B. me detyrë kryetare e Bashkisë Roskovec.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 6 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/4 prot., datë 14.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmblodhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në njësinë strukturore RO_UB_A2_70/21 kushtet zhvillimore janë të cituara ku përdorimi kryesor i lejuar është banim, nën njësi shërbim dhe përdorimet e tjera të lejuara duke ju referuar Nenit 42 të rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), duke ju referuar këtij neni qëllimi i objektit për të cilin është dhënë kjo leje ndërtimi nuk përjashtohet dhe nuk është i ndaluar.

Gjithashtu në njësinë strukturore RO_UB_A1_70/59 kushtet zhvillimore janë të cituara ku përdorimi kryesor i lejuar është banim, dhe përdorimet e tjera të lejuara duke ju referuar Nenit 41 të rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), duke ju referuar këtij neni qëllimi i objektit për të cilin është dhënë kjo leje ndërtimi nuk përjashtohet dhe nuk është i ndaluar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Persa citoni në observacion e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4851 prot datë 14.08.2023 nuk merr në konsideratë këtë koment pasi sipas pasaportës së njësive strukturore RO_UB_A2_70/21 dhe RO_UB_A1_70/59 përdorimi i lejuar është vetëm banim për një njësi strukturore dhe banim, shërbim njësi tjetër.

Titulli i Gjetjes 2:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se leja e miratuar është për objekt i cili ka qënë ekzistues para datës së miratimit të lejes së ndërtimit.
Situata:	<i>Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:-</i> Leje ndërtimi nr. prot ----, datë 19.04.2022 i jepet: zhvilluesit: X. Ç. .Leja e ndërtimit për objektin: “Kompleks magazinash shërbimi 1 kat (2 cope)” adresa e realizimit të punimeve: Qyteti Roskovec, afati kohor i kësaj leje është: 12 jave. Për lejen me të dhënat e mësipërme u konstatua se në njollën ku do të ndërtohet një nga objektete reja sipas lejes nga verifikimi me anë të programit Google Earth konstatohet se në po atë njollë të jetë një objekt ekzistues. Në pranëvendosjen e miratuar ky objekt ekzistues nuk është pasqyruar.
Kriteri:	Vkm 408 “Rregullorja e planifikimit të territorit”. Neni 15 Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi pika c) Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, Vkm 408 “Rregullorja e planifikimit të territorit” sjell efekte negativë në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Roskovec.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi sipas kushteve të domosdoshme për të miratuar një leje ndërtimi ku njëra prej tyre është planvendosja e objektit në gjendjen ekzistuese. Në këtë rast kemi të bëjmë me gjendje ku vihet re prania e një objekti ekzistues në njollën ku është miratuar leja e ndërtimit dhe nuk ka një leje prishje për objektin ekzistues për ti lënë rrugë objektit të ri që do ndërtohet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- 1.A. P. më detyrë ish përgjegjëse pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 2.E. H. me detyrë drejtore pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 3.M. B. me detyrë kryetare ë Bashkisë Roskovec.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 6 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/4 prot., datë 14.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Në konstatimin nr. 2 ku, Leja e ndërtimit me nr. prot ---- “Kompleks magazinash shërbimi” dhënë zhvilluesit X. Ç. është në kundërshtim me ligjin e planifikimit të territorit pasi nga kontrolli sipas Google Earth njolla e këtyre objekteve ka qënë ekzistuese ju sqarojmë se: - Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, zyra përgjegjëse për lejet përkatëse i referohet Ligjit Nr., 107/2014 Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit ku në baze të tij për marrjen e informacionit të nevojshëm i referohemi “Sistemit të informacionit gjeografik (GIS)” ASIG si të dhëna të bazuara ligjërish dhe jo Google Earth. Gjithashtu i referohemi dokumentit të pronësisë së paraqitur në dokumentacionin e aplikimit për leje ku në dokumentet e pronësisë është cituar pasuria Truall dhe nuk është cituar se në të ka ndërtesë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4851 prot datë 14.08.2023 nuk merr në konsideratë këtë koment pasi aplikacioni “google earth” është një mjet i përdorur nga ana e grupit të auditimit për të konstatuar situatën e mësipërme ku në sipërfaqen ku është miratuar leja e ndërtimit ka ekzistuar një objekt para miratimit të lejes.

Titulli i Gjetjes 3:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se në projektin teknik nuk ka marrë miratimin nga institucionet përkatëse
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- Leje ndërtimi nr. prot ----, datë 19.04.2022 i jepet: zhvilluesit: X. Ç. leja e ndërtimit për objektin: “Kompleks magazinash shërbimi 1 kt (2 cope) “adresa e realizimit të punimeve: qyteti Roskovec afati kohor i kësaj leje është: 12 jave nuk është marrë mendim nga AZHT(Agjencia e zhvillimit të territorit)
Kriteri:	Vkm 408 datë “Rregullorja e planifikimit të territorit” datë13.05.2015 Neni 14 Kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit pika 3. Lejet e ndërtimit jepen vetëm pasi janë marrë lejet dhe autorizimet përkatëse për ndërtimin në fjalë, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi. neni 15 Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi, pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Roskovec.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në ku të jenë marrë më para miratimit të sajë mendimet nga institucionet e tjera konkretisht në këtë rast nga AZHT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- 1.A. P. më detyrë ish përgjegjëse pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 2.E. H. me detyrë drejtore pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 3.M. B. me detyrë kryetare ë Bashkisë Roskovec.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 6 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/4 prot., datë 14.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në konstatimin nr. 3 ku, Leja e ndërtimit me nr. prot ---- “Kompleks magazinash shërbimi” dhënë zhvilluesit X. Ç. është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi nuk është marrë mendimi nga institucionet ju sqarojmë se: - Në bazë të VKM 408 datë 13.05.2015 Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit Neni 21 pika 6 shprehet: 6. Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë

për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve. Ku nuk e citon konkretisht institucionet përkatëse të cilave aplikimi për leje ju dërgohet për marrje mendimi, ku ndodhur para këtij fakti punonjësit e zyrës së lejeve e kanë menduar të arsyeshme dërgimin e aplikimit për marrjen e mendimit në institucionet e mëposhtme: ASHK, AEE, UK, OSHE.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4851 prot datë 14.08.2023 nuk merr në konsideratë këtë koment pasi nuk është marrë mendim nga AZHT. Agjencia e zhvillimit të territorit është institucioni i cili duhet ti merret mendim për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga drejtoritë Bashkiakë të planifikimit të territorit. Në rastin tuaj për disa leje është kërkuar mendim nga AZHT për disa të tjera jo.

Titulli i Gjetjes 4:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se intensiteti i ndërtimit të miratuar nuk është në përputhje me intensitetin e lejuar .
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat: - Leja e zhvillimit me nr. prot ---- për në parcelën me nr. pasurie 62/10 Zona Kadastrale 3537 ,sipërfaqe 10840 m2, me pronar z.I. H. dhe në marrëveshje midis pronarit të tokës dhe zhvilluesit subjektivit “G.” sipas kontratës së qerasë me nr.45 Rep. Nr.21 Kol, të ndodhur në adresën: fshati Suk 1, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec .Nga llogaritjet e vëllimit të objektit konstatohet se ai e kalon vlerën 10840 që do të thotë se ky raport ta kalojë atë të lejuar që është 1 m3/m2.
Kriteri:	Vendimin 283 datë 01.04.2015 II. Rregullat dhe kriteret për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore II b, pika 10. Ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 1 m ³ /m ² .
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Roskovec.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të respektohet intensiteti i lejuar që është 1m ³ /m ² në objekte për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- 1.I. K. me detyrë ish specialistë pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 2.A. P. më detyrë ish përgjegjëse pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 3.E. H. me detyrë drejtore pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 4.M. B. me detyrë kryetare ë Bashkisë Roskovec.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 6 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/4 prot., datë 14.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit;

Subjekti pretendon se nuk është kaluar intensiteti i lejuar 1m3/m2. Duke llogaritur vëllimin e objektit, sipërfaqen e zënë nga struktura 1513 m2 X lartësinë 6.7 m2 = 10137 m2. Duke qenë se sipërfaqet që përfitohen nga ndarjet e brendshme të objektit me ndërkat nuk ndikojë në shtimin e vëllimit të objektit, dhe duke qenë se lartësia e reklamës nuk është pjesë e lartësisë së kulmit të mbuluar të objektit, vëllimi i objektit prej 10137 m3 dhe sipërfaqja e truallit prej 10840 m2 plotëson kushtin 1m3/1m2.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4851 prot datë 14.08.2023 nuk merr në konsideratë këtë koment pasi vëllimi i objektit në fjalë nuk llogaritet thjesht sipërfaqe e bazës x lartësi por duke qenë se objekti e ka mbulesën jo të drejtë(horizontale)por të pjerrët në formë trekëndëshi në vëllimin total të sajë duhet të llogaritet edhe vëllimi që zë pjesa trekëndore.

Titulli i Gjetjes 5:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua nuk është respektuar koeficienti i shfrytëzimit të territorit.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- -leje ndërtimi nr.----, datë 19/10/2022 i jepet: zhvilluesit: Y. R. dhe Dallandyshe Rrezhda i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M. G. leja e ndërtimit për objektin: “Shtese anësore + 1k mbi objektin ekz 1k banim” adresa e realizimit të punimeve: Roskovec. nga llogaritja e ksht rezulton se për këtë leje është 48% pra më e madhe se ajo e lejuar 45%.
Kriteri:	Vkm 408 Neni 39 Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim 1. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (Ksht) për ndërtim është raporti i sipërfaqes së gjurmës së ndërtimit me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës së ndërrueshme. 2. Ksht-ja për ndërtim matet në përqindje (%). 41 3. Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërrueshme. 4. Në rastin e infrastrukturave për shërbime publike, Ksht-ja për ndërtim përcaktohet e pavarur nga ndërtimet e tjera dhe sipas nevojave të funksionit dhe legjislacionit të posaçëm.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim legjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Roskovec.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në ku të respektohet koeficienti i shfrytëzimit të territorit të përcaktuar dhe miratuar në planin e përgjithshëm vendor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- 1.E. H. me detyrë specialiste pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 2.E. H. me detyrë drejtore pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 3.M. B. me detyrë kryetare ë Bashkisë Roskovec.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 6 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/4 prot., datë 14.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Bazuar në VKM 408, neni 39, pika 3, ju sqarojmë se njësia strukturore ku pozicionohet objekti RO_UB_A1_70/14 ka KSHT të lejuar 50%, pra vlera 48% e paraqitur në pranëvendosje është më e vogël se norma e lejuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4851 prot datë 14.08.2023 merr në konsideratë këtë koment.

Titulli i Gjetjes 6:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se nuk është respektuar distanca nga kufiri i pronës.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:- Leje ndërtimi nr.----, datë 19/10/2022 i jepet: zhvilluesit: Y. R. dhe D.Rr. i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M.G. leja e ndërtimit për objektin: shtese anësore + 1k mbi objektin ekz 1k banim adresa e realizimit të punimeve: Roskovec. nga pranëvendosja konstatohet se distancat janë 1.3 m dhe 1.1 m në orientimet perëndimore dhe veriore,distanca minimale e lejuar duhet të ishte 3m. Distanca në orientimin lindor ku është dhënë dhe leja për shtesë verande nuk është pasqyruar në pranëvendosjen e miratuar.
Kriteri:	Vkm Nr. 408, datë 13.5.2015 Neni 35 ku citon “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve”.
Ndikimi/Efekti:	Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Roskovec.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të respektohen distancat e lejuara nga kufiri i pronës bazuar mbi rregullin ku distanca e lejuar nga kufiri i pronës duhet të jetë është nr. i kateve+1m.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- 1.E. H. me detyrë specialiste pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 2.E. H. me detyrë drejtore pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 3.M. B. me detyrë kryetare ë Bashkisë Roskovec.

Titulli i Gjetjes 7:	Nga kontrolli në sistemin e-leje u konstatua se nuk është realizuar konvertimi i truallit nga tokë arë në truall.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:-

	Leje ndërtimi me nr.prot ----/4 “Ndërtim ambient për ruajtje ,seleksionim dhe paketim fruta -perime” zhvilluesi E. -A., fshati Strum, Bashkia Roskovec, nuk është realizuar konvertimi i truallit nga tokë arë në truall. Lejë ndërtimi nr, prot ----/5 “Magazinë 1 kat në shërbim të aktivitetit bujqësor” me zhvillues “H. G.” qyteti Roskovec, Bashkia Roskovec.
Kriteri:	Plani i përgjithshëm vendor Bashkia Roskovec si dhe kushtet e vendosura nga ana e DPZHTK Bashkia Roskovec në lejen e miratuar ku citohet se para fillimit të punimeve duhet të realizohet konvertimi i truallit nga tokë arë në truall.
Ndikimi/Efekti:	Ndërtimi i objekteve në sipërfaqe të cilat janë me status tokë arë sjell keq urbanizim e zonave.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Roskovec.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi duke u respektuar statusi i tokës ku do të zhvillohet ndërtimi i ri.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- 1.A. P. më detyrë ish specialiste pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 2.R. H.me detyrë ish drejtor pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.
- 3.M. B. me detyrë kryetare ë Bashkisë Roskovec.
- 4.I. B. me detyrë ish kontrolluese pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 6 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 523/4 prot., datë 14.08.2023, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në bazë të rregullores së vjetër të Zhvillimit të Territorit ku citohej se ndalohej ndërtimi i objekteve të çdo lloj funksioni në toke Arë si kusht i miratimit të lejes së ndërtimit kërkohet konvertimi i tokës nga tokë Arë në Truall para fillimit të punimeve. Me ndryshimin e kësaj rregullore si dhe mbas miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec datë 10.06.2020 ku janë përcaktuar njësitë përkatëse dhe përdorimi i lejuar i tokës në bazë të të dhënave të pasaportës për secilën njësi kjo gjë pra konvertimi i tokës nuk është i nevojshëm. Citimi i këtij paragrafi në lejen e ndërtimit nr. prot ----/4 është lapsus dhe gabim njerëzor pasi është harruar që të hiqet si pikë nga formati i vjetër i lejes së ndërtimit

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4851 prot datë 14.08.2023 merr në konsideratë këtë koment.

6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore.

➤ **Vlerësimi i nivelit të kontrollit të territorit bazuar në organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).**

-Mbi krijimin e organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit.

Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor te Bashkisë Roskovec (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me Urdhër i Kryetarit Nr.803Prot., Date 01.02.2022 “Për ristrukturim

organizativ të Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, Vendim i Kryetarit Nr.22, Datë 01.02.2022 “Për miratimin e strukturimit në përfundim të ristrukturimit organizativ të Bashkisë Roskovec” për vitin 2022, i përbërë nga 3 punonjës, nga të cilët 1 Drejtor, 1 kryeinspektor dhe 1 inspektor në fakt aktualisht në punë janë tre punonjës, Drejtori, Kryeinspektori dhe Inspektori në përmbledhur paraqitet në aneksin nr. 1 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Sa më sipër rezulton se arsimimi i drejtorit Z. F. A. dhe Inspektorit Z. E. C. të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik (IMTV) Roskovec është në papajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin Nr.9780 Datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin Nr.183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”, ku përcaktohet se: “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

1.Përshkrimi i situatës për periudhën 01/01/2022-31/12/2022

Në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Roskovec për periudhën objekt auditimi, aktiviteti i veprimtarisë së punës në terren i cili është pasqyruar dhe dokumentuar me procesverbale konstatimi dhe për më tej me vendime pezullimi punimesh dhe vendime për prishje objekti të ndërtuar pa leje ndërtimi, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën në vijim.

Pasqyra e vendimeve të marra për periudhën 01/01/2022-31/12/2022

Nr.	Lloji i aktit	31.12.2022
1	PV/Akte kontrolli	-
2	PV/Akte konstatimi	10
3	Vendime gjobe	9
4	Vendime pezullimi	1
5	Vendime prishje	-
6	PV ekzekutimi të prishjeve	-
7	Kallëzime penale	-
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	2
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	1
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	1

Burim: Bashkia Roskovec.

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se Drejtori i IMTV-Roskovec nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit Nr. 9780, Datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me Nr.894, Datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, ndërmjet IMTV dhe Drejtorisë së Urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Roskovec, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 51 në Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se në akt-konstatimet e mbajtura nuk disponohen foto të situatës në terren, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin dhe pasqyrimin e veprimeve nga subjektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me nenin 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Në evidencën e kryer mbi procedurën e ndjekur vërehet se Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit, Bashkia Roskovec (*ne zbatim te VKB Nr.01, dt.18.05.2020, neni 52 i saj, pika 12*) në asnjë moment nuk ka kryer një korrespondencë me institucione të tjera, ndalemi këtu në korrespondencën e domosdoshme me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, respektivisht Sektori i Legalizimeve pranë kësaj drejtorie për të kërkuar një shkresë apo konfirmim nëse këta subjekte që i nënshtrohen prishjes, gjobës etj nga IMT, Bashkia kanë vetdeklarim për ndërtim pa leje, nëse ky vetdeklarim është në sistemin e tyre, nëse ka raste përjashtimore të vetdeklarimeve duke u bazuar në ortofoton fotografimin ajror në vite në referim të Ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.1040, Datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

2. Burimi i krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve nga mos arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në vlerën 2,906,000 lekë.

Situata:

Për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Roskovec është njoftuar zyra juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura, por nuk është ndjekur zbatimi i tyre. Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Roskovec për periudhën objekt auditimi janë vendosur 9 (nëntë) gjoba në vlerën 2,483,000 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 1,853,000 lekë, janë referuar në gjykatë 2 (dy) raste të ndërtimeve pa leje të konstatuara në vlerën 1,300,000 lekë dhe dy raste pa paguar në vlerën 533,000 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera 1,853,000 lekë, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 1,853,000 lekë.

Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridike nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Roskovec në vlerën prej 1,833,000 lekë, në kundërshtim me: **a-neni 16**, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamata 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni) (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

c-Nga Drejtoria Juridik dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

d-Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të Bashkisë Roskovec nuk ka marrë masat dhe nuk ka kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat të 31 vendimeve të gjobave në vlerën **1,853,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin Nr.8116, Datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile në RSH" i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) ku përcaktohet se: Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit dhe nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH.

Kriteri:

Neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; **Neni 15**-(*Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - Nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".*

Shkaku:

Mos vjelja e gjobave të vendosura nga IMT -ja si dhe mos zbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje.

Ndikimi/Efekti

Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i penaliëve dhe prishje të planit urbanistik nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv sipas **aneksit nr. 2 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit.**

3. Vendimet e marra nga IMT për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi.

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale IMT Bashkia Roskovec, nuk ka marrë vendime për prishje objektivash pa leje sipas aneksit nr. 3 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Rezulton se IMT Bashkia Roskovec ku pasqyrohen vetëm subjekte të viteve 2021 nga të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara vetëm një subjekt z. S. B., ndërsa 4 subjekte ekzekutuar prishja e tyre nga IKMT sipas aneksit të sipërcituar. Në shumicën rasteve (sipas tabelës së mëposhtme) rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje dhe janë marrë masat nga ana e IMT Bashkia Roskovec për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, por vetëm në rastin sipërcituar nuk është ndjekur procedura për marrjen e masave për prishjen e objektit pa leje, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr.9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe konkretisht neni 10.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. M. B., Kryetar i Bashkisë Roskovec.
2. Z. F. A., me detyrë Drejtor i Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor.
3. Znj. Z. C., me detyrë Kryenspektor i Inspektoriatit Mbrojtjes së Territorit Vendor.
4. Z. E. C. me detyrë Inspektor Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor.
5. Znj.V. Z. me detyrë, Drejtor Sektori Juridik.
6. Znj. D. F. me detyrë Përgjegjës Sektorit Juridik.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni në lidhje me akt konstatimin nr. 3 datë 04.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 503/4 prot., datë 14.08.2023, nga z. F. A. me detyrë Kryeinspektor, znj Z. Ç., E. Ç. me detyrë Inspektor në Drejtorin e IMT-së si dhe znj. V. Z. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, ku janë shprehur komentet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për sa i përket pretendimit se nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit te kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, te ligjit nr. 10279, date 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar,

Nga ana jonë janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllim arkëtimin e detyrimeve për gjobat e vendosura nga periudha 01.01.2022-31.12.2022 periudhë kjo e kërkuar nga ana juaj. Për sa i përket subjektit P. T. dhe J. sh.a nuk përfshihen në këtë periudhë të kërkuar pasi vendimet me gjobë, janë marrë në datën 28.12.2021 (P. T.) me Nr. Vendimi 14 dhe subjekti Jordil sh.a me Nr. vendimi 15 datë 30.12.2021 dhe jo siç janë konstatuar data dhe numri i vendimit me gjobë nga ana juaj në tabelën e paraqitur, me nr. 80 dhe datë 07.01.2022. Subjekti J. sha e ka shlyer detyrimin kurse subjekti P. T. është në proces gjyqësor, jemi në prritje të lëshimit të urdhrit ekzekutiv nga ana e gjykatës. *Bashkëlidhur mandat pagesa e ekzekutimit të gjobës të subjektit Jordil sha.*

Për sa i përket pretendimit se nuk është nuk ka marrë vendime për prishje objektesh pa leje (sipas tabelës së mëposhtme), ku pasqyrohen vetëm subjekte të viteve 2021 dhe të cilat vendime këto të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara vetëm një subject z. S. B., ndërsa 4 subjekte ekzekutuar prishja e tyre nga IKMT.

Për sa i përket pretendimit se për periudhën objekt auditimi, ndërmjet IMTV dhe Drejtorisë së Urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim nxitjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Roskovec, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 51 në Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.

Për sa i përket pikës së mësipërme: IMT ka pasur bashkëpunim me DPZHT konkretisht shkresa me Nr.5384 prot, datë 26.05.2022 si dhe bashkëpunime të tjera periodike ku dërgohet informacion nga ana e DPZHT shkresa me Nr. 35 prot, datë 06.01.2022.

Bashkëlidhur dokumentet vërtetues

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj me shkresën nr. 4850 prot datë 11.08.2023 do të merren në konsideratë për sa i përket përgjesisë dhe do të reflektohen në Raportin e auditimit. Ndërsa për sa i përket arkëtimin të gjobave të vendosura Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike në bashkëpunim me IMT të vazhdoj procedurat për arkëtimin e detyrimeve sipas dispozitave ligjore.

7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

7.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Titulli i gjetjes: *Bashkia Roskovec është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

Situata:

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 49/12 prot datë. 08.07.2022 i ka dërguar Bashkinë Roskovec **Vendimin 112, datë 07.07.2022**, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa dhe janë në proces zbatimi 13 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa organizative si dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative.

b.1 Për masat shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa në vlerë 1,707,879 lekë pa Tvsh nga të cilat deri në datën e verifikimit janë njoftuar subjektet për arkëtimin vullnetar të detyrimit, por nuk kanë kryer pagesën.

c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohet vlera 164,209,545 lekë si dhe të analizohet vlera 19,868,761 lekë Nga verifikimi rezulton se nga vlera e rekomanduar është arkëtuar vlera 69320 lekë është në proces zbatimi vlera 164,140,225 lekë, është analizuar vlera 108,429 lekë si dhe nuk është analizuar vlera 19,760,332 lekë.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Roskovec rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 49/12 datë. 08.07.2022, ndërsa nga Bashkia Roskovec për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.6631/1 Prot. datë 01.08.2022. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Roskovec është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 7086 datë. 29.07.2022 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Roskovec, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 49/12 datë. 08.07.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 08.03.2023.

Nga ana e Bashkisë Roskovec nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH. Pra nuk është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Pa zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Roskovec ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 49/12 datë. 08.07.2022, dhe nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin Bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Pa zbatuar

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Roskovec 21 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa dhe janë në proces zbatimi 13 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa organizative si dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë në nivelin “mjaftueshëm”, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. në sektorë të ndryshëm. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara si dhe plan-veprimi për monitorimin e Sistemit MFK. E gjithë kjo procedurë është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108,

datë 17.11.2016, Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Roskovec e miratuar me Vendim të Kryetares së Bashkisë me shkresën nr. 793 prot., datë 19.02.2019 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Roskovec, të marren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022, për zbatimin e rekomandimit është ngarkuar Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se janë bërë disa trajnime për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe legjislacionit për Financat Vendore. (*Bashkëngjitur tabelat e trajnimeve për vitin 2022 dhe 2023, si dhe fotokopje të e-maileve të konfirmimit të pjesëmarrjes së punonjësve në trajnimet përkatëse*).

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar se në njësinë e auditit të brendshëm, dy auditues nuk janë të certifikuar dhe nuk kanë eksperiencë pune, si dhe mungon trajnimi i tyre. Në dosjet e auditimeve të kryera mungojnë: memo e planifikimit të hartuara me përlllogarritjet e vlerësimit të riskut sipas koeficientit të riskut dhe përcaktimin e madhësisë së kampionit sipas fushave të auditimit, letrat e punës së audituesve, si dhe vlerësimet e cilësisë. Në raportet e auditimit nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara dhe nuk janë përcaktuar përgjegjësitë si dhe rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe nuk i referohen konkretisht çdo gjetjeje. Auditimet e kryera për sektorët me risk të lartë si prokurimet, planifikimi e zhvillimi i territorit, menaxhimi i aseteve, sektori i bujqësisë, burimet njerëzore etj janë vetëm të karakterit përshkruar (inventarizues) nuk janë të thelluara dhe nuk ka analiza për proceset e kryera në dokumentacionet e paraqitura nëse janë në përputhje me kriteret e pranuar. Nuk është kontrolluar dhe dokumentuar si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë së Bashkisë dhe në njësitë e vartësisë. Nuk ka program angazhimi për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm. E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 11, 20, me MAB të miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 pika 2.6 "nënpika (c) dhe pika 3.5 "kapitulli III fq34, kapitulli IV pikat 4.1.7 - 4.1.12 kapitulli IV pika 4.1.1; kapitulli VI pika 6.1 "Niveli i dokumentimit"; Kapitulli VII pika 7.1.1 dhe Dokumentet Standarte. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për certifikimin dhe trajnimin e dy audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditit të

brendshëm të kryeje vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022, për zbatimin e rekomandimit është ngarkuar Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se

1. Punonjësja Znj. G. Z. me detyrë “Specialiste e Sektorit të Auditit të Brendshëm”, prej datës 28.09.2022 nuk është më në marrëdhënie pune në institucionin tonë pasi ka dhënë dorëheqjen, referuar, Vendimit Nr. 125 datë 28.09.2022.

2. Punonjësja Znj. E. Ç. me detyrë “Specialiste e Sektorit të Auditit të Brendshëm”, ndjek procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sezonin 2022 -2023 që prej muajit nëntor 2022 e deri aktualisht dhe është në përfundim të certifikimit.

(Bashkëlidhur, fotokopje të e-maileve të pjesëmarrjes së kësaj punonjëseje në leksionet për certifikimin si auditues i brendshëm).

Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Për hartimin e PBA-së për periudhën 2020-2022 dhe 2021-2023, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Roskovec nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, përkatësisht:

- VKB për tavanet përgatitore dhe ato përfundimtare të shpenzimeve për çdo program buxhetor për PBA-në e vitit 2021-2023;
- Nuk është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë PBA 2020-2022;
- Raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve që përmban të dhëna për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme buxhetore (ku përfshihen metodologjia e përdorur për parashikimin, analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimit të atyre ekzistuese, dhe analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre), sipas Udhëzimit nr. 27, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023, pika I/ 2 dhe 3”;
- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33;
- Këshilli Bashkiak nuk ka miratuar, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor të vitit përkatës;
- Për hartimin e PBA-së nuk janë përgatitur kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Roskovec. Drejtoria Ekonomike nuk disponon asnjë dokumentacion lidhur me dëgjesa publike për konsultimin e buxheteve afatmesme me komunitetin dhe grupet e interesit;
- Nuk janë respektuar afatet kohore në miratimin nga ana e Këshillit të dokumenteve të projekt buxhetit afatmesëm, paraqitja e kërkesave buxhetore dhe kërkesave buxhetore shtesë, dokumenti përfundimtar i PBA 2021-2023;
- Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;
- Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik;

- Relacioni që shoqëron PBA-në 2020-2022, nuk është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzimit nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", p.sh në relacion nuk trajtohen risqet financiare dhe fiskale të Bashkisë dhe objektivat e synuara për periudhën afatmesme, si dhe ky relacion nuk është dërguar në MFE;
- Kryetari i Bashkisë Roskovec nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të Bashkisë.

Këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 33, 34, 35, 36, 37, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 27 datë 10.07.2020, në hartimin, zbatimin dhe dërgimin e PBA-së 2021-2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Këshilli Bashkiak Roskovec të marrë Vendimin për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33, e specifikuar brenda datës 31 Dhjetor si dhe të miratojë tavanet e buxhetit afatmesëm, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave referuar Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022, për zbatimin e rekomandimit është ngarkuar Drejtoria Ekonomike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.106 date 17.12.2021 është bërë miratimi i "Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor" për vitin 2022. Sipas PBA, 2022-2024 janë përcaktuar "Përshkrimi i çdo programi"; "Politikat e programit"; "Qëllimi Politikës së programit"; "Objektivat e politikës së programit".

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr. Programe	shënime
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë		
2022-2024	342/1	11.02.2021	342/1	11.02.2021	miratim kalendari	106	24.12.2021		
					miratim tavaneve të shpenzimeve	17	17.03.2021	19	në afat
					miratimi i tabelave të PBA	46	30.06.2021	19	në afat

Burimi: Drejtoria e Financës

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Ndryshimet e bëra në buxhet për vitet 2020 dhe 2021, rezulton:

- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektiveve të synuar të Bashkisë;
- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;
- Kryetari i Bashkisë Roskovec për vitet 2020-2021 nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, "...Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda afateve, të dokumentoj se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se

Miratimi i taveve të buxhetit afatmesëm 2022-2024 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 94, datë 29.06.2021, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 105, datë 24.12.2021, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Roskovec për vitet 2022-2024”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr.103 datë 24.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Fier me shkresën nr.03/1 date 11.01.2022.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Roskovec për vitet 2020-2021 ka hartuar dhe dërguar në MFE, 3 raporte monitorimi ku përveç monitorimit të 4-mujorit të II-të të vitit 2021, 2 raportet e tjera të monitorimit nuk janë dërguar brenda afateve ligjore, si dhe nuk janë dërguar raporte monitorimi vjetore për periudhën objekt auditimi. Kryetari i Bashkisë Roskovec në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Kryetari i Bashkisë Roskovec nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit nuk janë të plota pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore, këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Shtojca 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojca 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Roskovec të merren masa për hartimin në përputhje me kërkesat ligjore dhe dërgimin në ishtucionet përkatëse të raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit sipas afateve të përcaktuara, Bashkia të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022, për zbatimin e rekomandimit është ngarkuar Drejtoria Ekonomike. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Bashkia ka dërguar në MFE raportet e momotorimit si vijon:

4-mujori i pare me shkresën nr. 5462 prot date 30.05.2022.

4-mujori i dyte me shkresën nr. 8749 prot, date 26.09.2022.

4-mujori i trete me shkresën nr. 1239 prot date 27.02.2023.

6. Gjetje nga auditimi: Rezulton që detyrimet e prapambetura të Bashkisë Roskovec të jenë në vlerën 285,907,642 lekë për vitin 2020 dhe në vlerën 169,778,730 lekë për vitin 2021. U konstatuan pasaktësi në të dhënat e paraqitura në PBA mbi detyrimet e prapambetura. Nga kryqëzimi i të dhënave të PBA-së që mbulon periudhën 2020-2021 me listën e detyrimeve të prapambetura konfirmuar nga Dega e Thesarit Fier rezultojnë mospërputhje në shumën e stokut referuar Formatit C3, për vitin 2020 vlera rezulton 76,267,558 lekë me një diferencë 213,679,374 lekë nga shuma në bilanc, rakordimi në Degën e Thesarit dhe raportimi në MFE, si dhe një diferencë prej 209,640,084 lekë më shumë nga dokumentet analitike të Bashkisë Roskovec. Për vitin 2021, vlera në PBA rezulton 144,404,184 lekë me një diferencë 25,374,546 lekë më shumë nga dokumentet analitike të Bashkisë Roskovec.

Gjithashtu, u konstatuan mospërputhje e vlerës totale të detyrimeve të prapambetura që janë raportuar nga Bashkia Roskovec në MFE krahasuar me vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc. Për vitin 2020, në bilanc vlera e detyrimeve është 289,946,932 lekë, ndërsa në dokumentet analitike të Bashkisë rezulton vlera 285,907,642 lekë me një diferencë 4,039,290 lekë më pak.

Për vitin 2020 Bashkia Roskovec nuk ka respektuar detyrimet ligjore lidhur me raportimin e detyrimeve të prapambetura në MFE duke raportuar vetëm një herë në vitin 2021 (shkresa nr. 1531 Prot, datë 26.02.2021).

Për vitin 2021 janë dërguar në MFE 2 raportime për detyrimet e prapambetura nga Bashkia Roskovec (shkresa nr. 3945, datë 31.05.2021 dhe shkresa nr. 6511, datë 30.09.2021) duke raportuar vetë dy herë për vitin 2021 dhe jashtë afateve të përcaktuara, këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 109”. Këto veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014, pika 4. Ligji nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101, Udhëzimi i MFE nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 109. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2.Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresën nr.6342prot date 26.6.2022 është dërguar raport për situatën financiare në të cilën ndodhet Bashkia Roskovec Këshillt Bashkiak dhe me vendimin nr. 48 date 29.06.2022 Këshilli Bashkiak ka miratuar raportin e planit të masave për daljen nga situata e vështirësisë. Dërguar për miratim Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1239 prot date 27.02.2023. Si pasoje e masave të mara detyrimet e prapambetura me 31.12.2022 janë në shumën 65,119,199 leke nga 175,882,374 leke ne 31.12.2021

Zbatuar pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Metodologjia që DTTV përdor për të realizuar planifikimin vjetor të taksave dhe tarifave vendore nuk bën të mundur një parashikim real të të ardhurave të veta të Bashkisë Roskovec. Me qëllim analizimin e treguesve të planifikimit dhe realizimit të taksave dhe tarifave vendore nga DTTV në Bashkinë Roskovec u kërkua informacion lidhur me metodologjinë që zbatohet në hartimin e planifikimit vjetor të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Rezulton se, ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të Bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Për vitin 2020, 5 zëra janë realizuar në masën mbi ose 100%, 3 zëra janë realizuar në masën mbi ose 75%, 5 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 9 zëra është realizuar në masën mbi ose 25% dhe 6 zëra janë realizuar nën masën 25%.

Për vitin 2021, 5 zëra janë realizuar në masën mbi ose 100%, 5 zëra janë realizuar në masën mbi ose 75%, 8 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 5 zëra është realizuar në masën mbi ose 25% dhe 3 zëra janë realizuar nën masën 25%.

Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ka ardhur nga mos realizimi i të ardhurave nga Taksa mbi të Drejtën e Kalimit të Pronës, Tarifë Kontrolli Veterinar, Tarifë për Qira Ndërtese, Tarifë për Qira Trualli, etj., këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Udhëzimi të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022"; Për vitin 2020 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec është miratuar me VKB-në 105, datë 22.11.2019 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2020”; Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec është miratuar me VKB-në nr. 88, datë 02.12.2020 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Roskovec të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të Bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike kanë bërë një planifikim për vitin 2021 të bazuar mbi realizimin e vitit 2020 dhe mbi pritshmërinë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 .Për vitin 2020 planifikim nga të ardhurat e veta ishte 456,381 mijë lekë kurse për vitin 2021 është 365,224 mijë lekë. Kjo ulje ka qenë e theksuar konkretisht me shumë në tre zëra .Në planifikimin e të ardhurave të veta për vitin 2021 në vlerën 91,157 mijë lekë ka ardhur si rezultat i vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë Vlorë, me nr. 1240 me datë 28.09.2015 dhe nr.131 me datë 31.03.2016 për rimbushim të taksave të pagabuara padrejtësisht për vitin 2015 nga ana e kompanisë Bankës kundrejt Bashkisë Roskovec, Bashkia Roskovec ka detyrimin ti kthej vlerën 59,921,400. Më datë 14.10.2020 është lidhur marrëveshja mbi shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore me nr. prot 5414 , neni 3, shprehet se shume prej 19,973,800 leke detyrime që Bashkia Roskovec duhet ti kompensoje Bankersit do te zbriten nga taksat e vitin 2021. Referuar për sa me sipër vlerës prej 123,298,105 planifikuar si taksë ndërtesë për vitin 2020 është zbritur shuma prej 19,973,800 leke. Pra për vitin 2021 është planifikuar një taksë ndërtesë në vlerën 103,299 mijë lekë.

Gjithashtu në planifikim e viti 2021 është ulur planifikimi i të ardhurave nga qiraja e aseteve në pronësi të Bashkisë (truall, ndërtesë, tokë bujqësore) nga 52,374 mijë lekë që ishte në vitin 2020 në vlerën 10,559 mijë lekë për vitin 2021 referuar të ardhurave të realizuara dhe planifikimit që Bashkia Roskovec ka për dhënie me qera të aseteve në pronësi të vetë.

Në zërin të ardhura të tjera në planifikim e viti 2021 është ulur në vlerën 45,000 mijë lekë në krahasim me planifikimin e vitin 2020 që ishte në vlerën 54,691 mijë lekë.

Në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Gjobat e vendosura nga IMTV për periudhë 2020-2021 rezultojnë të mos jenë kontabilizuar nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec, edhe pse drejtoria e IMTV ka njoftuar për këto gjoba të vendosura me shkresë nr. 4596 prot., datë 11.09.2020, shkresën nr. 6030 prot., datë 09.11.2020 dhe shkresës nr. 6219 prot., datë 17.09.2021 “Mbi masat administrative të vëna nga IMT”, Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore, lidhur me gjobat e vendosura dhe ndjekjen e tyre sipas kërkesave ligjore dhe realizimin e ekzekutimit të këtyre kundërvajtjeve. Nuk është ndërmarrë asnjë masë nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec për tu kontabilizuar këto gjobat, këto veprime në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli 1, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec të marrë masa të kontabilizojë gjobat e vendosura nga Drejtoria e IMTV, sipas rregullave të përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2.Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi drejtoria Ekonomike nuk ka bërë kontabilizimin e gjobave të IMTV ne llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” referuar pasqyrave financiare të vitit 2022.

Pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Rezulton Bashkia Roskovec ka lidhur:

- 16 akt marrëveshje për të ndihmuar familje debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2020;
- 39 akt marrëveshje për të ndihmuar familje debitore në e detyrimeve me këste për vitin 2021; dhe
- 9 akt marrëveshje për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2021;

Për vitin 2020 rezulton se 7 prej tyre i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa 9 subjektet e tjera nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa për vitin 2021, 35 subjekte dhe familje debitore nuk i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes ndërsa 13 prej tyre i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes.

Nga analizimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se kemi mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht;

- Në asnjë rast nuk kemi kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste;
- Në asnjë rast nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste;

- Në pjesën më të madhe të akt marrëveshjeve të nënshkruara nuk është shënuar periudha e detyrimit të subjektit dhe në një rast detyrimet e periudhës/vitit janë bërë pjesë e aktmarrëveshjes. Në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, pika 2,3,4,5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Roskovec gjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë të marrë masat që këto akt marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022, për zbatimin e rekomandimit është ngarkuar Drejtoria e të Ardhurave Vendore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për shkak se subjektet debitorë nuk kanë zbatuar afatet e pagesës ka kërkuar zgjidhjen e akt-marrëveshjeve nga Drejtoria Juridike.

Në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Roskovec si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se: Drejtoria Ekonomike në Bashkia Roskovec dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mosbesueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. Veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3 pikat 14 e 15 dhe nenin 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësisë Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Brenda 9-mujorit të vitit 2022

10.2.Nga verifikimi rezultoi se:, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2019 u konstatua se; në disa llogari konkretisht llog.(210); llog.(211); llog.(212); llog.(486) nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2020 si më poshtë vijon;

1. Llog.(210)“*Toka, troje, terrene*” nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe truallit përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Roskovec nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19 të datës 16.01.2019, në të cilin detyrohet si Njësi të cilës i kalon prona me vlerë 30,755,412 lekë e përbërë nga ndërtesë dhe truall.

2. Llog. (211) *“Pyje, Kullota, Plantacione”* nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk ka reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse 208,21 Hektarë të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 *“Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”*, e ndryshuar pika 24, shtojca me nr.22, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec, me numrin rendor 1 (një) deri 24 (njëzetë e katër) për të cilën duhet të bëhet sistemim dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse, ose në shënimet shpjeguese.

3. Llog.(212) *“Ndërtime e Konstruksione”* nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 30 objekte me sipërfaqe truall nën objekt të objekteve prej 23,303 m² të trashëguara nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/komunitat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qënë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të *“Ndërtesave e Konstruksioneve”* nga Bashkia Roskovec nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Gjithashtu godina në të cilën ushtron aktivitetin e saj Administrata e Bashkisë Roskovec, është financuar nga Buxheti i Shtetit dhe vlera e investimit me objekt *“Projekti Zhvillimor i Bllokut nr.2, Roskovec”*, sipas kontratës së lidhur është në shumën 232,483,780 lekë me TVSh. Nga titullari i Bashkisë Roskovec, Sektori i Pronave dhe Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre. Për sa më sipër Llog. 212 *“Ndërtime e konstruksione”* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2020.

4. Llog.(486) *“Shpenzime të periudhave të ardhshme”* nuk paraqet pamjen reale pasi kemi një mospërputhje në vlerë me një diferencë 4,039,290 lekë më pak midis raportimit që bën Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike e Bashkisë Roskovec tek Ministria e Financave, me vlerën e pasqyruar në Pasqyrat Financiare. Për vitin 2020 në bilanc vlera e detyrimeve është 289,946,932 lekë, ndërsa në dokumentet analitike të Bashkisë rezulton vlera 285,907,642 lekë.

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me Ligji nr. 68/2017 “Përfinancat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika (1); (2), VKM Nr 433 dt. 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 35, shtojca me nr.33, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet dhe kullotat në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive të PF. llog. 210 “Toka, troje, terrene” dhe llog. 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”.

11.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat e duhura që:

1. Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llog. 210 dhe llog. 211, dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.

2. Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

11.3 Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike duhet të marrë masa për rakordimin e llogarisë 486 me Ministrinë e Financave dhe reflektimin e saj në Pasqyrat Financiare të vitit vijues.

Menjëherë

11.4. Nga verifikimi rezultoi se: Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në process zbatimi.

Në proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2020 rezulton se; nga Bashkia Roskovec nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajtjes kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-33. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Brenda 9-mujorit të vitit 2022

12.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe

reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në process zbatimi.

Në proces zbatimi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Llogaria 468 në vitin 2019 paraqitet në shumën 57,871,238 lekë, ndërsa për vitin 2020 në shumën prej 142,325,599 lekë. Gjatë vitit 2020 shtesa prej 84,454,361 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Roskovec dhe Njësive vartëse. Gjithashtu janë likuiduar gjatë vitit 2020 debitorë të viteve të mëparshme për shumën 49,869,267 lekë. Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2019 në Llog 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, paraqiten në vlerën 5,804,424 lekë ndërsa në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 10,336,038 lekë. Rritja prej 4,531,614 lekë gjatë vitit 2020 ka ardhur si rezultat i marrjes së angazhimeve financiare të cilat nuk janë likuiduar në kohë, duke mbartur dhe detyrimet ndaj furnitorëve të gjeneruara gjatë vitit. Nga auditimi në lidhje me likuidimin e faturave më sipër rezulton se disa prej detyrimeve të prapambetura janë likuiduar gjatë vitit 2020 në vlerën 5,109,028 lekë, me urdhër shpenzimet përkatëse. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Roskovec rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe garantimin e pagesave në kohë. Në rastet e mos likuidimit në kohë nuk rezulton asnjë analizë apo shpjegim ndaj nëpunësit autorizues. *Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Roskovec, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë.

Brenda datës 30.03.2023

13.2.Nga verifikimi rezultoi se; Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në process zbatimi.

Në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: Nga analiza dhe verifikimi i llogarisë 600 paga e shpërblime, të raportuara për PF të vitit 2020, rezulton se në bilancin e konsoliduar paraqitet në shumën 158,471,681 lekë, ndërsa në pasqyrën statistikore formati nr.8 paraqitet në shumën 136,233,791 lekë, kjo pasi; në pasqyrën përkatëse të Bashkia Roskovec paraqitet në shumën 97,074,622 lekë, në Njësinë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Administrative paraqitet në shumën 7,147,920 lekë dhe në Ndërmarrjen Pastrim Gjelbërim dhe Mirëmbajtje Varrezash paraqitet në shumën 32,011,209 lekë. Pas shpjegimeve të dhëna nga Drejtoria Ekonomike, u arrit në konkluzion se gabimi qëndronte në Njësinë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Administrative e cila nuk kishte kalkuluar në shumatoren e fondit të pagave vlerat e punëtorisë por, pavarësisht kësaj, u ri kalkuluan të dhënat sipas pasqyrave të secilës njësi shpenzuese dhe përsëri shumatorja e formatit nr.8, nuk korrespondonte me shumën e fondit të pagave të raportuar në Pasqyrat financiare. Shuma e

raportuar paraqitet në 158,471,681 lekë ndërkohë që shuma sipas formatit të konsoliduar rezulton të jetë në 155,109,815 lekë pra, me një diferencë 3,361,866 lekë. Kjo shumë tregon një mosraportim të drejtë të rezultatit të llogarisë 601 pasi, kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të raportuara në Këshillin e Bashkisë dhe Degës së Thesarit Fier. *Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandim: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të marrë masat e duhura për ri kalkulimin e të dhënave për pagat, si dhe kryerjen e veprimeve sistemuese në PF vijuese. Gjithashtu, të mbajë parasysh verifikimin e kësaj llogarie me dokumentacion përkatës, për raportimin sipas kuadrit ligjor.

Në vijimësi

14.2.Nga verifikimi rezultoi se; Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në process zbatimi.

Në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare në lidhje me auditimin e tyre rezulton se; Për vitin 2020, nuk është kryer auditim ligjor mbi pasqyrat financiare raportimin dhe rezultatin financiar. Nga titullari i Bashkia Roskovec nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e opinionit nga auditues të jashtëm mbi të cilin do të konkludohej për problematikat e hasura ndër vite të gjendjes së llogarive, shqyrtimin më pas në Këshillin Vendor në cilësinë e përdoruesve të Pasqyrave Financiare, dhe hartimin e një plani të detajuar veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit ku më pas të raportohej rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 68, datë 227.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", kreu IX, neni 50, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masat e duhura që të kryejë auditim të pasqyrave financiare për çdo vit, me qëllim njohjen e situatës dhe raportimit financiar nga përdoruesit për të bërë të mundur vendimmarrjen më të mirë në kohën e duhur të drejtimit financiar të Njësisë Vendore Roskovec.

Në vijimësi

15.2.Nga verifikimi rezultoi se; Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në process zbatimi.

Në proces zbatimi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2020 në lidhje me zërin (troje, pyje, kullota, ndërtime, rrugë, rrjete, etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Roskovec, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit

troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Roskovec pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. *Veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe neni 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Brenda datës 30.09.2022

16.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në proces zbatimi.

Në proces zbatimi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e procesit të inventarizimit fizik të “aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra” (materiale e jomateriale) dhe “inventar qarkullues” të pasurisë, aseteve dhe vlerave materiale në përdorim të Bashkia Roskovec, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr.167, administruar me shkresën nr. 6307, datë 23.11.2020, “Për inventarizimin e aktiveve të njësisë për vitin 2020”, me komisionet përkatëse. Komisionet do të bëjnë verifikimin e ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve, detyrimeve dhe të kapitaleve të veta të institucionit, Njësitë Administrative Kuman, Krujan dhe Strum, kopshtet, shkollat si dhe pallati i kulturës. Nga verifikimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit konstatohet se: Në disa raste, fletë inventarët fizik rezulton se, ato nuk janë të nënshkruara nga punonjësi me përgjegjësi materiale si dhe nga anëtarët e komisionit. Gjithashtu në disa raste kur është mbajtur procesverbal për nxjerrje nga përdorimi, nuk ka asnjë person përgjegjës material dhe procesverbali është nënshkruar vetëm nga anëtarët e komisionit, duke vijuar më pas me nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Në urdhrin e krijuar për kryerjen e procesit të inventarizimit të vitit 2020 rezulton se në komision janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit, në kushtet e konfliktit të interesit. Pra këta punonjës kanë nënshkruar edhe si anëtarë të komisionit të kryerjes së inventarizimit edhe në cilësinë e punonjësit me përgjegjësi materiale. Gjithashtu rezulton se komisioni i vlerësimit është i njëjti i cili ka kryer dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. *Veprime jo në përputhje Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 15 “Inventari i aktiveve e detyrimeve”; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve”, pika 81-82, pika 85 pika 86, pikat 96-100. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të marrin masa që në të ardhmen, në procesin e inventarizimit, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, përbërja e komisioneve të jetë në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor.

17.2 Rekomandimi: Anëtarët të cilët marrin pjesë në procesin e inventarizimit, të kryejnë me përpikmëri detyrën e ngarkuar deri në nënshkrimin e plotë të fletëve të inventarit.

17.3 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të marrë masat e duhura në vijimësi për procesin e inventarizimit ku, përbërja e komisionit të vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të jetë i ndryshëm me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Në vijimësi

17.4. Nga verifikimi rezultoi se: Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në proces zbatimi.

Në proces zbatimi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me aktivet e nxjerra jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre, konstatohet se; Nuk janë hartuar rregulla dhe procedura për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Nuk ka procedurë për vlerësimin dhe ndikimin që kanë në mjedis, të materialeve elektronike që janë nxjerrë jashtë përdorimit. Vlera totale e materialeve të inventarit të cilat janë asgjësuar është në shumën 3,783,487 lekë nga të cilat 3,209,374 lekë inventar ekonomik dhe 574,113 lekë material i imët. Në përbërje të listës së aktive ka pajisje IT dhe telekomunikacioni, elektronike si dhe materiale metalike të cilat duhet të klasifikoheshin si materiale për shitje skrap. Në përbërje të listës së aktiveve të vlerësuara jashtë përdorimit dhe, që duhet të dalin nga regjistri i aktiveve të Institucionit, ka materiale elektronike të cilat konsiderohen të dëmshme dhe nuk duhet të hidheshin apo të asgjësoheshin, pa një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim, si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. ***Nga Titullari i Bashkia Roskovec nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk ka asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.*** Materialet e asgjësuar sipas komisionit janë transportuar, djegur dhe groposur në vendin e quajtur pika e grumbullimit të mbeturinave. Bashkëlidhur praktikës së asgjësimit ndodhej një set fotokopje fotografish, të cilat nuk japin një pamje të arsyeshme për justifikimin dhe vërtetësinë e asgjësimit të tyre pasi; në foton e paraqitur te vendi në të cilën janë hedhur materialet, nuk mbulojnë të gjitha ato materiale, fotot e të cilave janë bërë në ambientet në ku ishin grumbulluar për tu dërguar më pas për asgjësim. Urdhërat për këto procedura janë ngritur nga zj. M. B. në cilësinë e Kryetarit të Bashkia Roskovec dhe Nëpunësi Autorizues z. S. Ç.. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me procesin e inventarizimit fizik, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve për periudhën objekt auditimi konstatohet gjithashtu se nga Titullari i Njësisë nuk është hartuar Gjurma Standarte e Auditit. *Veprime e mosveprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10431, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8, pika 8 germa ç), neni, 9, neni 12, neni 16, pika 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2012, "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", kreu I, pika 1 dhe pika 2, kreu VII, pika 1, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve*

në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 35, 36, 106, 109, 121 e 122. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të marrin masa në të ardhmen që, në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve, të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit, gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

18.2 Rekomandimi: Titullari i Njësisë Vendore Roskovec të marrë masat për hartimin e gjurmës së auditit me qëllim identifikimin e vijueshmërisë dhe monitorimit të veprimtarisë së aktivitetit.

Në vijimësi

18.3.Nga verifikimi rezultoi se:, Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në proces zbatimi.

Në proces zbatimi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së kryerjes së inventarit për vitin 2020 u konstatua se; Procedura nuk është kryer e rregullt pasi; komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit, në përbërje të tij, nuk ka asnjë specialistë të fushës për aktivet që janë vlerësuar si jashtë funksionit të tyre, kryesisht në fushën elektronike, mekanike dhe elektrike. Ka fletë inventari të cilat nuk janë të nënshkruara nga punonjësi me përgjegjësi materiale, gjithashtu ka fletë inventari të cilat nuk janë nënshkruar nga komisioni i inventarizimit. Nga titullari i njësisë N/A, nuk janë miratuar rregulla për procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të Bashkia Roskovec dhe Njësisë të vartësisë. Procesi i vlerësimit nuk është kryer në përputhje me kriteret e UMF pasi në listën e aktiveve të nënshkruara për vlerësim nga komisioni, mungojnë elementët e normave të amortizimit, riaftësimit, afateve të skadencës, shkalla e riparimit, arsyet e mos riparimit, niveli i dëmtimit, etj. Nga komisioni i cili ka kryer procesin e vlerësimit dhe është shprehur për nxjerrje jashtë përdorimit nuk është argumentuar për çdo aktiv arsyeja e daljes nga përdorimi por cilësohet vetëm J/P pa dhënë shpjegime të detajuara. *Veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 8/ç, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 103. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 56-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec, Nëpunësi Autorizues, Drejtoria Ekonomike, të marrë masat e duhura që, të përcaktohen rregulla e kritere për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në proceset e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, si dhe të caktohet një specialist i fushës me qëllim vlerësimin e një procesi sa më efektiv dhe eficient. Gjithashtu, anëtarët e komisioneve të kryejnë në përputhje me udhëzimin përkatës procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve si dhe të argumentohet për çdo rast arsyeja e daljes jashtë përdorimit të aktivitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Nga grupi i auditimit është bërë verifikimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresës nr. 568/44 datë. 29.07.2022 në lidhje me auditimin e Pasqyrave financiare të vitit 2021, për të cilat është evidentuar dhe statusi i tyre dhe reflektimi në pasqyrat financiare të vitit 2022. Për këtë shkak rekomandimet e sipërcituara do të konsiderohen në proces zbatimi.

Në proces zbatimi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 1335 prot datë 20.03.2019, me objekt “Rehabilitimi i qendrës së fshatit Strum”, Bashkia Roskovec dhe kontratës me nr. 4482 prot datë 02.11.2018, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Kuman – Luar – Vidhishtë, Pr 1900-4100, L=2210 ml, b=4+2x0.5 m”, Bashkia Roskovec, u konstatua se mungon Leja e ndërtimit/Leja infrastrukurore e objektit, në kundërshtim me Ligjin nr. Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 39. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 135-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandim: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për pajisjen me leje ndërtimi për të gjitha objektet që janë të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që të paraqesin gjendjen reale të objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022, për zbatimin e rekomandimit është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2022 për investimet e zhvilluara nga Bashkia Roskovec janë pajisur me leje ndërtimi për të gjitha objektet që janë të përcaktuar nga ligji.

Zbatuar

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar , neni 9, pika 3/c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Në Bashkinë Roskovec struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZhT).

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se:

Për vitin 2020 janë legalizuar 93 objekte me detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë 2,682,685 lekë. Kanë paguar detyrimin 5 qytetarë në shumën 145,175 lekë. Janë debitorë 88 qytetarë në shumën 2,537,510 lekë. Për vitin 2021 janë legalizuar 76 objekte me detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë 2,558,005 lekë. Kanë paguar detyrimin 30 qytetarë në shumën 1,090,564 lekë. Janë debitorë 46 qytetarë në shumën 1,467,441 lekë.

Pra, për periudhën 2020-2021 janë debitor 134 qytetarë me vlerë totale 4,004,951 lekë dhe nga vitet e mëparshme në vlerë totale 19,540,471 lekë, që përbën në total 23,545,422 lekë, të ardhura

të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligjin nr. 95/2018 “ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c; Ligjin nr. 98/2020 “ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”; VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5. Për vitin 2020 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec është miratuar me VKB-në 105, datë 22.11.2019 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2020”; Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec është miratuar me VKB-në nr. 88, datë 02.12.2020 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për **134 objekte** të legalizuara me **vlerë 23,545,422 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Roskovec të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Fier. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **25,177,147 lekë** për 861 persona, ndërsa shtesat për vitin ushtrimor buxhetor 2022 janë në vlerën **1,859,562 lekë** për 61 persona, në total vlera e detyrimit është 21,845,762 lekë për 882 persona e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Roskovec *(sipas listës të administruar në CD).*

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Roskovec u konstatua se për periudhën 01.04-31.12.2020 janë mbajtur në total 18 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Është dhënë 1 masa për “*Prishje të objekteve të kundërligjshëm*” si dhe 8 masa “*Dënim me gjobë*”. Vlera totale e gjobave të vendosura për periudhën 01.04-31.12.2020 është 900,000 lekë. Janë paguar vetëm 3 gjoba të këtij viti me vlerë 200,000 lekë dhe 5,000 lekë kamatë vonesë, dhe mbeten 700,000 lekë nga ky vit të papaguara.

Për periudhën nën auditim nuk është paguar në mënyrë vullnetare disa nga gjobat e vendosura nga IMTV. Për gjobat e vendosura në vitet 2020-2021 nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV ka njoftuar subjektet kundërvajtës dhe ka njoftuar me shkresat si më lart, Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore. Përkatesisht, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore nuk ka “dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë”.

Për vitin 2021 janë mbajtur në total 15 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 4 masa për “*Pezullim të punimeve*”, 1 masa për “*Prishje të objekteve të kundërligjshëm*” si dhe 3

masa “Dënim me gjobë”. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2021 është 515,000 lekë. Është paguar vetëm 1 gjoba e këtij viti me vlerë 100,000 lekë dhe 2,000 lekë kamatë vonesë, dhe mbeten 415,000 lekë nga ky vit të papaguara.

Pra për periudhën 01.04.2020-31.12.2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 1,115,000 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e IMTV e Bashkisë Roskovec të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **1,115,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike janë marrë masat e nevojshme me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të paligjshme.

Konkretisht, për gjobat e pashlyera i jemi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe i janë dërguar gjithsej 6 (gjashtë) kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit ndaj këtyre gjobave:

1. Kërkesë nr. 9607 prot, datë 25.10.2022, “Për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit, për titullin ekzekutiv, Vendim i IMT Bashkia Roskovec nr. 03, datë 07.04.2020 “Për dënim me gjobë” për subjektin A. A. – 500,000 lekë;
2. Kërkesë nr. 9608 prot, datë 25.10.2022, “Për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit, për titullin ekzekutiv, Vendim i IMT Bashkia Roskovec nr. 05, datë 14.08.2020 “Për dënim me gjobë” për subjektin P.K. – 50,000 lekë;
3. Kërkesë nr. 9609 prot, datë 25.10.2022, “Për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit, për titullin ekzekutiv, Vendim i IMT Bashkia Roskovec nr. 07, datë 10.09.2020 “Për dënim me gjobë” për subjektin V. D. – 50,000 lekë;
4. Kërkesë nr. 9610 prot, datë 25.10.2022, “Për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit, për titullin ekzekutiv, Vendim i IMT Bashkia Roskovec nr. 08, datë 11.09.2020 “Për dënim me gjobë” për subjektin P. D. – 50,000 lekë;
5. Kërkesë nr. 9611 prot, datë 25.10.2022, “Për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit, për titullin ekzekutiv, Vendim i IMT Bashkia Roskovec nr. 04, datë 24.04.2020 “Për dënim me gjobë” për subjektin S. D. – 50,000 lekë;
6. Kërkesë nr. 9612 prot, datë 25.10.2022, “Për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit, për titullin ekzekutiv, Vendim i IMT Bashkia Roskovec nr. 14, datë 28.12.2021 “Për dënim me gjobë” për subjektin P. T. – 110,000 lekë.

Deri në momentin e verifikimit nuk kemi ende një vendim nga ana e Gjykatës për këto kërkesa.

Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Roskovec dhe masat e marra për uljen e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me menaxhimin e borxhit tatimor, u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore. Gjendja e debitorëve progres për subjektet fizik/juridik paraqitet deri në 31.12.2020 në vlerën 13,076,514 lekë dhe në 31.12.2021 në vlerën 13,281,752 lekë.

Ndërsa familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifrat e pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit, Truall dhe Mirëmbajtje kanal Kullimi, të cilat paraqiten në vlerat si mëposhtë:

Për vitin 2020

Detyrimet për taksën e tokës bujqësore janë në shumën 82,058,038 lekë;
Detyrimet nga taksat dhe tarifrat familjare janë në shumën 39,189,083 lekë;
Detyrimet nga taksat dhe tarifrat e bizneseve në shumën 13,076,514 lekë;
Në total borxhi tatimor në fund të vitit 2020 paraqitet në shumën 134,323,635 lekë.

Për vitin 2021

Detyrimet për taksën e tokës bujqësore janë në shumën 78,741,256 lekë;
Detyrimet nga taksat dhe tarifrat familjare janë në shumën 47,162,928 lekë;
Detyrimet nga taksat dhe tarifrat e bizneseve në shumën 13,281,752 lekë;
Në total borxhi tatimor në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 139,185,936 lekë.
Pra, në fund të vitit 2021 gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik është 13,281,752 lekë, për taksën e tokës dhe 78,741,256 lekë dhe për taksat dhe tarifrat familjare 47,162,928 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec në total **139,185,936 lekë**.

Këto në kundërshtim me Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **139,185,936 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë Ekonomike.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022, për zbatimin e rekomandimit është ngarkuar Drejtoria e të Ardhurave Vendore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2022 ka dërguar në fund të viti listën e subjekteve debitorë te Drejtorisë Ekonomike, e cila ka bërë kontabilizimin e debitorëve. Gjendja e debitorëve është trajtuar më hollësisht në akt konstatimin nr. 7 datë 04.08.2023.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Roskovec për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregimit të lëndëve djegëse me pakicë 11 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifrat vendore për vitet 2020-2021.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatuan disa mungesa, përkatësisht:

- Mungonin pjesërisht autorizimet nga Bashkia Roskovec për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesës së detyrimit ligjor për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesave të detyrimeve tatimore vjetore.

Në kundërshtim me Ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2, pika 11. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **293,867 lekë** secili ndaj Bashkisë Roskovec.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Drejtoria e të Ardhurve Vendore ka marre mase për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizim, nëpërmjet shkresës me nr. 3102 prot. me date 05.05.2022 ju është dërguar për njohje dhe zbatim Drejtorisë Rajonale Tatimore.(Bashkëlidhur shkresën)

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Roskovec rezultojnë 14 qiramarrës të cilët kanë paguar detyrimin rregullisht, ndërsa nga 5 kontratat e lidhura për shitje të pasurisë së paluajtshme subjekti “M. B.” (për 20,796 lekë) dhe “T. L.” (për 48,524 lekë) nuk kanë paguar detyrimet e kontratës. Detyrimi që subjektet kanë ndaj Bashkisë Roskovec duke filluar nga 18.03.2021 dhe 23.03.2021 janë në vlerën totale 69,320 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec, në kundërshtim me Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat që subjekti “M. B.” (për 20,796 lekë) dhe “T. L.” (për 48,524 lekë) të paguajnë detyrimin dhe të ndiqet më përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave shitjes së pasurive të paluajtshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2.Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2021 që subjekti “M. B.” (për 20,796 lekë) dhe “T. L.” (për 48,524 lekë) kanë paguar detyrimet sipas pastës bankarë përkatëse.

Zbatuar

6-10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimin e 10 procedurave me vlerë të fondit limit **245,095 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 10 procedura **me vlerë kontrate 236,834 mijë lekë** ose 97 % e vlerës së Fondit Limit, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, vendosje jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e kontratave me vlerë 19,761,032 lekë pa TVSH, me OE të cilët nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe janë shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike në tre procedura për vlerën **19,761,032 lekë pa Tvsh, respektivisht:**

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Karburant, vaj dhe graso për Ndërmarrjen e Pastrimit, Gjelbërimin dhe Mirëmbajtjes së Varrezave*”. Bashkia Roskovec, Viti 2020, me fond limit 2,666 mijë lekë, me fitues BOE “A” Shpk & “O.” Shpk, me vlerë të ofertës **2,614 mijë lekë**, ku ka rezultuar se KLLFLST e NJP nuk ka zbatuar kuadrin ligjor në përlllogarritjen e fondit limit dhe aplikimin e kriterëve në DT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Karburant, vaj dhe graso për Bashkinë Roskovec*” i ndarë në lote:

“Loti 1 Karburant për mjetet e Bashkisë”

Loti 2 “Karburant, vaj dhe graso për mjete e Bordit të Kullimit

Loti 3 “Blerje karburanti për mjetet e Sektorit të MZSH-së dhe Arsimit”, Bashkia Roskovec, Viti 2020, me fond limit 9,159 mijë lekë (Loti I, me fond limit 2,666, mijë lekë; Loti II, me fond limit 4,582 mijë lekë; Loti III, me fond limit 1,910 mijë lekë), me fitues OE “A” Shpk me vlerë të ofertës 2,274 mijë lekë pa Tvsh (Loti 1), ku ka rezultuar se KLLFLST e NJP nuk ka zbatuar kuadrin ligjor në përlogarritjen e fondit limit dhe aplikimin e kriterëve në DT, për pasojë janë anuluar dy lote. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Blerje karburanti për mjetet e Sektorit të MZSH-së dhe Arsimit*”, Bashkia Roskovec, Viti 2020, me fond limit **1,910** mijë lekë, rezulton të jetë anuluar dhe rishpallur sërish, me arsyen se nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore, AK, nuk ka vepruar sipas përcaktimev të nenit 73/2 të VKM nr. 914 datë 29.12.2018, pasi nuk ka analizuar shkaqet e dështimit të procedurës. me fitues OE “D” Shpk, me vlerë të ofertës 1,830 mijë lekë pa Tvsh, ku ka rezultuar se KLLFLST e NJP nuk ka zbatuar kuadrin ligjor në përlogarritjen e fondit limit dhe aplikimin e kriterëve në DT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Karburant, vaj dhe graso për mjetet e bordit të kullimit*”, Bashkia Roskovec, Viti 2020, me fond limit 4,582 mijë lekë, rezulton të jetë anuluar dhe rishpallur sërish, me arsyen se nuk është paraqitur asnjë nga dy konkuresit ofertë të vlefshme, AK, nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të nenit 73/2 të VKM nr. 914 datë 29.12.2018, pasi nuk ka analizuar shkaqet e dështimit të procedurës. me fitues BOE “A” Sha & “O” Shpk, me vlerë të ofertës 4,354 mijë lekë pa Tvsh, ku ka rezultuar se KLLFLST e NJP nuk ka zbatuar kuadrin ligjor në përlogarritjen e fondit limit dhe aplikimin e kriterëve në DT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion i rrugëve të lagjes Shahallarëve, fshati Kuman*”, Bashkia Roskovec, Viti 2021, me fond limit 6,174 mijë lekë, rezulton të jetë anuluar dhe rishpallur sërish, me arsyen se nuk është paraqitur asnjë nga dy konkuresit ofertë të vlefshme, AK, nuk ka vepruar sipas përcaktimev të nenit 73/2 të VKM nr. 914 datë 29.12.2018, pasi nuk ka analizuar shkaqet e dështimit të procedurës, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, me fitues BOE “V.” & “A.” Shpk “me ofertë 6,060 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **6,060,072 lekë pa Tvsh** (7,272,926 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës rreth-rrotullimi Vajza Myzeqare Roskovec*”, Bashkia Roskovec, **Viti 2021**, me fond limit 7,551 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar asnjë nga problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT, me fitues BOE “A.” Shpk & “Z.” Shpk me ofertë 7,544 mijë lekë, ku ka rezultuar mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit. Nga vendosja jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence, si dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **7,544,160 lekë paTvsh** (9,052,992 (lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Adaptimi i objektit të ish-tualeteve në kopështe dhe çerdhe*”, Bashkia Roskovec, Viti 2021, me fond limit 12,822 mijë lekë, rezulton të jetë anuluar dhe rishpallur sërish, me arsyen se nuk është paraqitur asnjë nga dy konkuruesit ofertë të vlefshme, AK, nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të nenit 73/2 të VKM nr. 914 datë 29.12.2018, pasi nuk ka analizuar shkaqet e dështimit të procedurës, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, me fitues BOE “B.” Shpk & “L.” Shpk me ofertë 9,347 mijë lekë, ku ka rezultuar mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit. Nga vendosja jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence, si dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **9,347,790 lekë paTvsh** (11,217,348 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës rreth-rrotullimi Vajza Myzeqare Roskovec-Marinëz P0-P245*”, Bashkia Roskovec, Viti 2021, me fond limit 6,160 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar asnjë nga problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT, me fitues OE “Z.” Shpk me ofertë 6,156 mijë lekë, ku ka rezultuar mungesa e argumentimit të kriterëve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit. Nga vendosja jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence, si dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **6,156,100** (7,387,320 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Përmirësimi i furnizimit me ujë të Njesisë Administrative Strum*” (Rikonstruksion i ujsjellësit të fshatit Suk1, Suk 2 Strum dhe Velmish 2)”, Bashkia Roskovec, Viti 2021, me fond limit 188,512 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, me fitues BOE “F.” Shpk & “S.” Shpk, ku ka rezultuar se administratori i OE “F.” Shpk ka deklaruar në kushtet e deklaramit të remë. AK rezervon të drejtën e verifikimit të vërtetësisë së deklaratës, e të vepronte në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma ”a” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Karburant, vaj dhe graso*”, për Bashkinë Roskovec, për vitin 2021, i ndarë në lote:

Loti 1 “*Karburant për mjetet e Bashkisë*”

Loti 2 “*Karburant, vaj dhe graso për mjete e Bordit të Kullimit*”

Loti 3 “*Blerje karburanti për mjetet e Sektorit të MZSH-së dhe Arsimit*”,

Loti 4 “*Karburant, vaj dhe graso për Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave*”,

Loti 5 “*Blerje karburanti vaj dhe graso për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjes*”, Bashkia Roskovec, Viti 2021, me fond limit **12,051** mijë lekë (Loti I, me fond limit 1,409, mijë lekë; Loti II, me fond limit 3,749 mijë lekë; Loti III, me fond limit 1,781 mijë lekë, Loti IV, me fond limit 3,110 mijë lekë, Loti V, me fond limit 1,999 mijë lekë), me fitues OE “A.” Shpk me vlerë të ofertës 2,274 mijë lekë pa Tvsh (Loti 1), ku ka rezultuar se KLLFLST e NJP nuk ka zbatuar kuadrin ligjor në përlllogarritjen e fondit limit, ndarjen në lote dhe aplikimin e kriterëve në DT. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **19,761 mijë lekë** pa TVSH. Të

konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rehabilitimi i qendrës së fshatit Strum”*, Bashkia Roskovec, konstatohet se është ndryshuar tipi i shtyllave të ndriçimit nga shtylla me H=7 m dhe D=16 cm, në shtylla me H=4.5 m (nga verifikimi në terren, konstatohet se diametri i shtyllës është 10 cm). Çmimi i shtyllës së re të aprovuar është 15,500 lekë/copë, nga 16,500 lekë/copë që ishte çmimi i shtyllës së ofertuar. Argumenti i ndryshimit të shtyllës është “...për të bërë të mundur qëndrueshmërinë dhe cilësinë e punimeve”. Nga sa më sipër, nuk ka asnjë argument teknik bindës, si për ndryshimin e tipit të shtyllave të ndriçimit, ashtu edhe për çmimin e ri të miratuar (për shtyllë me gjatësi 35 % më të ulët, me diametër 38% më të vogël, çmimi i miratuar është 6% më i ulët). Nga rilogaritja sipas elementeve të kostos, çmimi i zërit të punës “FV shtylla metalike për ndriçim, H=4.5m”, e cila është vendosur në fakt, duhet të jetë 11,079 lekë/copë. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 5421 lekë/copë (për numrin e shtyllave të vendosur në vepër, 20 copë), **me vlerë totale 108,429 lekë, është përdorim i fondeve pa ekonomikitet.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 135-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë përgjegjësitë për miratimin e çmimeve të reja pa u bazuar në manualet e miratuara të çmimeve, me vlerën ekonomike më të mirë dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës për negociimin e çmimeve të reja, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë, më mënyrë që objektet e ndërhuara me financim nga Bashkia, të ndërtohen me sa më pak shpenzime dhe pa cënuar cilësinë e punimeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhrin e Brendshëm Nr. 21, datë 08.02.2022 “Për zbatimin e detyrimeve ligjore nga Komisionet e Llogarritjes së Fondit Limit” janë përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë që duhet të zbatojnë Komisionet e Llogarritjes së Fondit Limit për përllogarritjen e vlerës limit të kontratës në përputhje me legjislacionin e prokurimit.

Zbatuar

D. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,707,879 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rehabilitimi i qendrës së fshatit Strum”*, Bashkia Roskovec, me vlerë të kontratës (me tvsh) 12,707,249 lekë, realizuar nga BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK, rezultuan diferenca në volume

pune të pakryera në fakt në vlerën 245,771 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1335 prot datë 20.03.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 135-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **245,771 lekë pa tvsh** nga BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1335 prot datë 20.03.2019, me objekt “Rehabilitimi i qendrës së fshatit Strum”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datë 31.10.2022

1.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Drejtoria ekonomike ka bërë kontabilizimin e detyrimit të konstatuar nga KLSH dhe me shkresën nr. 8871/2 date 20.10.2022 është dërguar njoftim BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK për shlyerje detyrimit në vlerën **245,771 lekë pa tvsh**. Deri në momentin e verifikimit nuk është bërë likuidimi i vlerës se sipërcituar.

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni i rrugës “Kuman – Luar – Vidhishtë, Pr 1900-4100, L=2210 ml, b=4+2x0.5 m”**, Bashkia Roskovec, me vlerë të kontratës (me tvsh) 37,668,893 lekë, realizuar nga BOE “P.” SHPK & “B.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,226,085 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4482 prot datë 02.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe BOE “P.” SHPK & “B.” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 135-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,226,085 lekë pa TVSH** nga BOE “P.” SHPK & “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4482 prot datë 02.11.2018, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Kuman – Luar – Vidhishtë, Pr 1900-4100, L=2210 ml, b=4+2x0.5 m””, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datë 31.10.2022

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Drejtoria ekonomike ka bërë kontabilizimin e detyrimit të konstatuar nga KLSH dhe me shkresën nr. 8871/2 date 20.10.2022 është dërguar njoftim “P.” SHPK & “B.” SHPK për shlyerje detyrimit në vlerën **1,226,085 lekë pa tvsh**. Deri në momentin e verifikimit nuk është bërë likuidimi i vlerës se sipërcituar.

Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut”**, Bashkia Roskovec, me vlerë të kontratës (me tvsh) 37,668,893 lekë, realizuar nga BOE “A.” SHPK & “Z.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 236,023 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4444 prot datë 25.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe BOE “A.” SHPK & “Z.” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 135-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **236,023 lekë pa TVSH** nga BOE “A.” SHPK & “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4444 prot datë 25.07.2019, me objekt “Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut”,

Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datë 31.10.2022

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Drejtoria ekonomike ka bërë kontabilizimin e detyrimit të konstatuar nga KLSH dhe me shkresën nr. 8871/2 date 20.10.2022 është dërguar njoftim BOE “A.” SHPK & “Z.” SHPK për shlyerje detyrimit në vlerën 236,023 lekë pa tvsh. Deri në momentin e verifikimit nuk është bërë likuidimi i vlerës se sipërcituar.

Zbatuar pjesërisht

E. MASAT DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Roskovec t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në dokumentet e auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.
- Në mos marrjen së masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, neni 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.
- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se nga Titullari i Autoritetit kontraktor nuk është ngritur Komisioni Disiplinor për të bërë verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH.

Pa zbatuar

V- Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Roskovec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 49/12 prot datë. 08.07.2022, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre nuk është zbatuar dhe nuk rikërkohen si rekomandime të pa zbatuara pasi zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual janë rekomandimet:

A- MASA ORGANIZATIVE

1.1.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Roskovec, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e

një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë

2.2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për certifikimin dhe trajnimin e dy audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në F.t me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditit të brendshëm të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë

3.6.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Menjëherë

4.8.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec të marrë masa të kontabilizojë gjambat e vendosura nga Drejtoria e IMTV, sipas rregullave të përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

Menjëherë

5.10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **19,761 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë

publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë

D. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,707,879 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **245,771 lekë pa tvsh** nga BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1335 prot datë 20.03.2019, me objekt “Rehabilitimi i qendrës së fshatit Strum”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datë 31.10.2022

*1.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Drejtoria ekonomike ka bërë kontabilizimin e detyrimit të konstatuar nga KLSH dhe me shkresën nr. 8871/2 date 20.10.2022 është dërguar njoftim BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK për shlyerje detyrimit në vlerën **245,771 lekë pa tvsh**. Deri në momentin e verifikimit nuk është bërë likuidimi i vlerës se sipërcituar.*

Zbatuar pjesërisht

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,226,085 lekë pa TVSH** nga BOE “P.” SHPK & “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4482 prot datë 02.11.2018, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Kuman – Luar – Vidhishtë, Pr 1900-4100, L=2210 ml, b=4+2x0.5 m”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datë 31.10.2022

*2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Drejtoria ekonomike ka bërë kontabilizimin e detyrimit të konstatuar nga KLSH dhe me shkresën nr. 8871/2 date 20.10.2022 është dërguar njoftim P.” SHPK & “B.” SHPK për shlyerje detyrimit në vlerën **1,226,085 lekë pa tvsh**. Deri në momentin e verifikimit nuk është bërë likuidimi i vlerës se sipërcituar.*

Zbatuar pjesërisht

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **236,023 lekë pa TVSH** nga BOE “A.” SHPK & “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4444 prot datë 25.07.2019, me objekt “Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më datë 31.10.2022

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit nr. 7086 prot datë. 29.07.2022 Drejtoria ekonomike ka bërë kontabilizimin e detyrimit të konstatuar nga KLSH dhe me shkresën nr. 8871/2

date 20.10.2022 është dërguar njoftim P.” SHPK & “B.” SHPK për shlyerje detyrimit në vlerën 236,023 lekë pa tvsh. Deri në momentin e verifikimit nuk është bërë likuidimi i vlerës së sipërcituar.

Zbatuar pjesërisht

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Roskovec ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat e konsideruara të pa zbatuara të cilat janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e Bashkisë.

Kriteri:

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), *ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime,*

Shkaku:

Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës **1,707,879** lekë.

Ndikimi/Efekti:

Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Roskovec.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim:

Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara si vijon;

Për 5 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Roskovec, të marren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për certifikimin dhe trajnimin e dy audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditit të brendshëm të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

3.6.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

4.8.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec të marrë masa të kontabilizojë gjambat e vendosura nga Drejtoria e IMTV, sipas rregullave të përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

5.10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Për 3 masë shpërblim dëmi në vlerën 1,707,879 lekë si vijon:

1.1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **245,771 lekë pa tvsh** nga BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1335 prot datë 20.03.2019, me objekt “Rehabilitimi i qendrës së fshatit Strum”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,226,085 lekë pa TVSH** nga BOE “P.” SHPK & “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4482 prot datë 02.11.2018, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Kuman – Luar – Vidhishtë, Pr 1900-4100, L=2210 ml, b=4+2x0.5 m”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **236,023 lekë pa TVSH** nga BOE “A.” SHPK & “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4444 prot datë 25.07.2019, me objekt “Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Titulli i gjetjes: *Bashkia Roskovec është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

Situata:

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 568/44 prot datë. 29.07.2022 i ka dërguar Bashkinë Roskovec **Vendimin 132, datë 28.07.2022**, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 6 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 masa, nga të pranuarat është zbatuar 1 masa dhe është në proces zbatimi 1 masa organizative, zbatuar pjesërisht 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të

ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Roskovec rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr 568/44 datë. 29.07.2022, ndërsa nga Bashkia Roskovec për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 7124/1 Prot. datë 09.08.2022. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Roskovec është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 7279 datë. 09.08.2022 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Roskovec, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 568/44 datë. 29.07.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 29.03.2022.

Nga ana e Bashkisë Roskovec nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH. Pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkëlur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se:* Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Pa zbatuar

3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

B. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Roskovec 6 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 masa, është zbatuar 1 masa dhe është në proces zbatimi 1 masa organizative, zbatuar pjesërisht 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Roskovec si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria Ekonomike në Bashkia Roskovec dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “*Bartës Informatik*”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin

dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3 pikat 14 e 15 dhe nenin 11 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësisë Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Brenda 31.12.2022

1.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në date 07.08.2023 Projekti ‘Bashki të Forta’, i ka nisur email Bashkisë për mundësimin e ofrimit të mini-grante në fushen e:

Financës së Bashkisë – Instalimin e programit të licencuar të paketës “Microsoft Office” për përdorim nga stafi i Bashkisë në opsionin share folder, ku çdo përdorues ka akses.

2. Pajisje e sallës së Këshillit Bashkiak me mjetet e duhura/ laptop, camera/ microfone/ etj me qëllim që të mundësohet transmetimi live/ drejtpërdrejt i mbledhjeve të KB për publikun.

Sa më sipër Bashkia Roskovec nuk ka parashikur në buxhet për vitin 2023 fond për mundësimin e një programi kompjuterik financiar. Ky parashikim do të mbahet në konsideratë në vijim duke qenë se nga ky projekt nuk u mundësua programi kompjuterik. (bashkëngjitur email nga Projekti ‘Bashki të Forta’)

Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2021 u konstatua se; në disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2021 konkretisht;

1. Llog. (210) “Toka, troje, terrene” nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe truallit përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Roskovec nuk janë reflektuar saktë ndryshimet në këtë llogari sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19 të datës 16.01.2019, në të cilin detyrohet si Njësi të cilës i kalon prona me vlerë 30,755,412 lekë, pasi kjo vlerë nuk është e ndarë se sa është ndërtesë dhe sa truall.

Nuk janë kryer ndryshimet përkatëse pasi nuk rezulton të jetë pasqyruar VKM 29.09.2021, për *Sipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh; e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP.*

2. Llog. (211) “Pyje, Kullota, Plantacione” nuk paraqet gjendjen reale sepse edhe pse ka reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse 208,21 Hektarë të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të

Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar pika 24, shtojca me nr.22, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec, nuk ka kryer inventar për gjendjen fizike të këtyre aktiveve, për të cilën auditimi nuk mund të shprehet me siguri.

3. Llog. (212) “*Ndërtime e Konstruksione*” nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 30 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 23,303 m² të trashëguara nga ish Komunitat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunitat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të “*Ndërtesave e Konstruksioneve*” nga Bashkia Roskovec nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Gjithashtu godina në të cilën ushtron aktivitetin e saj Administrata e Bashkisë Roskovec, është financuar nga Buxheti i Shtetit dhe vlera e investimit me objekt “*Projekti Zhvillimor i Bllokut nr.2, Roskovec*”, sipas kontratës së lidhur është në shumën 232,483,780 lekë me TVSh. Nga titullari i Bashkisë Roskovec, Sektori i Pronave dhe Drejtoria Ekonomike rezulton të jetë regjistruar në llogarinë përkatëse ndërtesa e Bashkisë së Re, por nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre. Gjithashtu për vlerën e raportuar si shtesë gjatë vitit, nuk është llogaritur amortizimi i cili duhet të llogaritet nga momenti i marrjes në dorëzim të aktivitetit dhe vënies në shfrytëzim të tij. Për sa më sipër Llog. 212 “*Ndërtime e konstruksione*” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2021.

4. Llog. (213) “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” nuk paraqet pamjen reale pasi në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse sipas VKM datë 29.09.2021, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.802, datë 30.9.2015, të këshillit të ministrave, “Për vënien në dispozicion të shoqërisë trans Adriatik pipeline ag (tap ag), nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridorit i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans Adriatik (projekti TAP)”*”, për ndryshimet përkatëse në llogarinë 213, për kalimin e 38 metra lineare, në total 14,457 m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 2,838 m² pa kompensim; si dhe sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 metra linear, në total 5,755 m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1,304 m².

5. Llog. (520) (Disponibilitete në thesar) nuk paraqet një pamje reale pasi; në pasqyrat financiare në fund të vitit 2020 rezulton në shumën 106,831,971 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 në shumën 75,433,269 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 (*kreditorë në ruajtje*) e cila paraqitet në shumën 57,303,684 dhe llog. 85 (*teprica e periudhës*) e cila paraqitet në shumën 18,129,585 lekë. Në ekstraktin e rakordimit të paraqitur nga sistemi i Thesarit llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Roskovec, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të Thesarit.

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me Ligji nr. 68/2017 “*Përfinancat e qeverisjes vendore*”, neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu (VI) “*Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, pika (1); (2), VKM Nr. 433 dt. 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*”, pika 35, shtojca me nr.33,

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, 50, Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në PF.

2.1.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Roskovec nuk ka marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec.

Pa zbatuar

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat e duhura që;

a-Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.

b-Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

2.2.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Nga ana e Bashkisë Roskovec është ngritur urdhri nr. 10336 prot, date 25.11.2022 “Për inventarizimin e aktiveve të njësisë për vitin 2022”, në të cilën është përcaktuar edhe inventarizimi i ndërtesave

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i llogarisë 486 (*shpenzime të periudhave të ardhshme*) rezulton se; kjo llogari paraqitet në shumën 289,946,932 lekë në fund të vitit 2020. Për periudhën 2021 nga ana e Bashkinë Roskovec janë bërë përpjekje për uljen e detyrimeve ku detyrimet e lindura gjatë vitit 2021 paraqiten në shumën 72,398,933 lekë si dhe shlyerjet paraqiten në shumën 192,829,153 lekë. Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc në llogarinë 486 përputhet me shumën e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me Degën e Thesarit për vitin 2021. Referuar dokumentacionit të audituar, që disponon Bashkia, lidhur me likuidimin e detyrimeve për vitin 2021 rezulton se, shuma e detyrime të prapambetura më datë 31.12.2021 është 169,731,367 lekë. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Roskovec rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe garantimin e pagesave në kohë. Në rastet e mos likuidimit në kohë nuk rezulton asnjë analizë apo shpjegim ndaj nëpunësit autorizues, veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Roskovec, miratuar me vendimin pa nr., pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3.

Nga kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga Dega e Thesarit, rezulton se gjatë vitit 2021 janë likujduar 13 raste në shumën 47,969,662 lekë të cilat i përkisnin si datë fature vitit 2018, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2021 për tu likujduar. Janë likujduar 33 raste në shumën 77,035,471 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2019, ndërkohë që janë regjistruar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021 dhe 54 raste në shumën 53,179,933 lekë fatura të cilat i përkisnin vitit 2020, ndërkohë që janë regjistruar për tu paguar si fatura për tu likujduar gjatë vitit 2021. Gjithashtu referuar të dhënave të marra nga sistemi SIFQ rezulton të ketë fatura të vitit 2021 të cilat janë regjistruar dhe likujduar në sistem në vitin 2022, fatura të cilat i përkasin shpenzimeve apo detyrimeve të vitit 2021 në shumën 7,581,104 lekë.

Kjo ka ardhur si pasojë e marrjes së angazhimeve duke mos patur fonde buxhetore në dispozicion duke mos lejuar ekzekutimin e tyre. Pra duke mos patur fonde faturat nuk deklarohen si të pagueshme brenda 30 ditëve, por mbahen të pa regjistruara deri në hapjen e fondeve të nevojshme për pagesën e tyre, çka do të thotë se strukturat përgjegjëse kanë patur dijeni për këto detyrime dhe duke mos patur fonde në dispozicion, kanë shlyer vetëm një pjesë të tyre. Këto veprime çojnë në prishjen e hallkave të kontrollit të brendshëm në lidhje me parandalimin dhe detektimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61, nenin 54, “Kryerja e pagesave”, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1, nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë.

3.1.2.Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresën nr.6342prot date 26.6.2022 është dërguar raport për situatën financiare në të cilën ndodhet Bashkia Roskovec Këshillit Bashkiak dhe me vendimin nr. 48 date 29.06.2022 Këshilli Bashkiak ka miratuar raportin e planit të masave për daljen nga situata e vështirësisë. Dërguar për miratim Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1239 prot date 27.02.2023. Si pasoje e masave të mara detyrimet e prapambetura me 31.12.2022 janë në shumën 65,119,199 leke nga 175,882,374 leke ne 31.12.2021.

Zbatuar pjesërisht

3.2. Rekomandimi: Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për paraqitjen në kohë me besueshmëri të shpenzimeve dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në Pasqyrat Financiare me qëllim, raportim të drejtë të situatës financiare të Njesisë.

Brenda datës 31.12.2022

3.2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar Pasqyrave financiare dërguar me shkresën përcjellëse nr. 2145 prot. datë 31.03.2023 konfirmuar nga Dega e Thesarit Fier është bërë paraqitja në kohë e shpenzimeve dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në Pasqyrat Financiare.

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2021 rezulton se; nga Bashkia Roskovec nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim,

përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-33. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Brenda 31.12.2022

4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar Pasqyrave financiare dërguar me shkresën përcjellëse nr. 2145 prot. datë 31.03.2023 konfirmuar nga Dega e Thesarit Fier është përditësimi i regjistrave kontabël përsa i përket vitit ushtrimor 2022, por ngelet për tu përditësuar aktivitetet përpara vitit 2015 pasi mukojnë kartelat përkatëse.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021 në lidhje me zërin (Tokë, truall, ndërtesa, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Roskovec, rezultoi se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtoria Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Roskovec pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe neni 15, me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Brenda datës 31.12.2022

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Roskovec nuk ka bërë plotësimin me dokumentacion pronësor, si dhe nuk ka kryer reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Pa zbatuar

V- Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Roskovec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 568/44 prot datë. 29.07.2022, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre nuk është zbatuar dhe nuk rikërkohen si rekomandime të

pa zbatuara pasi zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual janë rekomandimet:

MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Roskovec 6 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 masa, nga të pranuarat është zbatuar 1 masa dhe është në proces zbatimi 1 masa organizative, zbatuar pjesërisht 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1.1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangjen e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

2.2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive

3.3.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë.

4.5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njesisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Roskovec ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat e konsideruara të pa zbatuara të cilat janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual.

Menjëherë

Kriteri:

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), *ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime,*

Shkaku:

Mos ndjekja e gjitha procedurave ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara.

Ndikimi/Efekti:

Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Roskovec.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim:

Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara si vijon;

Për 4 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

2.2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive

3.3.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë.

4.5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njesisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë në nivelin “mjaftueshëm”, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. në sektorë të ndryshëm. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara si dhe plan-veprimi për monitorimin e Sistemit MFK. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23 dhe 24. -Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Roskovec. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 faqe 19-34 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij;
- Për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve;

- Hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit;
- Të aplikojë programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit nga Bashkia Roskovec.
- Të organizojë trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se Bashkia Roskovec është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë dhe një Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta vetëm përgjegjësi është pajisur ndërsa të tjerët nuk janë të pajisur me certifikatën e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 dhe të VKM Nr.83, Datë 03/02/2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3., ndërkohë vërehet se një nga audituesit është në proces certifikimi, kurse audituesi i tjetër është me arsimim jo të mjaftueshëm (bachelor), pa certifikuar si auditues dhe jo në hapa procesi trajnimi apo certifikimi gjë që automatikisht sjell një auditim jo në nivele të kënaqshme.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin Nr.114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

-NJAB nuk ka kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM Nr.83, Datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin Nr.5 dhe Nr.6 të ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Miratimi i strategjisë së riskut mbetet një nga pikat me sensitive në lidhje me mungesën e hartimit të strategjive në nivel sektori e drejtorie për arritjen e këtij synimi.

-Audituesit e brendshëm në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmbëpulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve dhe nuk është bërë në afatin e përcaktuar në Konkluzione mbi problematikat e punës si auditues. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 faqe 19-34 të Raportit të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për mbylljen e procesit të certifikimit dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se Bashkia Roskovec në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 174,850 mijë lekë. Në buxhetin vjetor 2022 është likuiduar vlera 159,611 mijë lekë, ose 91.2% e vlerës së detyrimit

Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjate vitit 2022, kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022 .

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (174,850-65,119), me 109,731 mijë lekë, ose në masën prej 62%. Ndërsa detyrimet e krijuara gjat vitit 2022 janë në vlerën 49,880 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar detyrimet e prapambetura paraqiten në aneksin nr. 5 pika 2 bashkëlidhur Raportit të auditimit. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 35-42 të Raportit të Auditimit).*

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Roskovec dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Roskovec për vitin ushtrimor 2022 kanë ushtruar aktivitetin 11 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte kanë mbyllur aktivitetin. Është pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 1 subjekt konkretisht B. me nipt L.....R dhe ka paguar detyrimet në vlerë 1,000,000 lekë si dhe janë pajisur me autorizim 3 dhe 4 vjeçar 3 subjekte të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 3,200,000 lekë si dhe nuk janë pajisur me autorizim 4 subjekte. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 93 datë 26.11.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 42-57 të Raportit të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës, të ndërmar të gjitha procedurat ligjore për pajisjen me autorizim të 4 subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë respektivisht:

Subjekti A. me nipt K.....A

Subjekti E.me nipt K.....J

Subjekti L. me nipt L.....V

Subjekti B. me nipt L.....A

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 janë lidhur 27 kontrata me operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë

Roskovec, të cilët nuk kanë hapur nipt sekondar si dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore, që lindin ndaj Bashkisë Roskovec për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki. Nga sektori i prokurimeve nuk është dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës. Sa më sipër mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 “Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë Bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”, VKB nr. 93, datë 25.11.2021 për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 42-57 të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandimi Sektori i prokurimeve në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Roskovec, të marri masa të menjëhershme për llogaritjen e vlerës së detyrimit sipas paketës fiskale nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Roskovec, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezultoi se në llogarinë. 468 “Debitorë të ndryshëm” janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore familjarë dhe biznesi në vlerën **166,380,720 mijë lekë**, por nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **21,845,762** lekë për 758 persona, si dhe nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMT –ja dhe Policia Bashkiake në vlerën 1,043,000 lekë të akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2022 në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 49-62 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandim Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Roskovec të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog.468 “debitorë të ndryshëm”, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë por të ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

7.Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezultoi se gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,868,600 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 28,601,463 lekë, ku diferenca në ulje prej 17,732,863 lekë i përket lëvizjeve të aktiveve si dhe vlerës së amortizimit. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në totalin e llogarisë 202- *Studime dhe kërkime*”, për 21 projekte drejtoria e financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 49-62 të Raportit të Auditimit).

7.1.Rekomandim Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

8.Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezultoi se në 5 raste në procedurat e prokurimit publik, njësia e prokurimit nuk ka argumentuar kriteret e vendosur kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht në procedurat me objekt si vijon:

- 1- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamion për mbledhjen e mbetjeve dhe kontenier”, zhvilluar në vitin 2022.
- 2- Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i banesave Ekzistues” zhvilluar në vitin 2022.
- 3- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjecare 5 Dëshmoret ,Suk 1, Ambienteve sportive dhe Ndërtimi i palestrës , Bashkia Roskovec.”, zhvilluar në vitin 2022.
- 4- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Vidhishtë- Drizë,1470 ml (Asfaltim) b=4m+2*0.5”, zhvilluar në vitin 2022.
- 5- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemimi i qendrës Marinëz +ndërtim rrethrotullimi”, zhvilluar në vitin 2022.

Veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 62-98 të Raportit të Auditimit).

8.1.Rekomandim Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret e veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se në procedurën e prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave Ekzistuese”, ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “J.” SHPK” për të cilën është lidhur kontrata datë 06.10.2022 për vlerën 9,534,932 lekë pa TVSH dhe vlera 11,441,918 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës , i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 62-98 të Raportit të Auditimit).

9.1.Rekomandim Titullari i AK Bashkia Roskovec, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit me të dhënat:-

Leje ndërtimi nr. ----, datë 10.01.2022 me zhvillues: D. H. i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: nid: k.....j; Leja e ndërtimit për objektin: “Magazine shërbimi 1 kat” adresa e realizimit të punimeve: qyteti Roskovec. Sipas pasaportës për atë njësi strukturore konkretisht RO_UB_A2_70/21 dhe RO_UB_A1_70/59 përdorimi kryesor A i lejuar për atë njësi strukturore është 100 % “Banim” që do të thotë se objekte të llojit magazinë nuk mund të ndërtohen. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1 faqe 102-108 të Raportit të Auditimit).*

10.1.Rekomandim Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të respektohet përdorimi i lejuar për njësinë strukturore përkatëse ku do të zhvillohet ndërtimi i ri. Në rastin konkret përdorimi i lejuar në atë njësi strukturore është 100 % banim.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se Leje ndërtimi nr. prot ----, datë 19.04.2022 i jepet: zhvilluesit: X. Ç. .Leja e ndërtimit për objektin: “Kompleks magazinash shërbimi 1 kat (2 cope)” adresa e realizimit të punimeve:Qyteti Roskovec,afati kohor i kësaj leje është: 12 jave. Për lejen me të dhënat e mësipërme u konstatua se në njollën ku do të ndërtohet një nga objektet e reja sipas lejes nga verifikimi me anë të programit Google Earth konstatohet se në po atë njollë të jetë një objekt ekzistues.Në planevndosjen e miratuar ky objekt ekzistues nuk është pasqyruar Në këtë rast kemi të bëjmë me gjendje ku vihet re prania e një objekti ekzistues në njollën ku është miratuar leja e ndërtimit dhe nuk ka një leje prishje për objektin ekzistues për ti lënë rrugë objektit të ri që do ndërtohet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1 faqe 102-108 të Raportit të Auditimit).*

11.1.Rekomandim Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi sipas kushteve të domosdoshme për të miratuar një leje ndërtimi ku njëra prej tyre është planëvendosja e objektit në gjendjen ekzistuese. Në këtë rast kemi të bëjmë me gjendje ku vihet re prania e një objekti ekzistues në njollën ku është miratuar leja e ndërtimit dhe nuk ka një leje prishje për objektin ekzistues për ti lënë rrugë objektit të ri që do ndërtohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi Leje ndërtimi nr. prot ----, datë 19.04.2022 i jepet: zhvilluesit: X. Ç. leja e ndërtimit për objektin: “Kompleks magazinash shërbimi 1 kt (2 cope) “adresa e realizimit të punimeve: qyteti Roskovec afati kohor i kësaj leje është: 12 jave nuk është marrë mendim nga AZHT(Agjencia e zhvillimit të territorit). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1 faqe 102-108 të Raportit të Auditimit).*

12.1.Rekomandim Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të jenë marrë më para miratimit të sajë mendimet nga institucionet e tjera konkretisht në këtë rast nga AZHT.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi Leja e zhvillimit me nr. prot ---- për në parcelën me nr. pasurie 62/10 Zona Kadastrale 3537 ,sipërfaqe 10840 m², me pronar z.I. H. dhe në marrëveshje midis pronarit të tokës dhe zhvilluesit subjektit “G.” sipas kontratës së qerasë me nr.45 Rep. Nr.21 Kol,të ndodhur në adresën: fshati Suk 1, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec .Nga llogaritjet e vëllimit të objektit konstatohet se ai e kalon vlerën 10840 që do të thotë se ky raport ta kalojë atë të lejuar që është 1 m³/m². *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1 faqe 102-108 të Raportit të Auditimit).*

13.1.Rekomandim Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të respektohet intesiteti i lejuar që është 1m³/m² në objekte për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore.

14.Gjetje nga auditimi Leje ndërtimi nr.----, datë 19/10/2022 i jepet: zhvilluesit: Y. R. dhe Dallandyshe Rrezhda i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: manol goga leja e ndërtimit për objektin: shtese anesore+ 1k mbi objektin ekz 1k banim adresa e realizimit të punimeve: Roskovec. nga planvendosja konstatohet se distancat janë 1.3 m dhe 1.1 m në orientimet perëndimore dhe veriore, distanca minimale e lejuar duhet të ishte 3m. Distanca në orientimin lindor ku është dhënë dhe leja për shtesë verande nuk është pasqyruar në planvendosjen e miratuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1 faqe 102-108 të Raportit të Auditimit).*

14.1.Rekomandim: Nga DPKZHT Roskovec të merren masa për të miratuar leje ndërtimi ku të respektohen distancat e lejuara nga kufiri i pronës bazuar mbi rregullin ku distanca e lejuar nga kufiri i pronës duhet të jetë është nr.i kateve+1m.

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

15.Gjetje nga auditimi Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Roskovec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 49/12 prot datë. 08.07.2022, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre nuk është zbatuar dhe nuk rikërkohen si rekomandime të pa zbatuara pasi zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë si se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre. **Statusi i zbatimit të rekomandimeve është si vijon:**

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 21 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa dhe janë në proces zbatimi 13 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa organizative si dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative.

b.1 Për masat shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa në vlerë 1,707,879 lekë pa Tvsh nga të cilat deri në datën e verifikimit janë njoftuar subjektet për arkëtimin vullnetar të detyrimit, por nuk kanë kryer pagesën.

c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohet vlera 164,209,545 lekë si dhe të analizohet vlera 19,868,761 lekë për të cilat rezulton se nga vlera e rekomanduar është arkëtuar vlera 69,320 lekë është në proces zbatimi vlera 164,140,225 lekë, është analizuar vlera 108,429 lekë si dhe nuk është analizuar vlera 19,760,332 lekë.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.1 faqe 114-151 të Raportit të Auditimit).*

15.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara si vijon;

Për 5 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Roskovec, të marren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arrijtjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga

menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për certifikimin dhe trajnimin e dy audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditit të brendshëm të kryeje vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

3.6.1 Rekomandimi: Bashkia Roskovec të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

4.8.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec të marrë masa të kontabilizojë gjobat e vendosura nga Drejtoria e IMTV, sipas rregullave të përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

5.10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

Për 3 masë shpërblim dëmi në vlerën 1,707,879 lekë si vijon:

1.1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **245,771 lekë pa tvsh** nga BOE “A.” SHPK & “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1335 prot datë 20.03.2019, me objekt “Rehabilitimi i qendrës së fshatit Strum”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,226,085 lekë pa TVSH** nga BOE “P.” SHPK & “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4482 prot datë 02.11.2018, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Kuman – Luar – Vidhishtë, Pr 1900-4100, L=2210 ml, b=4+2x0.5 m”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **236,023 lekë pa TVSH** nga BOE “A.” SHPK & “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4444 prot datë 25.07.2019, me objekt “Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Roskovec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 568/44 prot datë. 29.07.2022, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre nuk është zbatuar dhe nuk rikërkohen si rekomandime të pa zbatuara pasi zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë si se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre. **Statusi i zbatimit të rekomandimeve është si vijon:**

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 6 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 6 masa, nga të pranuarat është zbatuar 1 masa dhe është në proces zbatimi 1 masa organizative, zbatuar pjesërisht 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.1 faqe 114-151 të Raportit të Auditimit).

16.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara si vijon;

Për 4 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

2.2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive.

3.3.1. Rekomandimi: Bashkia Roskovec, të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njesisë.

4.5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njesisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera

në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,042,235 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës civile me objekt “Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut” me vlerë të kontratës (me tvsh) 23,153,880 lekë, realizuar nga OE “Z.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt me vlerë totale **1,042,235 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Roskovec. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.--- Prot, datë 30.03.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe OE “Z.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 98-101 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,042,235 lekë pa tvsh nga OE “Z.” SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.--- Prot, datë 30.03.2021, me objekt “Rikualifikimi i rrugës së shkollës dhe ndërtimi i parkut”, Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 8,937 ha e ndarë sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 93 datë 26.11.2021 planifikim i kësaj takse për një vit ushtrimorë 2022 duhej të ishte në vlerën **32,940 mijë lekë**, por në fakt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Roskovec është planifikuar një vlerë prej **25,852 mijë lekë** ose më pak për shumën **7,088 mijë lekë** vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në të ardhurat e Bashkisë Roskovec në kundërshtim me ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 ku si dhe_VKB nr. 93, datë 26.11.2021“Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Roskovec për vitin 2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 45-58 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandim Bashkia Roskovec duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej **7,088 mijë lekë**, si e efekt në të ardhur në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Roskovec në datën 31.12.2022 janë në vlerën **166,688,832 lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërorë në vlerë **20,442,816 lekë** dhe abonentë familjarë në vlerë **146,246,016 lekë**, vlerë kjo e cila përbën detyrim të pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Rezulton se vetëm në vitin 2022 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 25,999,918 lekë, i përbërë nga 10,355,095 lekë dhe 15,644,823 lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Roskovec nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. DTTV për vitin 2022 nuk ka dërguar në Drejtorinë e Financës informacion lidhur me debitorët progresiv. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 45-58 të Raportit të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **166,688,832 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë Ekonomike.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim pagesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Fier. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **21,845,762 lekë** për 758 persona, ndërsa shtesat për vitin ushtrimor buxhetor 2022 janë në vlerën **1,829,562 lekë** për 61 persona, në total vlera e detyrimit është 21,845,762 lekë për 758 persona e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Roskovec, në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 “ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 “ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec është miratuar me VKB-në 93, datë 26.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 45-58 të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për **758 objekte** të legalizuara me **vlerë 21,845,762 lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Roskovec në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), të evidentojnë subjektet të cilët janë pajisur me certifikatës pronësisë dhe vendosje e urdhër kufizimit në kartelat e pasurive.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave për tokat bujqësore rezulton se 2 qiramarrës i nuk kanë paguar detyrimin sipas kontratës në vlerën 35,640 lekë për vitin 2022 e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Për kontratat e lidhura për shitje pasurie të paluajtshme rezulton që janë lidhur gjithsej 5 kontrata dhe 3 subjekte kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Roskovec, por për vitin 2022, janë 2 (dy) subjekte që nuk kanë paguar detyrimin për vlerën totale prej 83,184 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen

Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 45-58 të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për arkëtimin e vlerave debitorë nga subjektet: S. I. në vlerën 28,600 lekë; D. K. në vlerën 7,040 lekë; S. L. në vlerën 37,350 lekë; T. L. në vlerën 45,834 lekë si dhe të ndiqet më përpikëri zbatimin e kushteve të kontratave shitjes së pasurive të paluajtshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Roskovec dhe sipërmarrësit BOE “N.” SHPK ,“G.” dhe “S.” SHPK me kontratë nr.--- Prot, datë 06.03.2020 me objekt “Përmirsimi i furnizimit me ujë për qytetin e Roskovecit” dhe kontrolli në terren i rrugëve me rërë bituminoze u konstatua se rrugët në tërësi pothuajse ishin jashtë standartit madje në shumë vende përgjatë sipërfaqes së tyre ishin gërryer dhe kishin krijuar gropa ,plasaritje të thella në disa pjesë kishte humbur pothuajse fare shtresa e sipërme me rërë bituminoze t=10,cm . Në disa pjesë kishte mbirë barë anash sipërfaqes së rrugës dhe në mes të aksit të sajë. Projektimi i këtyre rrugë nuk është eficient dhe efektiv pasi kjo metodë projektimi nuk garanton jetëgjatësi të objektit të ndërtuar. Lidhja mes këtyre shtresave nuk realizohet sipas kushteve teknike gjithashtu dhe vetë shtresa e rërës bituminoze nuk është zgjidhje e duhur marrë parasysh dhe përbërjen e sajë e cila nuk ka aftësi të mirë si ndaj ngarkesave që mban si në rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Aq më tepër kur këto rrugë nuk kanë kanale për kullimin e ujërave, pasi prania e ujërave mbi sipërfaqen e rrugës për një kohë të gjatë ndikon në degradimin e rrugës për një afat kohor të shkurtër. Vlera totale e investimit të këtyre rrugëve është 23,255,720 lekë e cila përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve të Bashkisë Roskovec. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 98-101 të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Roskovec konkretisht zyrës së urbanistikës dhe kryetarit të Bashkisë të merren masa për të mos hartuar dhe miratuar projekte të këtij lloji pasi janë projekte të cilat nuk kanë efikasitet dhe efektivitet si dhe degradojnë në një kohë shumë të shkurtër.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Roskovec për periudhën objekt auditimi janë vendosur 9 (nëntë) gjopa në vlerën 2,483,000 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 1,853,000 lekë, janë referuar në gjykatë 2 (dy) raste të ndërtimeve pa leje të konstatuara në vlerën 1,300,000 lekë dhe dy raste pa paguar në vlerën 533,000 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera 1,853,000 lekë, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 1,853,000 lekë. Sa më sipër rezulton se për 5 praktikant IMT-ja ka njoftuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me nenin 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1 faqe 109-113 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në vlerën 1,853,000 lekë sipas aneksit nr. 2 pika 6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i **rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Roskovec, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

1. z. E. K.- Inxhinierë me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Pronave

2. znj. S. P.- Inxhinierë me detyrë përgjegjëse e Njesisë së Prokurimit.

3. z. S. Ç., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës

Për shkeljet e konstatuara

Në cilësinë e anëtarit të njesisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 62-98 të Raportit të Auditimit).*

4. z. K. L. me detyrë zv/kryetar i Bashkisë Roskovec.

5. z. M. L. me detyrë Specialist në Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

6. znj. Z. Ç. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor

Për shkeljet e konstatuara

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 62-98 të Raportit të Auditimit).*

7.znj. A. P. më detyrë ish përgjegjëse pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.

8.znj. E. H. me detyrë drejtore pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.

9. znj E. H. me detyrë specialiste pranë DPZHTK Bashkia Roskovec.

Për shkeljet e konstatuara

- Në cilësinë e *Drejtorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit* për mos zbatim të kërkesave të ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015” Në miratimin e lejeve të ndërtimit. *(Më hollësisht trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit).*

10. z. M. P. me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 11.02.2022 e në vijim

11. znj. A. R. me detyrë Përgjegjëse në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 02.09.2021 e në vijim

- Për shkeljet e konstatuara

Në mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, me pasojë mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit **166,688** mijë lekë.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

- Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore *znj. Z. S. me detyrë juriste nw Zyrën Juridike për shkeljet e konstatuara në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST; z. R. H. me detyrë ish drejtor pranë DPZHTK Bashkia Roskovec dhe znj. I. K. me detyrë ish specialite pranë DPZHTK Bashkia Roskovec si person përgjegjës për shkeljet e konstatuara në cilësinë e Drejtorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015” në miratimin e lejeve të ndërtimit; z. M. A. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 19.04.2021 deri më 03.11.2022 dhe znj. D. D. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 15.01.2021 deri më 14.04.2022 për shkeljet e konstatuara në mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.*

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Gramsh pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

Kontrolli i Lartë i shtetit

